

1 E hënë, 15 shtator 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare e seancës, ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar
9 kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup
10 Krasniqit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
12 të gjithëve. Për procesverbal, vërej që të akuzuarit janë të
13 gjithë të pranishëm sot.

14 Sot do të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të Mbrojtjes
15 së Thaçit 1DW-003.

16 Përpara sesa të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit të
17 Mbrojtjes së Thaçit, Trupi Gjykses dëshiron që të trajtojë një
18 çështje paraprake. Në fakt kemi gjashtë ose shtatë çështje
19 paraprake, megjithatë, si fillim, do fillojmë me një urdhër
20 gojor pastaj do të vazhdojmë me urdhrat e tjerë.

21 Trupi Gjykses vëren se parashttrim i protokolluar F03462,
22 në këtë parashttrim Mbrojtja e Thaçit ka kërkuar përshpejtim të
23 afateve për F03462. Gjithashtu ka kërkuar që të ndryshojë
24 listën e provave materiale për të shtuar një dokument që synon
25 që të përdorë me Dëshmitarin 003.

1 Në parashtimin F03466, ZPS-ja është përgjigjur për
2 kërkesën duke thënë që kërkesa është dorëzuar me vonesë,
3 megjithatë, ka theksuar që nuk është kundër kërkesës.

4 Së pari, sa i takon kërkesës për përshpejtim të afateve,
5 Trupi Gjykses vëren se të enjten më 11 shtator 2025 Trupi
6 Gjykses përshpejtoi afatin për F03462.

7 Së dyti, sa i takon kërkesës për ndryshimin e listës së
8 provave materiale, Mbrojtja e Thaçit kërkoi që të shtohet një
9 dokument që është versioni i plotë dhe versioni origjinal i
10 një artikulli të Dëshmitarit 003. Një version paraprak jo i
11 plotë i këtij artikulli është diskutuar në deklaratën e
12 dëshmitarit, dhe Trupi Gjykses ka konstatuar që është i
13 përshtatshëm për t'u pranuar në prova sipas rregullës 154.

14 Sa i takon dorëzimit me vonesë, Trupi Gjykses vëren se
15 Mbrojtja e Thaçit e ka bërë këtë kërkesë pesë ditë përpara
16 sesa ZPS-ja të nxirrte versionin e plotë të artikullit në
17 paketën e nxjerrjes së dokumenteve 1765.

18 Rrjedhimisht, Trupi Gjykses konstaton se Mbrojtja e
19 Thaçit ka bërë njoftim në kohë.

20 Trupi Gjykses vëren se dokumenti lidhet me dëshminë e
21 dëshmitarit lidhur me atë se çfarë mban mend ai për sa i takon
22 konfliktit në Kosovë, në veçanti me rolin e z. Thaçi në
23 Konferencës së Rambujesë dhe autoritetit dhe kompetencës së
24 tij brenda UÇK-së. Gjithashtu, versioni tjetër i këtij
25 artikulli është diskutuar me dëshmitarin dhe është përfshirë

1 në dëshminë e tij.

2 Për rrjedhojë, Trupi Gjykses konstaton që materiali ka
3 rëndësi *prima facie* dhe ka rëndësi të mjaftueshme si dhe
4 ekziston shkak bindës për sa i takon shtesës me vonesë së
5 këtij në listën e provave materiale.

6 Së fundi, sa i takon cenimit, Trupi Gjykses vëren se
7 versioni tjetër i artikullit është aktualisht në listën e
8 provave materiale dhe ZPS-ja nuk e ka kundërshtuar shtimin e
9 këtij dokumenti. Duke e marrë parasysh faktin që palët dhe
10 pjesëmarrësit kanë pasur kohë të mjaftueshme për të rishikuar
11 dokumentet në fjalë dhe për t'u përgatitur për dëshminë e
12 Dëshmitarit 003, Trupi Gjykses konstaton që shtimi i këtij
13 dokumenti nuk cenon asnjë nga palët dhe vendos për ta shtuar
14 atë në listën e provave materiale.

15 Trupi Gjykses miraton kërkesën për shtimin e dokumentit
16 SPOE00397414 deri në 00397417 dhe përkthimet përkatëse në
17 listën e provave materiale të Mbrojtjes së Thaçit. Trupi
18 Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Thaçit që të dorëzojë një listë
19 të rishikuar të provave materiale sa më shpejt të jetë e
20 mundur.

21 Këtu përfundon urdhri me gojë i Trupit Gjykses.

22 Tani do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit përkatës.

23 Së pari, si kujtesë, në parashtrimin F03468, Trupi
24 Gjykses autorizoi masa të caktuara sipas rregullës 107 për sa
25 i takon dëshmitarit aktual, duke përfshirë këtu dhe dëshminë e

1 dëshmitarit që duhet të kufizohet sa i takon fushëveprimit të
2 tij në paragrafin 18 të F03468, që dëshmitari do t'i
3 përgjigjet pyetjeve që kanë të bëjnë me pyetjet përkatëse duke
4 u mbështetur në parimin e konfidencialitetit.

5 Trupi Gjykues nuk do të pranojë pyetje të cilat nuk
6 tregojnë ose nuk dëshmojnë që janë të lidhura qartësisht me
7 çështje të cilat kanë të bëjnë me parashikimet e rregullit 107
8 dhe që lidhen me miratimin e palës ofruese. Pra, palët
9 përkuese do të duhet që të dëshmojnë se si pyetjet e tyre bien
10 brenda fushëveprimit të autorizimit sipas rregullës 107.

11 Do i kërkoja Sekretares tani të sjellë dëshmitarin në
12 sallë.

13 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 qëndroni në këmbë, Dëshmitar. Ju lutem, qëndroni në këmbë. Të
16 dy do flasim të njëjtën gjuhë, megjithatë besoj që mund të më
17 dëgjoni më mirë në qoftë se përdorni dëgjueset.

18 Dëshmitar, Sekretarja e seancës tani do t'ju japë tekstin
19 e deklaratës solemne të cilën duhet ta lexoni në pajtim me
20 rregullin 141(2) i Rregullores tonë. Do ju kërkoja që t'i
21 hidhni një sy dhe ta lexoni me zë më pas.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë e
23 dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj
24 solemnisht se do ta them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe
25 vetëm të vërtetën dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të

1 cilën kam dijeni.

2 DËSHMITARI: JAMES RUBIN

3 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Tani mund të uleni.

6 Së pari, sa i takon prezantimeve. Palët dhe përfaqësuesit
7 mbase e kanë vënë re që kemi dy përfaqësues të Qeverisë së
8 Shteteve të Bashkuara që janë të pranishëm në sallën e gjyqit.
9 Do i kërkoja secilit prej persona që të prezantoheshin për
10 procesverbal.

11 ZNJ. GEARHART-SERNA: [Përkthim] Unë jam Terra Gearhard-
12 Serna. Unë jam zëvendëssekretare në Ambasadën e Shteteve të
13 Bashkuara këtu në Hagë.

14 ZNJ. COYNE: [Përkthim] Unë jam Joanna Coyne. Dhe jam
15 gjithashtu këshilltare juridike në Uashington DC.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
17 dëshmia juaj vlerësohet që të zgjasë dy deri në tre ditë.

18 Sikurse mund ta dini, ekipi i parë që do t'ju bëjë pyetje
19 është Ekipi i z. Thaçi. Pas Ekipit të z. Thaçi, do t'ju bëjnë
20 pyetje ekipet e tjera në qoftë se kanë. Dhe pas tyre do t'ju
21 bëjë pyetje ZPS-ja, në qoftë se kanë pyetje dhe anëtarët e
22 Trupit Gjykues do të bëjnë pyetje për ju.

23 Mbrojtja e Thaçit ka vlerësuar se i duhen rreth katër
24 orë. Ndërkohë ekipet e tjera të Mbrojtjes kanë vlerësuar që i
25 nevojiten 3.5 orë, ZPS-ja ka vlerësuar që i duhen katër orë.

1 Si me çdo vlerësim tjetër, ne shpresojmë që avokatët përkatës
2 do ta përdorin kohën siç duhet dhe me efikasitet. Trupi
3 Gjykses do të lejojë pyetje plotësuese në qoftë se përmbushen
4 kriteret përkatëse.

5 Dëshmitar, ju lutem jepini përgjigjet të qarta dhe me
6 fjali të shkurtra. Në qoftë se pyetjet nuk i kuptoni, ju
7 lutem, tregojini avokatit përkatës që nuk e kuptoni pyetjen në
8 mënyrë të tillë që të bëhet një shpjegim i mëtejshëm i pyetjes
9 ose një riformulim i saj. Në qoftë se ju kërkohet që të jepni
10 bazën e njohurive për sa i takon fakteve dhe rrethanave, ju
11 lutem na e bëni me dije këtë gjë. Në qoftë se do ju kërkohet
12 që të vërtetoni qartësimet ose saktësimet e bëra në deklaratën
13 tuaj duhet që ta konfirmoni këtë gjë.

14 Ju lutem flisni përpara mikrofonit, bëni një pauzë prej
15 pesë sekondash përpara se të jepni përgjigje dhe do ju kërkoja
16 që të flisni ngadalë në mënyrë të tillë që t'ju kapin
17 përkthyesit.

18 Gjatë kohës që do jepni dëshmi në këtë gjyq, nuk lejohet
19 që të diskutohet me askënd lidhur me përmbajtjen e dëshmisë
20 tuaj jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se një person jashtë
21 sallës së gjyqit ju kërkon ose ju bën pyetje lidhur me
22 dëshminë tuaj në Gjykatë, këtë informacion duhet të na e bëni
23 me dije menjëherë.

24 Në qoftë se ju kërkoj që të mos flisni më, ju lutem
25 ndërprisni së foluri ose në qoftë se më shikoni që ngre dorën,

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 7

1 ju lutem ndërprisni së foluri, sepse kjo do të thotë që do të
2 duhet t'ju jap udhëzime të caktuara.

3 Në qoftë se e ndjeni të nevojshme që duhet që të bëni një
4 pauzë ose në qoftë se doni të bëni sqarime të caktuara, na e
5 bëni të qartë këtë gjë.

6 Sa për sqarim, dua t'ju them që në orën 10.00 do bëjmë
7 një pushim të shkurtër prej dhjetë minutash, ndërkohë që do të
8 vazhdojmë më tej në orën 11.00 me pushim e radhës prej 30
9 minutave. Pra, do japim kohë të mjaftueshme për të pushuar.

10 Për procesverbal, ne vërejmë që jeni të shoqëruar këtu me
11 dy përfaqësuese të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara. Ndërkohë
12 Trupi Gjykses më përpara ka bërë, ka marrë një vendim
13 paraprake që dëshmia juaj do jetë e kufizuar në fushëveprim e
14 saj dhe përfaqësuesit në Gjykatë sot do të na ndihmojnë lidhur
15 me këtë. Në qoftë se keni dyshime, në qoftë se keni pyetje
16 lidhur me dëshminë tuaj mund të na bëni ne pyetje ose mund t'i
17 bëni pyetje përfaqësuesve të Qeverisë të Shteteve të
18 Bashkuara.

19 Z. Misetic, fjala është për ju.

20 Pyetje nga z. Misetic:

21 Z. MISETIC: [Përkthim]

22 PY. Mirëmëngjes, z. Rubin.

23 PË. Mirëmëngjes.

24 PY. Ne jemi takuar më herët. Për procesverbal unë jam avokati
25 kryesor për Hashim Thaçin.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 8

1 A mund të na thoni emrin dhe mbiemrin për procesverbal?

2 PË. James Phillip Rubin.

3 PY. Cila është ditëlindja juaj?

4 PË. Ditëlindja ime është 28 mars 1960.

5 PY. Çfarë shtetësie keni?

6 PË. Amerikane.

7 PY. A keni dhënë një deklaratë për Mbrojtjen e Thaçit më datë
8 22 shkurt të vitit 2025?

9 PË. Po.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares së seancës
11 që të paraqesë në ekran dokumentin DHT171 dhe në vijim.

12 PY. Z. Rubin, a e njihni, a ju kujtohet ky dokument që keni
13 përpara në ekran?

14 PË. Po.

15 PY. Cili është ky dokument, na e shpjegoni pak?

16 PË. Ky është dokumenti që kemi përgatitur mbështetur në të
17 gjithë njohurinë që kam unë për temën.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Le të kalojmë tek faqja e fundit e
19 këtij dokumenti që është DHT11892. Kalojmë në fund të faqes.

20 PY. A është nënshkrimi juaj ky, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. A është nënshkrim elektronik ky?

23 PË. Po.

24 PY. A keni autorizuar ju vendosjen e nënshkrimit elektronik?

25 PË. Po.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 9

1 PY. Një udhëzim për ju, Dëshmitar. Ne të dy flasim anglisht,
2 kështu që besoj do kemi tendencë që të flasim shpejt,
3 megjithatë çdo gjë që flitet këtu ndiqet nga përkthyesit, nga
4 përkthyesit e shqipes dhe të serbishtes, kështu që do të duhet
5 të bëjmë një pauzë ndërmjet pyetjeve dhe përgjigjeve, ju
6 lutem.

7 A keni pasur mundësi që ta rishikoni këtë dokument
8 përpara sesa ta nënshkruanit, Dëshmitar?

9 PË. Po.

10 PY. A keni pasur një tjetër mundësi që ta rishikoni këtë
11 dokument përpara një jave?

12 PË. Po.

13 PY. A keni pasur mundësinë që të takoheshit me mua dhe
14 kolegët e mi përmes videolidhjes javën e shkuar?

15 PË. Po.

16 PY. Në këto takime a keni pasur mundësi që të bëni sqarime
17 dhe korrigjime në deklaratën tuaj përkatëse?

18 PË. Po.

19 PY. A ju kujtohet që sqarimet dhe korrigjimet ju janë lexuar
20 në një shënim që ka qenë i plotë?

21 PË. Po.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal Ky është
23 dokumenti DHT12022 deri në DHT12024.

24 PY. Duke marrë parasysh këto sqarime dhe korrigjime që na
25 keni dhënë përpara një jave dhe të cilat i kemi reflektuar në

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 10

1 shënim, deklaratata që keni dhënë në deklaratën tuaj për
2 Mbrojtjen e Thaçit, pasqyron me saktësi atë çfarë dini ju
3 lidhur me pyetjet e bëra?

4 PË. Po.

5 PY. Informacioni i dhënë në deklaratën e dëshmisë tuaj, duke
6 marrë parasysh dhe sqarimet dhe korrigjimet, a pasqyron
7 plotësisht atë çfarë do të thonit ju në qoftë se do ju
8 bëheshin të njëjtat pyetje këtu përpara Trupit Gjykses?

9 PË. Po.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkojmë
11 pranimin e deklaratës së dëshmitarit që është dokumenti i
12 shënjuar si DHT11879 deri në DHT11892 dhe provat materiale
13 shoqëruese që janë pranuar më herët nga Trupi Gjykses në
14 vendimin F03452 dhe kërkojmë gjithashtu që të pranohet në
15 provë materiale shënimi përgatitor 1DHT12022 deri në DHT12024.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
17 kundërshtim nga Prokuroria?

18 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

19 Z. LAWS: [Përkthim] As ne nuk kemi kundërshtim.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshiron
21 dikush tjetër që të thotë diçka? Duket se jo.

22 Atëherë dokumenti DHT11879 deri DHT11892 pranohet në
23 provën materiale.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
25 i caktohet numri i provës 1D262. Si ta klasifikojmë?

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 11

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jetë i klasifikuar si
2 publik.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ta
4 riklasifikojmë si publik. Po ashtu le të pranojmë Shënimin
5 Përgatitor numër 1 që është DHT12022 deri në 12024.

6 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e
7 provës 1D263. Çfarë klasifikimi të caktojmë?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Ta klasifikojmë si publik.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Le t'i caktojmë numrin përkatës.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Prova shoqëruese
12 DHT01462 deri në DHT01464 do të marrë numrin e provës 1D264.

13 Dokumenti DHT05121 deri DHT05124 do marrë numrin e provës
14 1D265.

15 Dokumenti DHT05125 deri në DHT05125 do marrë numrin e
16 provës 1D266.

17 Dokumenti DHT05126 deri në DHT05133 do të marrë numrin e
18 provës 1D267.

19 Dokumenti DHT05134 deri në DHT05139 do të marrë numrin e
20 provës 1D268.

21 Dokumenti DHT05144 deri në DHT05149 do të marrë numrin e
22 provës 1D269.

23 Dokumenti DHT05150 deri DHT05153 do të marrë numrin e
24 provës 1D270.

25 Dokumenti DHT05154 deri në DHT05155 do të marrë numrin e

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 12

1 provës 1D271.

2 Dokumenti DHT456 -- dhe një herë. Dokumenti DHT05156 deri
3 në DHT05164 do të marrë numrin e provës 1D272.

4 Dokumenti DHT05165 deri në DHT05169 do të marrë numrin e
5 provës 1D273.

6 Faqet DHT05170 deri në DHT05173 nga dokumenti DHT05170
7 deri në DHT05177 do të marrin numrin e provës 1D274.

8 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres por
9 mikrofonin e dëshmitarit është i ndezur dhe mund ta dëgjojmë se
10 çfarë po thotë. Mbase do ishte mirë që ta fikte.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit, që ma kujtuat.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti DHT05180 deri
13 në DHT05189, faqet nga DHT05180, DHT05186 dhe DHT5189 do të
14 marrin numrin e provës 1D275.

15 Dokumenti DHT05190 deri në DHT05191 do të marrë numrin e
16 provës 1D276.

17 Dokumenti DHT05166 deri në DHT05281 do të marrë numrin e
18 provës 1D277.

19 Dokumenti DHT05284 deri në DHT05289 do të marrë numrin e
20 provës 1D278.

21 Dhe, së fundi, dokumenti nga SPOE002829708 deri në
22 SPOE00229735, faqet SPOE00229721, SPOE00229726, SPOE00229727
23 dhe SPOE00229728 dhe faqja SPOE00229733 do të marrin numrin e
24 provës 1D279.

25 Të nderuar Gjykatës, ju lutem më thoni çfarë klasifikimi

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Page 13

1 t'i vë të gjitha provave materiale shoqëruese?

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Aktualisht
3 janë konfidenciale, apo jo? Znj. Sekretare e seancës?

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Disa prej tyre, po,
5 janë.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të gjitha do
7 riklasifikohen si publike. Në rregull.

8 Z. Misetic, mund të vazhdoni më tej.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

10 Më 8 shtator 2025, Mbrojtja e Thaçit ka dërguar përmes
11 postës elektronike një përmbledhje të propozuar për këtë
12 dëshmitar dhe tani ky dokument i është bërë me dije të gjithë
13 palëve dhe pjesëmarrësve. Nuk kemi marrë asnjë kundërshtim
14 lidhur me këtë dokument, kështu që në qoftë se më lejoni dua
15 që të lexoj një përmbledhje të këtij dokumenti.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
17 vazhdoni.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Nga viti 1997 deri në vitin 2000,
19 James Rubin ka shërbyer si Ndihmëssekretar i Shtetit për
20 Çështjet Publike dhe i zëdhënësi kryesor që ka raportuar
21 drejtpërdrejt përpara Sekretares së shtetit Madeleine
22 Albright. Kur grupi i kontaktit vendosi që të mblidhej për një
23 proces paqeje në janar të vitit 1999, z. Rubin është udhëzuar
24 drejtpërdrejt nga znj. Albright për t'u angazhuar me
25 delegacionin shqiptar të Kosovës gjatë Konferencës së

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 14

1 Rambujesë në Kosovë dhe më pas u bashkua negociatave si i
2 dërguari i posaçëm në emër të Sekretares së Shtetit për të
3 siguruar demobilizimin e UÇK-së.

4 Në këtë kuadër, z. Rubin ka pasur takime të shumta me
5 Hashim Thaçin dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së. Kjo e lejoi z.
6 Rubin që të kuptonte që z. Thaçi ishte i shqetësuar që nuk do
7 të kishte autoritetin ose lejen e plotë për të nënshkruar
8 Marrëveshjen e Rambujesë në emër të UÇK-së pa miratimin e anës
9 ushtarake ose të aspektit ushtarak të UÇK-së.

10 Po ashtu, gjatë negociatave që çuan në nënshkrimin dhe në
11 sipërmarrjen e demilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së, z.
12 Rubin vërejti që roli i z. Thaçi ishte i kufizuar sepse ai nuk
13 ishte i angazhuar në biseda teknike. Ai gjithashtu, vërejti që
14 z. Thaçi i ka shprehur atij personalisht që prej fillimit që
15 ai dëshironte të kishte dhe sigurohej në të ardhmen një Kosovë
16 demokratike, e lirë, pa dhunë ndëretnike dhe që funksiononte
17 nën vlerat demokratike të perëndimit deri në masën e mundur.

18 Z. Rubin shpjegoi gjithashtu që në qershor të 1999
19 Sekretarja Albright u takua me z. Thaçi, me Rexhep Qosjen dhe
20 z. Rubin e kuptoi që kjo kishte ndikim mbi Qeverinë e
21 Përkohshme të Kosovës.

22 Ky është fundi i përmbledhjes së z. Rubin.

23 Dhe një herë do të doja t'ju kujtoja z. Rubin që duhet të
24 jemi të ngadaltë për t'u kapur plotësisht nga përkthyesit.

25 PY. Z. Rubin, ju thoni në deklaratën e dëshmitarit që ju keni

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 15

1 punuar për senatorin amerikan Joseph Biden në periudhën nga
2 1989 në 1993. A ka qenë kështu?

3 PË. Po.

4 PY. A keni pasur mundësi që të vizitonit ndonjë prej vendeve
5 të ish-Jugosllavisë kur keni punuar për senator Biden?

6 PË. Po. Kam vizituar në periudhën 1991, 1992 dhe 1993,
7 domethënë, i kam vizituar këto vende përpara luftës, ndërmjet
8 Kroacisë dhe Serbisë së pari dhe më pas kam vizituar
9 Sarajevën, kapjen, rrethimin e Sarajevës dhe gjatë sulmeve po
10 ashtu dhe gjatë luftës që ka qenë në Bosnje. Kam qenë në disa
11 qytete dhe po ashtu në fund fare kam shoqëruar gjithashtu edhe
12 senator Biden në të gjitha këto vende në pranverën e vitit
13 1993.

14 PY. A keni pasur mundësi që gjatë këtyre udhëtimeve tuaja të
15 jeni takuar me udhëheqës të Kosovës?

16 PË. Po. Gjatë luftërave në atë kohë, fillimisht në Kroaci dhe
17 në Serbi dhe pastaj në Bosnjë këto kanë qenë fokuset e këtyre
18 udhëtimeve, domethënë, vendet përkatëse. Megjithatë duke qenë
19 të vetëdijshëm për faktin që konflikte të tilla mund të
20 shtriheshin më tej, ne e kuptuam që ajo çfarë po ndodhte në
21 Kosovë ishte po ashtu shumë e rëndësishme. Kështu që kam
22 përshtypjen që e kam vizituar Prishtinën në atë kohë dy ose
23 tri herë. Gjatë asaj kohe jam takuar të paktën një herë ose dy
24 herë me Ibrahim Rugovën, jam takuar gjithashtu edhe me
25 shqiptarë të tjerë të Kosovës, me persona të tjerë me

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 16

1 influencë në Kosovë në atë kohë.

2 PY. Në deklaratën e dhënë në paragrafin 1, ju thoni që në
3 periudhën nga 1993 deri në 1996 gjatë mandatit të parë të
4 Presidentit Clinton, ju keni qenë ose keni shërbyer si
5 këshilltar i lartë dhe zëdhënësi kryesor për Sekretaren e
6 Shtetit Albright. Dhe ju thoni që juve e keni njohur njëri-
7 tjetrin, domethënë, ju dhe znj. Albright, për çështjen e
8 Bosnjës përpara zgjedhjeve të 1992. A mund të na e shpjegoni
9 çfarë doni të thoni më konkretisht me këtë, Dëshmitar?

10 PË. Partia Demokratike ishte në fuqi për tre mandate,
11 ndërkohë që administrata e Reagan, domethënë, kishte tre,
12 ishin dy administrata të Reagan dhe një administratë e Bush,
13 kështu që bëhej fjalë për 12 vite në të cilat Partia
14 Demokratike ishte në fuqi në atë kohë. Personat si puna jonë
15 të Partisë Demokratike të cilët kërkonin që të ndiqeshin
16 politika të dhura të ndryshimit e kishin njohur dhe filluam
17 ta njihnim më mirë njeri-tjetrin.

18 Për sa i takon Madaleine Albright në atë kohë, ajo ishte
19 një zyrtare e lartë, një zyrtare udhëheqëse e komunitetit të
20 politikave të jashtme të Partisë Demokratike dhe kishte bërë
21 shumë punë në Evropën Lindore. Unë besoj që përvoja jonë e
22 parë reale ishte kur ajo bëri ose shprehu keqardhjen e saj të
23 ndjerë, pra, u bë një sondazh për sa i takon shprehjes së
24 keqardhjes për atë çfarë kishte ndodhur në vendet evropiane të
25 lindjes pas rënies së komunizmit.

1 Ndërkohë kur unë them që ne krijuam "një lidhje" ndërmjet
2 nesh, pra, e kam fjalën për veten dhe për znj. Albright, ajo
3 çfarë dua të them është që me sa më kujtohet mua në 1992 ose
4 në 1991, Partia Demokratike kryesisht ishte e mbushur me
5 persona të cilët nuk donin që Amerika të merrte një veprim ose
6 të luante një rol ndërkombëtar aktiv. Ndërkohë, znj. Albright
7 në vetvete ishte e kundërta e këtij qëndrimi të përgjithshëm.
8 Kishte shumë zyrtarë të tjerë në Amerikë në atëkohë që kishin
9 qëndrim të ndryshëm prej saj. Unë vetë isha po ashtu isha i
10 ndryshëm, pasi e kisha vizituar vetë zonën e luftës.

11 Dhe, me thënë të drejtën edhe kauza e Bosnjës ishte diçka
12 shumë emocionale për mua duke pasur parasysh prejardhjen time
13 si amerikan hebre që isha rritur në vitet 1970 dhe ishte disi
14 e pabesueshme që gati 50 vjet pas holokaustit situata dukej si
15 sikur po përsëritej përsëri. Kështu që duke qenë në një
16 pozicion të tillë dhe duke menduar që çfarë do bëje ti ose
17 çfarë do të bënte dikush në qoftë se kishit kompetenca, kishit
18 mundësi të bënit diçka në atë kohë. Dhe duke pasur mundësi që
19 të punoja së bashku me të me një kauzë që ishte kaq shumë e
20 rëndësishme, ne krijuam një lidhje, një lidhje që shkonte
21 përtej thelbit të punës tonë. Kjo është ajo çfarë unë doja të
22 thoja me atë që u krijua një lidhje ndërmjet nesh.

23 Shpresoj që të mos isha shumë i gjatë në përshkrimin e
24 dhënë, po kjo ishte ideja.

25 PY. Z. Rubin, a keni pasur përfshirje ju në krijimin ose në

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 18

1 themelimin e TPNJ-së, domethënë, për Tribunalin Penal
2 Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara kundër Jugosllavisë në
3 1993?
4 PË. Po. Madaleine Albright ishte Ambasadore e Shteteve të
5 Bashkuara dhe së bashku me Kombet e Bashkuara dhe me një prej
6 këshilltarëve David Schaeffer. Ajo ka qenë një avokate shumë e
7 fuqishme për krijimin e atij tribunali. Unë personalisht kam
8 punuar shumë ngushtë me të. Kam punuar ngushtë edhe me David
9 Schaeffer. Madaleine Albright ishte shumë krenare dhe unë për
10 rrjedhojë isha shumë krenar që kam dhënë ndihmën time modeste
11 për krijimin e këtij tribunali të parë të këtij për ish-
12 Jugosllavinë dhe për Ruandën. Besoj që u desh ca kohë që të
13 krijohej institucioni, tribunali. Kemi ardhur këtu në 1993 ose
14 në 1994, nuk më kujtohet mirë viti se cili ka qenë, megjithatë
15 më kujtohet që ne e thërrisnim atë nënën e tribunalit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk dua t'ju
17 ndërpres, por do ishte më mirë që të dëgjoni pyetjen. Pyetja
18 ndoshta kërkonte një përgjigje "po" ose "jo". Në qoftë se
19 avokati dëshiron që të jepni më shumë informacion, do ju bëjë
20 pyetje tjera. Ndoshta do ishte më mirë që të dëgjoni pyetjen,
21 të përgjigjeni me "po" e "jo" dhe në qoftë se avokati dëshiron
22 që të ketë më shumë informacion prej jush do t'jua bëjë
23 përsëri pyetjen ai.

24 DËSHMITARI: Në rregull.

25 Z. MISETIC: [Përkthim]

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 19

1 PY. Në paragrafin 2 të deklaratës tuaj, ju thoni që gjatë
2 mandatit të dytë të Presidentit Clinton, ju keni shërbyer si
3 zëdhënësi kryesor i Departamentit të Shtetit. Dhe në
4 paragrafin 11, ju thoni që, jo vetëm që duhet të dinit
5 çështjet përkatëse, por duhet që të dinit dhe qëndrimin e znj.
6 Albright sa i takon problemeve që ekzistojnë dhe, gjithashtu,
7 ju ishit të informuar sa i takon kabllogrameve të dërguara nga
8 Departamenti i Shtetit që i dërgoheshin ambasadave të
9 ndryshme, a është kjo e drejtë, Dëshmitar?

10 PË. Po.

11 PY. Thoni në paragrafin 3 se cilat ishin përgjegjësitë tuaja
12 dhe sesi sekretarja znj. Albright ju ngarkoi ju me detyrën për
13 të shkuar në Rambuje dhe për t'u përfshirë me delegacionin
14 shqiptar të Kosovës gjatë Konferencës së Rambujesë, a është e
15 saktë kjo, Dëshmitar?

16 PË. Po.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Do i kërkoja Sekretares tani të
18 paraqesë në ekran tani dokumentin SPOE00397414 deri në
19 SPOE00397417.

20 PY. Z. Rubin, e njihni dokumentin në ekran?

21 PË. Po.

22 PY. Çfarë është ky?

23 PË. Është artikull që e kam shkruar unë pak kohë pasi jam
24 larguar nga qeveria në vitin 2000, ky ishte si një lloj
25 memorie e shkurtër e luftës së Kosovës.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 20

1 PY. Dhe ky tregim, ky artikull a përbën një memuar tuajin
2 personal dhe të përvojave tuaja personale në luftën e Kosovës?
3 PË. Po, për këtë quhet "Tregimi", që është i nivelit shumë
4 personal, "i një lufte shumë personale".

5 PY. Në këtë tregim ju jeni përpjekur që të jeni sa më i saktë
6 i mundur bazuar në atë që ju kujtohej?

7 PË. Po.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Gjykatës, kërkoj që ky dokument
9 ta dorëzoj për pranim, të dy pjesët e tij, SPOE003937414 deri
10 në SPOE00397417

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
12 kundërshtim?

13 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00397414
15 deri në 00397417 pranohet.

16 Jepini një numër.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky do të marrë numrin e
18 provës materiale 1D280. Dhe do kërkoj, do pyetja për
19 klasifikimin?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Duhet të jetë publik. Është
21 publik.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është publik,
23 pra, riklasifikohet si publik.

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Pyetja ime për kontekstin tjetër është pas publikimit të

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 21

1 këtij artikulli në vitin 2000, a keni patur ndonjë -- keni

2 ndërvepruar më tej me z. Thaçi?

3 PË. Po.

4 PY. A mund të na thoni kur ndodhi ky ndërveprim dhe pse?

5 PË. Atëherë, nuk më kujtohen të gjitha ndërveprimet. Më
6 kujtohet takimi i parë apo shkëmbimi i parë pas kësaj. Ai
7 ishte djalë i ri, e kam takuar në një kohë të vështirë, nuk
8 kishte ndonjë funksion zyrtar apo pushtet. Dhe herën e parë
9 jemi takuar pas publikimit të kësaj në Nju Jork kur është bërë
10 kryeministër. Erdhi në një restorant si kryeministër dhe unë u
11 habita shumë nga kjo sepse ai kishte kaluar nga një djalë i ri
12 që punonte në rrethana të vështira dhe tani befasisht ishte
13 bërë kryeministër. Pra, kishin kaluar disa vite, katër-pesë
14 vite në qoftë se më kujtohet mirë dhe kjo ka ndodhur në një
15 restorant në Nju Jork. Hera e parë.

16 PY. Kur ishte hera e fundit?

17 PË. Besoj që hera e fundit duhet të ketë qenë rreth vitit
18 2018 kur po punoja në Uashington dhe ai në atë kohë ishte
19 president i Kosovës.

20 PY. Pse u takuat këtë herë?

21 PË. Unë u largova nga Londra në 2018, ndoshta jam takuar me
22 të në 2019 në fakt. Pra 2018 u ktheva në Uashington për të
23 punuar për një firmë të njohur lobimi. Dhe kur u ktheva atje,
24 unë kisha një kontratë me qeverinë e Kosovës përpara që të
25 vija, të mbërrija atje. Kur partnerët e kuptuan që unë e

1 njihja shumë mirë, menduan që kjo kishte kuptim që unë të
2 punoja me të lidhur me këtë kontratë. Kjo kontratë kishte të
3 bënte me përfaqësimin që do i bëja unë atij në përpjekjet për
4 të bërë paqe me Serbinë. Pra, kemi punuar shumë bashkë gjatë
5 asaj periudhe në përpjekje për t'i dhënë fund konfliktit dhe
6 për të sjellë një paqe përfundimtare midis Kosovës dhe
7 Serbisë. Dhe unë isha shumë i gëzuar që ta shoh atë që ndoshta
8 ne mund t'i jepnim fund këtij konflikti me një njohje të
9 ndërsjellët të dy palëve. Ne kemi punuar bashkë me të lidhur
10 me këtë, pra, përpjekjen për të përfunduar, për t'i dhënë fund
11 konfliktit, për të sjellë paqen në rajon dhe për të siguruar
12 njohjen e Kosovës dhe Serbisë si dy vende në paqe, me siguri,
13 e cila do të ishte një përfundim i bukur i një historie të
14 tmerrshme të mëparshme.

15 PY. Z. Rubin, të kthehemi në 1999-n, a ju kujtohet kur keni
16 arritur në Rambuje për bisedimet?

17 PË. Po, më kujtohet kur kam arritur pasi ata kishin filluar,
18 kishte disa ditë që kishin filluar bisedimet. Pra, ishte
19 Madalaine Albright, Sekretarja e Shtetit, duhet pasur parasysh
20 që kjo ishte një çështje e një rëndësie parësore për atë dhe
21 gjërat që ishin të rëndësishme për atë ishin të rëndësishme
22 dhe për mua. Dhe ajo e dinte që ajo dhe unë kishim një --
23 kuptonim fare mirë pikëpamjet e secilit, pra, të njëri-tjetrit
24 dhe ajo më dërgoi mua përpara se të vinte ajo, rreth një javë
25 më parë, që të shkojë aty dhe të takoja negociatorët dhe që të

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 23

1 fillonim të formulonim politikat që ishte një gjë tejet e
2 rëndësishme. Pra, përpjekja për të sjellë paqe dhe për të
3 parandaluar atë që ne kishim frikë do të ndodhte, pra, që
4 ishte një masakër masive e shqiptarëve të Kosovës, pra, që ta
5 shmangnim këtë përmes konferencës për paqe.

6 PY. Kur arritët ju a e dinit nëse delegacioni i Shqipërisë
7 kishte zgjedhur kryesuesin e tyre?

8 PË. E di.

9 PY. Dhe kë kishin zgjedhur dhe a e kishin zgjedhur?

10 PË. Po.

11 PY. Dhe kush ishte ai?

12 PË. Hashim Thaçi.

13 PY. Dhe a dini në atë kohë apo e dini tani pse Hashim Thaçi
14 ishte zgjedhur si kryesues i delegacionit të shqiptarëve të
15 Kosovës?

16 PË. Jo e sigurtë. Ne thjesht e dinim që e kishin zgjedhur
17 atë.

18 PY. Në paragrafin 21 të deklaratës tuaj ju thoni që
19 Sekretarja Albright menjëherë dëshiroi të fliste menjëherë me
20 z. Thaçi kur arriti atje.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të shfaqni në
22 ekran dokumentin DHT05848 deri në DHT05854 që është i pranuar
23 si provë materiale përmes mendimit për pranimin në prova jo
24 gojore në F03467.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është e

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 24

1 mundur të përmendim numrin e provës materiale sepse nuk e
2 dhatë këtë?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk mendoj që kemi numër të provës
4 materiale.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e kemi
6 bërë këtë.

7 Vazhdoni.

8 Z. MISETIC: [Përkthim]

9 PY. Ky është kabllogram i Shteteve të Bashkuara i datës 15
10 shkurt 1999.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Nëse mund ta zmadhojmë pak
12 titullin.

13 PY. Pra, kabllogrami ka të bëjë me një takim që Sekretarja e
14 Shtetit znj. Albright ka bërë me delegacionin shqiptar të
15 Kosovës më 14 shkurt 1999. E shikoni këtë?

16 PË. Po.

17 PY. Dhe kjo duhet të ketë ndodhur ditën pas arritjes së asaj
18 në Rambuje?

19 PË. Po.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
21 faqen 2 të dokumentit. Pak më poshtë.

22 PY. Shohim pjesëmarrësit, të pranishmit në këtë takim nga
23 delegacioni i shqiptarëve të Kosovës. E shihni veten këtu të
24 pranishëm?

25 PË. Po.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 25

1 PY. A ju kujtohet ky takim?

2 PË. Po.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë në
4 faqen tani DHT05852 të këtij dokumenti. Pak më poshtë, në fund
5 të faqes.

6 PY. Dhe aty shohim në ekran ku thuhet, Hashim Thaçi i cili
7 foli dhe përshkroi, përcaktoi tre objektivat kyçe të
8 delegacionit të shqiptarëve të Kosovës. Një prej tyre ishte
9 marrëveshja politike, e dyta ishte që marrëveshja të
10 garantohet nga NATO dhe Shtetet e Bashkuara dhe e treta ishte
11 krijimi i institucioneve demokratike në Kosovë pas
12 marrëveshjes, dhe e katërta, të sigurohej që kosovarët -
13 kalojmë në faqen tjetër - që kosovarët të kenë të drejtën të
14 vendosin për të ardhmen e tyre pas periudhës tranzitore.

15 Ajo që është e regjistruar këtu a është e saktë me atë që
16 ju kujtohet juve mbi atë që tha Hashim Thaçi gjatë këtij
17 takimi?

18 PË. Kjo ka ndodhur para 26 vitesh. Kam marrë pjesë në shumë
19 mbledhje, takime, nuk mund të më kujtohen saktësisht fjalët që
20 ju lexuat, por është, përputhet me atë që më kujtohet të ketë
21 thënë ai gjatë këtyre bisedimeve.

22 PY. Dhe pastaj, fjalitë më poshtë në raport, pra, në qoftë se
23 kemi regjistrimin e fjalëve të Ibrahim Rugovës. Z. Rugova
24 theksoi se:

25 "... delegacioni shqiptar kishte ardh në Rambuje për të

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 26

1 arritur një marrëveshje politike. Rugova theksoi se kosovarët
2 donin një marrëveshje e cila linte derën hapur për të ardhmen.
3 Duke pranuar problemet me sovranitetin, Rugova theksoi se
4 Kosova duhet të ketë sovranitetin së pari dhe pastaj
5 integrimin në bashkësinë ndërkombëtare më vonë. Shqiptarët e
6 Kosovës kërkojnë pavarësi, jo vetëm pavarësi por siguri për
7 popullin e tij. Diskutimi u përqendrua në Republikën Federale
8 të Jugosllavisë, e cila nuk ekzistonte më. Shpresa e tyre
9 ishte të shkonin përpara dhe jo prapa".

10 Është ky paragrafi në përputhje me atë që ju kujtohet
11 juve mbi qëndrimin e Presidentit Rugova sa i takon pavarësisë
12 së Kosovës?

13 PË. Po.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tani
15 në faqen e fundit të dokumentit DHT05854, paragrafi 13.

16 PY. Sekretarja Albright është shënuar këtu që të ketë thënë
17 pjesëtarëve të UÇK-së të delegacionit shqiptar si në vijim:

18 "Sa i takon Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, UÇK-ja,
19 Sekretarja theksoi se theksoi se grupet e tjera të armatosura
20 janë transformuar në parti politike dhe inkurajoi UÇK-në që të
21 bënte të njëjtën gjë. Ishte gjë shumë e ndershme të ishe një
22 lider i madh, udhëheqës i madh politik ashtu siç është të jesh
23 luftëtar i madh. Shqiptarët e Kosovës duhet të shohin
24 shembullin e Irlandës së Veriut dhe ta marrin si model. Sinn
25 Fein, që u nda vetë nga IRA. U bë pjesë e zgjedhjes jo

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 27

1 probleme".

2 Ju kujtohet Sekretarja Albright që inkurajoi pjesëtarët e
3 UÇK-së që të kthenin UÇK-në në parti politike siç kishte bërë
4 Sinn Fein që kishte dalë nga Ushtria Republikane Irlandeze?
5 PË. Po, më kujtohet që kjo është thënë nga ajo në atë kohë jo
6 vetëm kësaj që është shkruar në këtë kabllogram. Dua të
7 theksoj që për herë të parë atje që është shumë e rëndësishme,
8 kabllogramet nuk janë një transkriptim fjalë për fjalë. Janë
9 përshtypje të një zyrtari për politik i cili thekson atë që ai
10 vendosë të theksojë ose jo në transkripte.

11 Pra, më kujtohet, sa i takon asaj që më kujtohet është
12 fjala Gerry Adams dhe jo Sinn Fein. Pra, më kujtohet që ajo ka
13 thënë që ai mund të ishte Gerry Adams më shumë sesa Sinn Fein,
14 pra, më kujtohet që ajo ka përdorur fjalën Gerry Adams, duke
15 iu referuar Hashim Thaçit.

16 PY. Lidhur me këtë pikë -- në qoftë se mund të kontrollojmë
17 tani.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shfaqim në ekran dokumentin
19 1D277, ju lutem.

20 PY. Z. Rubin, ky është një version tjetër i artikullit tuaj
21 në *Financial Times*.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë tani
23 në faqen DHT05278. Dhe shohim më poshtë, paragrafi i dytë nga
24 fundi.

25 PY. Dhe në të këtë keni shkruar ju, pra:

1 "Albright u shpreh si në vijim: 'Shpresoj që të bëheni
2 Gerry Adams i Kosovës dhe të zgjidhni paqen përkundër
3 vazhdimit të luftës'."

4 Është kjo ajo që ju kujtohet që keni thënë?

5 PË. Po. Në vend që -- dhe jam i lumtur që e kam shkruar në
6 mënyrën siç më është kujtuar.

7 PY. A mund të na thoni me fjalët e tua se çfarë donte të
8 thoshte Sekretarja e Shtetit kur thoshte që uroj të jeni Gerry
9 Adams i Kosovës?

10 PË. Kjo kërkon që të jap një përgjigje më të zgjeruar.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

12 DËSHMITARI: Ne arritëm dhe ne nuk i njihnim mirë
13 shqiptarët e Kosovës, ashtu si përkundra boshnjakëve, për
14 shembull. Ne i njihnim disa prej tyre. Nuk kishim takuar asnjë
15 udhëheqës të UÇK-së, erdhi Madeleine Albright -- as Madeleine
16 Albright as unë. Pjesëtarët e tjerë të administratës kishin
17 takuar pjesëtarë të UÇK-së. Ne jo. Ne nuk kishim, nuk njihnim
18 UÇK-në në përgjithësi nuk kishim shumë njohuri. Ishte diçka
19 shumë e vogël në mendjen tonë, që nuk kuptohej mirë apo nuk
20 ishte një forcë e armatosur e rëndësishme. Pra, nga ajo që
21 kishim dëgjuar është kur dëgjuam që udhëheqësi i delegacionit,
22 atë që kishin zgjedhur si kryesues ishte nga UÇK-ja, ajo po
23 përpigjej të arrinte paqen në Rambuje për të ndaluar luftën që
24 po vazhdonte.

25 Dhe për të ndaluar luftën duhet të motivohen ata që kanë

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 29

1 një rol në pjesën ushtarake të ekuacionit, pra, përkundër z.
2 Rugova që luftonte për paqe por në mënyrë paqësore. Hashim
3 Thaçi ishte identifikuar me UÇK-në. Pra, ne e inkurajonim atë
4 që ai ta shihte këtë konferencë të paqes si mundësi për të
5 transformuar një grup të vogël njerëzish që kishin arritur në
6 pikën ku po përdornin dhunë apo mjete ushtarake për të arritur
7 objektiva. Ne donim t'i bindim që të mos bënë një gjë të
8 tillë. Ajo po përpiqej të bënte të kuptonin që nuk fitohet
9 Çmimi Nobel kështu, por paqja fitohet kështu, duke u
10 transformuar, njerëzit transformohen vetë. Dhe ne nuk e
11 njihnim atë, po përpiqeshim ta motivonim.
12 PY. Faleminderit, z. Rubin.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, kabllogrami i Shteteve
14 të Bashkuara, siç e përmenda, është pranuar përmes mocionit
15 për pranimin në prova jo gojore, do të kërkoja që t'i jepet
16 një numër i provës materiale. Dhe ky është DHT05848 deri në
17 DHT05854.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jepini një
19 numër, ju lutem.

20 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
21 e provës materiale 1D821.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

23 PY. Z. Rubin, në fjalët e tua ja në qoftë se mund të na thoni,
24 si keni ndërvepruar gjatë konferencës së Rambujesë?

25 PË. Edhe këtu do të më duhet të jap pak shpjegime. Pra, më

1 kujtohet takimi i parë që më duket është ai që ju sapo
2 përmendët që është e regjistruar në kabllogram. Dhe më
3 kujtohet që ai më njohu menjëherë përmes televizionit sepse
4 unë isha dhe si zëdhënësi i Departamentit të Shtetit dhe isha
5 shpesh në televizor, kryesisht për ata që ishin të interesuar
6 për atë që ndodhte në ish-Jugosllavi. Pra, ai më njohu. Dhe në
7 ato ditë kur dikush të njihte ata lëvizin, shprehin fizikisht,
8 shtrëngojnë dorën apo japin shenja fizike dhe znj. Albright e
9 vërejti këtë gjë që ai bëri kështu, që më njohu pra. Ajo ishte
10 shumë e zonja për marrëdhëniet njerëzore dhe më tha menjëherë,
11 "Jamie, bisedo me të. Njihu me të". Sepse unë s'e njihja.
12 Askush s'e njihte në fakt në Qeverinë e Shteteve të Bashkuara,
13 të paktën unë nuk e dija. Pra, ne donim të dinim pak më shumë
14 kush ishte udhëheqësi i delegacionit që ne donim të ishte në
15 favor të marrëveshjes së paqes. Pra, ajo më tha, "Njihu me të.
16 Dil me të. Ndhimje që të arrijë në vendimin e duhur".

17 Dhe kështu bëra. Gjatë atyre, besoj dy javëve, u përpoqa
18 të rri me të. Të kaloj kohë me të. U takuam në vende ku hanim,
19 jashtë. Pija ndonjë cigare, pra, dilnim jashtë, ecnim bashkë
20 dhe unë përpiqesha të njihesha me të, ta njihja. Në qeveri na
21 thonin do punosh me këtë person, ajo mendoi, znj. Albright, se
22 ishte e dobishme dhe unë i njihja pikëpamjet e saj, njihja
23 pikëpamjet e saj më mirë se askush tjetër edhe sot është e
24 njëjta gjë. Edhe ajo donte që unë të njihja atë, pra, që të
25 bëhesha koleg, mik, shok diplomatik.

1 Dhe kjo është arsyeja që kalova kaq shumë kohë me atë
2 atje.

3 PY. Si keni komunikuar me të?

4 PË. Në atë kohë Hashim Thaçi nuk fliste anglisht. Dhe kur
5 dikush nuk flet gjuhën, në ato rrethana përdoret shpesh gjuha
6 e trupit. Përdoren fjale që njihen në të gjitha gjuhët. Dhe
7 pastaj për të komunikuar siç duhet në nivel diplomatik kishim
8 përkthyes. Dhe besoj që ka pas momente kur përkthyesi i
9 Departamentit të Shtetit ishte me mua ose ndonjë person tjetër
10 që unë e njihja dhe që fliste të dy gjuhët ishte aty për të
11 bërë përkthimin.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, në qoftë se mund
13 të shfaqim në ekran tani dokumentin DHT05870 deri në DHT05874.
14 Edhe ky është pranuar përmes mocionit për pranimin e provova
15 jo gojore në vendimin e Trupit Gjykues F03467. Dhe kalojmë tek
16 tema.

17 PY. Pra, mban datën 25 shkurt 1999 dhe tema është raporti i
18 takimit të Sekretares Albright me delegacionin e shqiptarëve
19 të Kosovës në kështjellën e Rambujesë më 20 shkurt 1999.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë tani në faqen
21 2. Më poshtë shohim listën e të pranishmëve.

22 PY. E shikoni veten tuaj si i pranishëm në këtë takim?

23 PË. Po.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen 3 të dokumentit
25 në DHT05872, fillojmë në paragrafin 4.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 32

1 PY. Dokumenti raporton se Sekretarja Albright këmbëngulte me
2 delegacionin e shqiptarëve të Kosovës që të pranonin kushtet e
3 marrëveshjes edhe termat e Marrëveshjes së Rambujesë dhe po
4 citoj:

5 "Sekretarja kërkoi një vendim nga delegacioni shqiptar
6 për në orën 4:30 pasdite nëse ata do të pranonin marrëveshjen
7 e përkohshme të propozuar për zgjidhjen e konfliktit.
8 Shqiptarët nuk u angazhuan që do ta jepnin një gjë të tillë.
9 Përfundon këtu përmbledhja."

10 Dhe pastaj paragrafi i pestë thotë:

11 "Sekretarja informoi delegacionin e Shqipërisë se grupi i
12 kontaktit priste vendimin e tyre për marrëveshjen e përkohshme
13 të propozuar deri në orën 4:30 pasdite. Ajo shprehu shpresën
14 që kishte që vendimi që do të arrinin do të ishte pozitiv.
15 Paralajmëroi se në qoftë se nuk do të ishte kështu shqiptarët
16 do të ishin humbës pasi serbët ishin gati të refuzonin
17 marrëveshjen. Ajo theksoi se shqiptarët - dhe bota - kuptuan
18 efektin që do të kishte një veprim i tillë".

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen 3, ju lutem,
20 tani.

21 PY. Kemi përgjigjen e Thaçit këtu. Ku thotë:

22 "Thaçi kërkoi ndjesë për humbjen e kohës së Grupit të
23 Kontaktit, por delegacioni i shqiptarëve duhej të merrte
24 vendime të rëndësishme se nuk duhej të nxitoheshin, të ishin
25 të nxituara. Ai shpresoi se Shtetet e Bashkuara do ta kuptonin

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 33

1 këtë vonesë. Shqiptarët e Kosovës kanë qenë gjithmonë dhe do
2 të jenë gjithmonë me Shtetet e Bashkuara. Megjithatë, populli
3 i Kosovës duhet të jetë në gjendje që të shprehë gjykimin dhe
4 mendimin e tyre për sa i takon statusit pas skadimit të
5 periudhës së përkohshme tre vjeçare.”

6 Kjo përmbledhje në këtë kabllogram a është në përputhje
7 me atë që ju kujtohet juve nga ky takim i datës 20 shkurt
8 1999?

9 PË. Po

10 PY. Faleminderit.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të kërkoja që t’i jepet një
12 numër prove materiale dhe këtij dokumenti.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jepini një
14 numër prove materiale 05870 deri në 05874.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë provën
16 materiale 1D282.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

18 Znj. Sekretare, mund të na shfaqni në ekran tani, ju
19 lutem, DHT04047 deri në DHT04051.

20 PY. Z. Rubin, ky është artikulli i *New York Times* i 23
21 shkurtit 1999. Pyetja ime e parë është autori duket të jetë
22 Jane Perlez. E njihni autorin e këtij artikulli?

23 PË. Po.

24 PY. Si e njihni këtë?

25 PË. Ajo ka qenë korrespondentja për çështje diplomatike për

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 34

1 *New York Times*, pra, që mbulonte çështjet e Sekretares së
2 Shtetit dhe kjo ishte puna ime që ta njihja atë.
3 PY. A keni komunikuar me atë gjatë kohës që ishit në Rambuje?
4 PË. Po, por jo shumë shpesh.
5 PY. Artikulli raporton se delegacioni i shqiptarëve të
6 Kosovës kishte refuzuar lutjet e bëra nga Sekretarja Albright
7 dhe gjenerali Clark.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se kalojmë në faqen 2,
9 paragrafi i dytë në ekran.

10 PY. Thuhet:

11 "Objektivi kryesor i guerilëve duket të jetë --
12 kundërshtimi kryesor i guerilëve duket të jetë mungesa e
13 fjalës 'referendum' në dokumentin politik të propozimit të
14 pages edhe pse drafti kërkon një konferencë ndërkombëtare për
15 të vlerësuar 'vullnetin e popullit' në fund të një periudhe të
16 ndërmjetme tre vjeçare. Një referendum për pavarësinë ka qenë
17 një thirrje tubuese e grupit guerilë."

18 A është kjo, a përputhet kjo me atë që ju kujtohet juve
19 që gjatë këtyre bisedimeve?

20 PË. Po, më kujtohet që ajo është thjesht duke marrë
21 përshtypjet nga kjo. Nuk është pjesë e bisedimeve. Nuk është
22 gjithmonë e saktë. Përpiqet të jetë e saktë, por ne nuk po
23 komunikojmë saktësisht, nuk kemi komunikuar saktësisht atë që
24 ndodhte gazetës *New York Times* sepse këto janë bisedime për
25 paqe dhe ata përpiqen të marrin informacion.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 35

1 Përshkrimi është pjesë e problemit, po ajo ndoshta e ka
2 ekzagjeruar atë.

3 PY. Artikulli raporton se z. Thaçi nuk fliste serbisht. A e
4 dini nëse z. Thaçi fliste serbisht apo ka folur serbisht në
5 atë kohë?

6 PË. Nuk e di, po e di që nuk dinte anglisht.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Paraqes këtë artikull për t'u
8 pranuar si provë.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
10 kundërshtim?

11 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT04047 deri
13 në 04051 pranohet. Jepini një numër.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Tani ky do të marrë
15 numrin e provës materiale 1D283.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, tani do të flas për
17 një temë që do të kërkojë më shumë kohë. Nuk e di nëse
18 dëshironi të bëni pushimin tani?

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do marrim
20 dhjetë minuta pushim dhe do kthehemi pas dhjetë minutash. Ju
21 lutem mos bisedoni me askënd lidhur me dëshminë tuaj, me
22 askënd jashtë sallës së gjyqit. Duhet t'jua kujtoj këtë disa
23 herë, kini durim.

24 Mund të largoheni nga salla.

25 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 36

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
2 ndërpritet deri në 10.10.

3 --- Seanca ndërpritet në orën 09.58

4 --- Seanca rifillon në orën 10.10

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] I lutem
6 Sekretares të sjellë dëshmitarin në sallë.

7 Z. Misetic, a kishit diçka për të thënë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, do vazhdoj me pyetjet.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendova se
10 kishit diçka për të thënë meqë, mbase donit të mbanit ndonjë
11 ligjëratë.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk është koha.

13 [Dëshmitari vijon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

15 Z. Dëshmitar, do të vijojë z. Misetic me pyetjet e veta.

16 Vazhdoni.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Z. Rubin, në paragrafin 24 të deklaratës suaj, thoni që
19 në një moment z. Thaçi iu tregoi se ishte i shqetësuar se nuk
20 kishte autoritet të plotë për të firmosur në emër të UÇK-së pa
21 miratim.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretarisë të vendosë në
23 ekran provën numër -- më falni, provën me numër 1D27 -- 279.

24 PY. Z. Rubin, ky është një artikull i gazetës *Financial*
25 *Times*, është libri juaj dhe e kemi diskutuar në deklaratën

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 37

1 tua.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të vendoset në ekran më
3 konkretisht faqja me numër SPOE00229721.

4 PY. Në këtë faqe, në krye të faqes, këtu flet Sekretarja
5 Albright në krye të faqes:

6 ``Ti personalisht'', thotë ajo,

7 ``Do të jesh'', --

8 Pra po i drejtohet z. Thaçi, ë:

9 ``Ti personalisht do jesh përgjegjës për vdekjet e
10 njerëzve të tu, nëse nuk ndërron mendje. Liderhipi është për
11 të marrë vendime të vështirë. E di se e ke shumë të vështirë
12 të heqësh dorë nga pavarësia. Por, nëse nuk pranon nuk do ta
13 kesh përkrahjen e perëndimit. Do ta rrezikosh miqësinë me mua
14 dhe me z. Rubin. Nuk ke miq, nuk ke miq më të mirë se mua e
15 Rubini në perëndim. Por, kështu ne nuk mund të të ndihmojmë që
16 të dëshpërosh popullin shqiptar.'''

17 Më pas vijoni:

18 ``Thaçit sa nuk i shpëtonin lotët. Ai kurrë më parë nuk
19 kishte takuar ministra të jashtëm, e le më një sekretare
20 amerikane të zëmëruar. Ai i tha asaj se si vetë kishte qenë
21 dëshmitar i vdekjeve të shokëve të tij më të ngushtë dhe
22 krimeve të kryera kundër grave, fëmijëve dhe të moshuarve. Ai
23 ishte i vetëdijshëm se cilat do të ishin pasojat. Për disa
24 momente ai nuk mund të fliste. Pastaj, duke u ndrequr pak,
25 duke ndrequr qëndrimin, tha se i vinte keq, por përgjigja

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 38

1 ishte 'jo'..."

2 Pyetja ime është e parë, kjo: A është kjo e vërtetë dhe e
3 saktë me aq sa ju kujtohet ju?

4 PË. Po.

5 PY. A është e vërtetë se z. Thaçi ishte gati sa -- ishte gati
6 të qajë gjatë komunikimit me Sekretaren -- Sekretaren
7 Albright?

8 PË. Kjo është përshtypja ime.

9 PY. Vazhdojmë në faqen më tej, më thotë:

10 "Kur Hashim Thaçi la dhomën e tij natën e fundit në
11 Rambujejit, Madeleine Albright mblodhi ekipin e saj për takim.
12 Ai ishte e zbehtë. Konferenca po shndërrohej në një
13 katastrofë. Pas analizimit të kësaj situate të pashpresë
14 Albright u kthye me automjet në Paris për të fjetur disa orë.
15 Atë natë bëra një shëtitje të gjatë me Thaçin. Jashtë ishte
16 ftohtë, por ai e refuzoi ofertën time për t'i dhënë pallton.
17 Ishte i shqetësuar. Tha se ishte nën presionin komandantëve të
18 UÇK-së në Kosovë dhe financuesve të saj nga Evropa. Ata do ta
19 konsideronin tradhtar. Ai e ndjente se po ta humbte Albright
20 si mik, kjo do të ishte një katastrofë e vërtetë për kauzën e
21 tij."

22 Kjo pjesë mesa ju kujtohet ju, ky komunikim me z. Thaçin,
23 a është i vërtetë?

24 PË. Po.

25 PY. Më konkretisht, a ju tha z. Thaçi se nuk mund ta

1 firmoste, nënshkruante marrëveshjen sepse ishte nën presion,
2 në presionin e komandantëve të UÇK-së dhe financuesve nga
3 Evropa dhe se do ta konsideronin tradhtar po ta nënshkruante?
4 PË. Po.

5 PY. A mund ta shtjelloni pak me fjalët tuaja, si ishte kjo
6 bisedë? Si ndodhi kjo bisedë?

7 PË. Po. Ideja ishte që nuk mund të bëheshin deklaratata
8 specifike për pavarësinë dhe ky ishte thelbi i diplomacisë,
9 pikërisht për këtë po diskutohej në Rambuje. Ne donim që të
10 mbledhej gjithë bota bashkë, jo Shtetet e bashkuara, por
11 shtetet evropiane, madje dhe Rusia, që ishte pjesë e këtyre
12 negociatave. Ka qenë moment unik ky në histori, kur shtetet e
13 mëdha, sikurse ishin atëherë, po përpuqeshin të parandalonin
14 një masakër për ta bërë këtë. Ne donim që fuqitë e mëdha të
15 punonin së bashku. Jo vetëm Shtetet e Bashkuara, sepse
16 ndonjëherë na duhej ta bënim punën vetëm, por Madeleine
17 Albright donte sa më shumë unanimitet mes fuqive të mëdha.

18 Edhe ndihmën e Rusisë. Rusia ishte në favor të dëshirës
19 serbe për të mos pasur deklaratata pavarësie të përkthyer në
20 një dokument. Ne nuk kishim ende ndonjë qëndrim të qartë sa i
21 takon pavarësisë. Ne na duhej një kompromis, një veprim
22 diplomatik, një përpjekje që të kalonim në fazën e radhës ku
23 të kishim gjithë botën në anën tonë, që t'i mbushnin mendjen
24 serbëve që të pajtoheshin me marrëveshjen e pages. Ai na tha
25 që nuk mund të na thoshte ne, por, pa pasur një deklaratë

1 specifike për pavarësinë, sepse ai duhet të diskutonte me
2 komandantët e UÇK-së, ideologjia për pavarësi -- pra, personat
3 -- personat që kërkonin pavarësinë e Kosovës ishin
4 maksimalistë, i donin të gjitha. Donin çdo gjë të mundshme.

5 Sigurisht që diplomacia nuk mund të jetë gjithmonë
6 perfekte. Ne përpiqeshim që të gjenim një të mesme të artë që
7 të mos i thonin as po, as jo pavarësisë në atë dokument.
8 Kështu që ne thamë "mund të shprehni vullnetin e popullit pa e
9 bërë të qartë dhe pa e thënë specifikisht fjalën 'pavarësi'.
10 Ai na tha, "Po nuk përdora fjalën 'pavarësi' atëherë mua do të
11 më konsiderojnë si person që ka hequr dorë nga pavarësia e
12 vendit". Pra, ishte moment shumë i vështirë.

13 Edhe ai na shpjegoi se nuk ishte përgjegjës për këto. Ai
14 ishte thjesht personi që po komunikonte me ne sepse kishte një
15 rol politik në UÇK, por jo një rol udhëheqës. Nuk kishte
16 kompetenca, nuk kishte autoritet. Ai ishte thjesht pasqyrimi i
17 një lëvizje dhe shumë persona në atë lëvizje donin pavarësi
18 tani. Ose më së paku, të shprehej në dokument, të konfirmohej
19 në dokument se do të realizohet pavarësia.

20 Ideja ishte si t'i kënaqim të gjithë. Dhe mënyra e vetme
21 për ta bërë këtë ishte që të kishim një dokument të vagullt sa
22 i takon pavarësisë. Ai këtë nuk mund ta pranonte, sepse atij i
23 kishin thënë "Nëse e bën këtë", siç na tha dhe me fjalët e
24 veta, "do të ishte një tradhtar". Ne u përpoqëm të gjenim një
25 zgjidhje, të gjenim një pajtim për këtë.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem Sekretarisë të vendosë në
2 ekran materialin DHT05884 deri në DHT05884.

3 PY. Z. Rubin, kjo është një incizim, një video i BBC-së,
4 "Rënia e Miloshevishit", është një dokumentar. Ju lutem
5 dëgjojeni këtë fragment, ju lutem, që do të shohim në video.

6 [Luhet videoincizimi]

7 "Ministri i jashtëm -- ministrat e jashtëm u ulën në një
8 tavolinë të gjatë sikurse të ishim -- sikur të na gjykonin apo
9 diçka të tillë. Dhe fillimisht erdhi Thaçi me disa anëtarë të
10 tjerë të delegacionit shqiptar. Pyetja në thelb ishte a
11 pajtoheni me kornizën, po apo jo. Dhe ne po prisnim një po.
12 Ose të paktën unë. Unë thashë, 'Shiko, nuk e kuptoj çfarë
13 ndodhi këtu, na zhgënjeve atje. Është një situatë e pamundur.
14 Si mund të presësh -- si mund ta bësh këtë, ne po prisnim që
15 ti të ishe një udhëheqës këtu'.

16 "Mrs. Albright --

17 "... nënshkruani, serbët nuk nënshkruajnë, ne do të, ne
18 do të bombardojmë. [E padëgjueshme] po që se ju nuk
19 nënshkruani, serbët e pranojnë, ne kemi duart e lidhura.

20 "Mund ta shihje se ishte i tronditur, dukej si një
21 student që e kisha ndëshkuar."

22 Z. MISETIC: [Përkthim]

23 PY. Z. Rubin, kjo që thotë Sekretarja Albright dhe z. Thaçi
24 për takimin, a përputhet me mënyrën si e keni kuptuar ju si ka
25 qenë atmosfera asokohe, mënyra se si iu drejtua znj. Albright

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 42

1 z. Thaçi kur ai nuk pranoi të nënshkruante?

2 PË. Po.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, z. Kryegjykatës, të
4 pranohet kjo video si provë gjyqësore.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
6 kundërshtime?

7 Z. PACE: [Përkthim] Më falni, doni të pranohet e gjithë
8 videoja apo vetëm ky fragment?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] jo, të gjithë videon, ju lutem.

10 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 Materiali me numër DHT05884-05884 pranohet. Do të marrë numrin
13 e provës.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument do të marri
15 numrin e provës 1D284.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

17 PY. Z. Rubin, në deklaratën tuaj në paragrafët 26 dhe 27 ju
18 shpjegoni se ka patur një raund të dytë bisedimesh në Paris,
19 dhe delegacioni shqiptar i Kosovës, në fakt, më në fund e
20 nënshkroi marrëveshjen më 18 mars 1999.

21 Do t'ju tregoj një dokument që tani është pranuar si
22 provë gjyqësore përmes një mocioni për provat jогоjore,
23 përkatësisht është pranuar nga Trupi Gjykses në dokument -- në
24 parashtrimin e protokolluar F03467.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Dokumenti në fjalë ka numrin

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 43

1 DHT05883, DHT0588 [Sipas përkthimit].

2 PY. Z. Rubin, çfarë shohim në këtë fotografi?

3 PË. Këtu jemi në Paris, është momenti i nënshkrimit nga
4 delegacioni shqiptar i Kosovës në Rambuje.

5 PY. Njihni ndonjë nga personat në fotografi?

6 PË. Njoh shumicën e personave që janë ulur tek tryeza, Chris
7 Hill, shoh. Shoh negociatorin rus, shoh negociatorin e
8 Bashkimit Evropian këtu.

9 PY. Faleminderit.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj që të pranohet edhe kjo
11 fotografi dhe të marri numrin përkatëse.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt kjo
13 është pranuar si dokument. Ju lutem, jepini një numër.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Ky dokument, kjo
15 fotografi, pra, do të marrë numrin 1D285.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

18 PY. Z. Rubin, gjatë raundit të dytë të bisedimeve në Paris, a
19 patët shans të flisnit sërish me z. Hashim Thaçi?

20 PË. Po.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua t'ju tregoj sërish një
22 dokument që mban numrin 1D279. Shkojmë në faqen SPOE00229726,
23 ju lutem. Në paragrafin e parafundit, ju lutem, në anglisht.

24 PY. Këtu keni thënë kështu - është i *Financial Times*, është:

25 "Gjatë drekës luksoze franceze dhe një shëtitje në

1 kopshtin e Ambasadorit *after* [Sipas përkthimit] Champs
2 Elysees, Thaçi më tregoi versionin e tij për atë ç'kishte
3 ndodhur në të vërtetë në kështjellën e Rambujesë. Gjatë atij
4 intervali prej tri javësh, në lidërshtipin e UÇK-së kishte
5 pasur një përçarje. Meqë një grup i vogël ekstremistësh
6 këmbëngulte për pavarësisë, por shumica dërmuese donin të
7 përqafonin NATO-n dhe perëndimin. Shumica fitoi, ndërsa ata që
8 kundërshtuan u përjashtuan nga vendimmarrjet në të ardhmen."

9 Kjo që keni treguar ju këtu, bisedimi juaj me z. Thaçi në
10 Paris, a është një pasqyrim i saktë i asaj që iu ka thënë z.
11 Thaçi asokohe me aq sa ju kujtohet ju?

12 PË. Po.

13 PY. Gjatë komunikimeve me z. Thaçi, gjatë konferencës në
14 Rambuje dhe në Paris, a t'u krijua përshtypja se çfarë
15 autoriteti kishte z. Thaçi në UÇK?

16 PË. Po.

17 PY. Çfarë përshtypje ju krijua ju?

18 PË. Do të them dy gjëra për këtë. Një, ka qenë një mjedis me
19 shumë presion. Kam qenë në mjedise të ngjashme në jetën time
20 lidhur me shumë aspekte. Kjo ka qenë situata më e vështirë që
21 më kujtohet mua, sepse fati i një milion personave ishte në
22 fjalë. Nëse NATO-ja do të përqafonte perëndimin -- më falni,
23 më falni, desha të thoja nëse lëvizja kosovare nëse ata do të
24 përqafonin perëndimin, perëndimi do të ishte pro tyre.

25 Përndryshe do të kishte masakër, dhe ne kishim parashikuar

1 masakër ku do të vdisnin me qindra, mijëra persona. Dhe kjo
2 krijoi një situatë shumë të tensionuar.

3 Përshtypja ime asokohe ishte që ai ishte një person që
4 ishte i caktuar detyra të komunikonte me ne nga udhëheqja
5 kosovare siç ishte asokohe. Ne nuk e kishim kuptuar mirë se si
6 funksiononte struktura udhëheqëse, por e kishim të qartë që ai
7 nuk kishte autoritet, as nuk kishte mundësi të diktonte asgjë,
8 por thjesht pasqyronte vendimet që merreshin nga ajo zyra diku
9 e fshehur, ajo zyra e udhëheqjes shqiptare, që po merrnin
10 vendime në grup që nuk ishin gjithmonë të pranishëm, kështu që
11 ai duhet ta merrte lejen prej tyre. Ai nuk kishte vetë
12 mundësi. Nuk ishte në gjendje të diktonte rregulla dhe kushte.
13 Kështu që kur ne duhet të donim të bënim diçka shumë të
14 rëndësishme atij -- ai duhet të komunikonte me persona të
15 tjerë që t'i jepnin miratimin.

16 Dhe ky moment kaq i vështirë që po përshkruaj unë çoi dhe
17 në këtë përçarje, sepse kishte persona, që unë i quaja
18 ekstremistë, dhe këta ekstremistë i donin të gjitha, i donin
19 tani. Edhe të vendosnin në rrezik të gjithë popullin e tyre
20 për shkak të kësaj. Thjesht për çështje formulimi në dokument.
21 Por kishte dhe persona që ishim më praktikë, siç ishte dhe z.
22 Hashim Thaçi. Dhe humbën betejën, sepse ne i bindëm, e bindëm
23 delegacionin e shqiptarëve të Kosovës që këto sqarime dhe
24 çështjen e pavarësisë ta sqaronim, pavarësinë ata do ta
25 kishin, u thamë, "Do ta keni pavarësinë, por fillimisht

1 shpëtoni njerëzit, shpëtoni popullin”.

2 Dhe përshtypja ime për Hashimin, për Hashim -- për
3 pushtetin e Hashim Thaçit ishte që ai thjesht mund të
4 pasqyronte vendimmarrjen. Kështu që kur shumica vendoni të
5 përqafonte NATO-n dhe perëndimin, atëherë ekstremistët humbën,
6 u mënjanuan, dhe ai më pas mund të vinte dhe u bashkua me
7 pjesën tjetër të grupit për nënshkrimin e dokumentit. Pra,
8 përshtypja ime ishte që ai ishte thjesht një pasqyrim i
9 udhëheqjes apo lëvizjes udhëheqëse të asaj kohe, por jo
10 personi përgjegjës në atë lëvizje.

11 PY. Faleminderit.

12 Z. Rubin, dua të shohim tani paragrafin 68 dhe 69 të
13 deklaratës suaj ku shpjegoni se në qershor të '99-s Sekretarja
14 Albright u takua në Gjermani me Hashim Thaçin, Ibrahim Rugovën
15 dhe Rexhep Qosen dhe i inkurajoi që të organizonin strukturën
16 e tyre politike dhe të përpigeshin të organizonin një
17 organizatë civile. Në paragrafin 69 thoni që ishte e qartë që
18 Sekretarja Albright e kishte fjalën për Qeverinë e Përkohshme
19 të Kosovës.

20 Ju thoni:

21 “Ne duhet të punonim me një organizatë të unifikuar. Ne
22 nuk donim, sidoqoftë, të njëhej, sidoqoftë, si një shtet
23 sovran, prandaj dhe formulimi ato kohë mbeti aq i vagullt.”

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Për këto do t'ju tregoj një
25 dokument që ta shohim më konkretisht. Është dokumenti

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 47

1 SITF00011863 deri në SITF0011870 [Sipas përkthimit].

2 PY. Z. Rubin, ky është një raport i OSBE-së që mban datën 1
3 qershor 1999.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në faqen SITF00011866, ju
5 lutem. Tek pjesa II, ku thuhet "Marrëdhëniet Ndërkombëtare",
6 fillojmë me paragrafin, "Me datën 19 maj ..."

7 PY. Thuhet kështu:

8 "Më 19 maj, Kryeministri Britanik Blair pasi takoi
9 Krasniqin dhe përfaqësues të tjerë të UÇK-së në Tiranë, iu
10 bëri thirrje të gjitha forcave politike në Kosovë të
11 bashkoheshin, bazuar në marrëveshjen e Rambujesë, si
12 ndërveprues të besueshëm për komunitetin ndërkombëtar.
13 Udhëheqësi i UÇK-së, Thaçi, mbërriti në Tiranë më 21 maj dhe
14 lëshoi një letër publike ku ftonte Rugovën t'i bashkohej atij
15 dhe drejtuesve të tjerë politikanë kosovarë për të biseduar së
16 bashku.

17 Pyetja ime është kjo: Këto mesazhe që i ka -- këto
18 thirrje që ka bërë Kryeministri Blair edhe Albright drejtuesve
19 të Kosovës dhe Qosjes, Kosovës dhe Rugovës, a kanë ngjashmëri,
20 pra, këto dy mesazhe me njëri-tjetrin?

21 PË. Po.

22 PY. Çfarë janë ngjashmëritë mes këtyre dy thirrjeve apo
23 mesazheve?

24 PË. Edhe një herë, ne kur themi "ne", themi Mbretëria e
25 Bashkuar, Shtetet e Bashkuara që ishim dhe shtetet kryesore që

1 e drejtonim këtë proces, Kryeministri Blair, punonte me
2 Presidentin Clinton dhe Sekretaren Albright, ne ishim sinkron
3 me njëri-tjetrin, ne ishim një linjë, dhe ne donim që ata ta
4 bënim sa më të lehtë punën për ne, që ne të punonim së bashku.
5 Dhe po përpiqeshim që ata të vepronin në mënyrë të unifikuar
6 për atë që ishte e mundur. Prandaj -- prandaj iu bëhej
7 thirrje të punonin së bashku, por nuk donim t'ju jepnim --
8 t'ju jepnim sinjale se mbështesnim pavarësinë. Nuk deshëm t'ju
9 thonim që jeni një komb i pavarur me një qeveri të pavarur
10 sepse kjo do të dëmtonte unitetin e komunitetit ndërkombëtar,
11 se vetë komuniteti ndërkombëtar s'ishte pajtuar për këtë dhe
12 s'ishte e mundur, s'ishte shtet i pavarur, s'e kishte
13 qeverinë, dhe ishim -- kishim merak se mos duke mos pasur
14 strukturë fare, kjo -- në fakt, do të ishte e vështirë, do të
15 duhej një grup që të merrte vendimmarrje.

16 Ne duhet të kishim disa pika kontakti që të realizonim
17 disa aspekte. Dhe kjo nuk ishte, dhe ai po thoshte të njëjtën
18 gjë sikurse dhe ajo. Prandaj dhe Kryeministri Blair thoshte,
19 "Punoni së bashku, unifikohuni, duhet të jeni -- duhet të
20 respektoni kushtet e Rambujesë, që e nënshkruat në fund të
21 fundit, po as mos e përdorni fjalën lojtar, Clinton -- më
22 falni, Blair, Clinton apo Albright. Mos thoni që ne kemi dhënë
23 mbështetje të qartë për pavarësi".

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky dokument është pranuar nga
25 Trupi Gjykses përmes mocionit për provat jогоjore dhe do ju

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 49

1 lutesha t'i jepni një numër të provës materials.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, i
4 caktohet numri i provës 1D0286.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

7 PY. Në deklaratën tuaj, duke filluar nga paragrafi 28, ju
8 shpjegoni që jeni kthyer në Kosovë në qershor të vitit 1999
9 për të marrë pjesë në negociatat që kishin të bënin me
10 demilitarizimin e UÇK-së. A është e saktë kjo, Dëshmitar?

11 PË. Po.

12 PY. A ishte ngritur ndonjë problem që kërkohej ose ishte e
13 nevojshme pjesëmarrja juaj në këtë bisedë?

14 PË. Po.

15 PY. A mund të na thoni çfarë problemi ekzistonte, ku
16 qëndronte problemi?

17 PË. Në atë kohë lufta ishte drejt fundit. Gjenerali britanik
18 Mike Jackson po bënte planin e tërheqjes së forcave serbe nga
19 Kosova. Ai ishte komandanti i forcës së re të quajtur KFOR, që
20 ishte negociuar nga -- në nivelin më të lartë të mundshëm. Kam
21 përshtypjen që Yeltsin dhe Bill Clinton e kanë negociuar vetë
22 këtë marrëveshje. Domethënë, Evropa, Shtetet e Bashkuara, të
23 gjithë ishin të unifikuar sa i takon qëndrimit për të pasur
24 një forcë të unifikuar. Ishte shumë e komplikuar që të ishin
25 të përfshirë dhe rusët. Megjithatë, pra, do të thoja që kishin

1 një lloj shpjegimi për Mike Jackson, për gjeneralin Jackson
2 për sa i takon menaxhimit të tërheqjes serbe, por më tej ai
3 thoshte që, "Unë dua që të vendos forcat e mia vetëm në ato
4 mjedise që ishin të 'lejueshme'", dhe ky mjedis i lejueshëm
5 kërkonte që UÇK-ja të demilitarizohej. Domethënë, ideja ishte
6 që forcat ndërkombëtare të gjeneralit Jackson nuk donin që të
7 kishin debate ose diskutime me forcat çlirimtare të Kosovës.

8 Ajo çfarë ishte unike për të, ishte që për ta ishte vetëm
9 një luftë, por ndërkohë që sipas pikëpamjes tonë ne mendonim
10 që ata ishin lojtarë i vogël. Megjithatë, ata mendonin që
11 ishin, pra, ushtria çlirimtare. Pra, nuk -- e vërteta dhe ajo
12 çfarë ishte më e rëndësishme ishte që Milosheviqi u pajtua që
13 të tërhiqej dhe ne si hap pasardhës na duhej na duhej që të
14 ndihmonim në demilitarimin e UÇK-së dhe duhej që të takoheshim
15 me komandantët në terren.

16 Neve na u tha që kishte biseda në vijim e sipër ndërmjet
17 ushtarakëve britanikë dhe përfaqësuesve të UÇK-së, pra,
18 bisedat ishin drejt fundit, megjithatë, nuk kishin arritur
19 akoma në një marrëveshje midis palëve, dhe pastaj kur
20 përfunduan negociatat në -- pra, britanikët u hasën me emrin e
21 Hashim Thaçit, pra, që komandantët e UÇK-së dëshironin që
22 përfaqësuesi politik i tyre të nënshkruante këtë marrëveshje.
23 Dhe Sekretarja Albright menjëherë pas zhvillimeve të tilla
24 tha, "Po ku është Jamie? Se Jamie, mbase do të ishte mirë që
25 të shkonte të takonte z. Thaçi për shkak të marrëdhënies që

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 51

1 kishim ne të dy, dhe të historikut tonë të përbashkët".

2 Kjo ishte puna ime normale ose e zakonshme, sepse unë
3 isha zëdhënësi i znj. Albright. Po punoja për çështjet e
4 Kinës, të Rusisë. Dhe ajo më tha, "Ndalo së bëri çdo gjë që
5 t'i po bën, dhe duhet të shkosh në Kosovë. Duhet të shkosh
6 atje në menyrë të tillë që të ndihmoni Mike Jackson që të
7 realizojë objektivat e veta. Dhe po ashtu, sigurohu që Hashim
8 Thaçi të nënshkruajë marrëveshjen". Kjo është arsyeja që pse
9 shkova unë në rajon.

10 PY. Sa qëndruat në Kosovë ju asokohe?

11 PË. Nuk më kujtohet ekzaktësisht. Por, mbase tre ditë, katër
12 ditë. Nuk është se kam qëndruar në Kosovë, në fakt, kam
13 qëndruar në një hotel në Shkup, në Maqedoni, dhe çdo mëngjes
14 dërgohesha përmes mjeteve të posaçme në male për t'u takuar me
15 Hashim Thaçi dhe komandantët faktikë të UÇK-së. Pra, çdo ditë
16 më çonin dhe më merrnin nga aty.

17 PY. A ju kujtohen datat?

18 PË. Ka qenë diku nga fundi i qershorit të 1999-s.

19 PY. Z. Rubin, Do t'ju tregoj një video tani.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretar, për procesverbal,
21 video që kërkoj që të shfaqet tani është me numrin DHT087008
22 deri në 01, që fillon në minutën 09:58 dhe vazhdon deri 09:18.
23 Transkripti ka numrin 087088-01-TR E Rishikuar-ET në anglisht
24 dhe 087008-01-TR E Rishikuar në shqip. Janë dokumente të cilat
25 janë të pranuar si mocione jогоjore. Për tani, do i kërkoj

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 52

1 Sekretares që të thjeshtë të transmetojë videon.

2 [Luhet videoincizimi]

3 "Më pas, siç e kam kuptuar, Hashimi ishte" --

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Ndaloni këtu.

5 PY. Z. Rubin, a e njihni ndonjë person në këtë sekuencën e
6 videos që patë?

7 PË. Po.

8 PY. Kë njohët?

9 PË. Veten dhe Hashim Thaçin.

10 PY. A dëgjuat çfarë thatë ju me zërin tuaj në video?

11 PË. Po.

12 PY. Në transkript thuhet që:

13 "... mesa kuptoj unë, Hashimi do ta nënshkruajë atë."

14 A e keni idenë se për çfarë e keni fjalën këtu.

15 PË. Po. E kam fjalën për marrëveshjen e demilitarizimit.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Të kalojmë para në video. Do i
17 kërkoja Sekretares që të vazhdojë me videon.

18 PY. Ndërkohë, data që është në video është 19 qershor 1999. A
19 e dini në qoftë se kjo është datë e saktë, apo jo?

20 PË. Më duket sikur është e saktë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, do ju kërkoja që
22 t'i caktonit një numër prove materiale kësaj video që është
23 pranuar.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është pranuar
25 sipas provave jogojore. Do të doja t'i kërkoja Sekretares të

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 53

1 caktojë një numër prove për këtë video.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është numri i provës
3 1D287.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Këtu përfshihet
5 video dhe transkripti?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

8 PY. Z. Rubin, a mund të na e thoni me fjalët e tua, se si u
9 realizuan negociatat për demilitarizimin. Çfarë zhvillimi ka
10 pasur në kohën kur mbërritët ju në Kosovë sa i takon
11 negociatave të demilitarizimit?

12 PË. Po.

13 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj, I nderuar Gjykatës. Kjo
14 është një çështje e cila është mbuluar në deklaratën sipas
15 rregullit 154. Ka dhe çështje të tjera të cilat janë të
16 tërthorta që janë mbështetur aty dhe mbështeten te rregulli
17 154, kështu që neve kundërshtojmë që t'i përgjigjet dëshmitari
18 kësaj pyetje. Në qoftë se avokati dëshiron që të bëjë në
19 pyetje që është më konkrete, mund të vijojmë me të.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendojmë që
21 në shënimin përgatitor ne kemi dhënë informacion shtesë,
22 kështu që besoj që duhet që të na lejohet që të vazhdojmë me
23 pyetjen e radhës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
25 kundërshtimi.

1 Ju lutem, vazhdoni, Dëshmitar.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Kjo ishte një negociatë e
3 pazakontë për shkak të vendimmarrjes të palës tjetër, gjë e
4 cila ishte shumë e paqartë në kohën kur mbërrita unë atje. Ne
5 duhej që të pasqyronim pikëpamjet e të gjithë anëtarëve të
6 NATO-s dhe të gjithë anëtarëve të botës që merrnin pjesë në
7 KFOR. Domethënë, pas nesh ne kishim shumë shtete, të cilat
8 duhet t'i përfaqësonim dhe nga ana tjetër kishim këtë
9 strukturën e UÇK-së që nuk e kuptonim shumë mirë, ose
10 plotësisht, edhe askush nuk e kuptonte mirë atë strukturë.
11 Ishte si një strukturë që nuk ishte shumë mirë e organizuar,
12 por nga ana tjetër ishte e nevojshme që ne të përmbushnim
13 kërkesat e komandantëve që ishin në terren, sepse në një
14 situatë ushtarake, komandanti në terren ka shumë kompetencë
15 dhe ajo çfarë po kërkonim ne ishte demilitarizimi i UÇK-së.
16 Kur mbërrita unë forcat ushtarake britanike kishin punuar
17 me UÇK-në, domethënë, me komandantët që ishin në dhomë, në
18 sallë. Unë këta persona nuk i kisha takuar asnjëherë. Mendoj
19 ishin 12, 15 ose deri në 16 persona të llojeve të ndryshme, të
20 cilët dukeshin sikur ishin komandantë të sektorëve, ose të
21 paktën mua mu tha që ishin komandantë të sektorëve. Dhe këta
22 ishin persona në një moshë më të thyer. Ishin persona rreth të
23 50-ave ose pak më të vjetër. Ndërkohë që Hashimi ishte shumë i
24 ri, ishte 30 vjeç, ishte ngjashëm me mua. Ishte një person i
25 cili edhe në pamje dukej shumë i ri. Dhe ishte e qartë që ai

1 nuk ishte person përgjegjës. Ai nuk kishte njohuritë, nuk
2 kishte aftësitë apo as edhe kompetencën për të marrë vendime,
3 në asnjë formë ose në asnjë trajtë, me aq sa di unë.
4 Megjithatë, ajo çfarë kishte ai ishte dëshira për të
5 nënshkruar marrëveshjen. Dhe unë këtë e përktheva si një lloj
6 roli të ministrit të jashtëm, ose rol politik, në qoftë se
7 mund ta shprehja kështu.

8 Ndërkohë, përditë ne diskutuam, duhej që të ndryshohej
9 formulimi, duhet që idetë të përktheheshin në gjuhë të
10 shkruar, në fjalë. Ata donin që të kishin nivelin maksimal të
11 një force ushtarake, ndërkohë që ne donim që të eliminonim ose
12 të ulnin në minimum forcën ushtarake sepse këtë na kishte
13 kërkuar gjenerali. Dhe sa i takon ndryshimit të formulimit dhe
14 të fjalëve kjo është bërë nga komandantët në lidhje dhe në
15 bashkëpunim me ushtarakët britanikë në shumë raste kur
16 formulimi duhej të ndryshonte, kur fjalët duhej të ndryshonin.
17 Dhe ndonjëherë, Hashim Thaçi mua më jepte pikëpamjet e fundit
18 të tyre ndërkohë që unë i shikoja ato pikëpamje së bashku me
19 bashkëpunëtorët e mi, dhe thonim ne që "Kjo është okej, kjo
20 nuk është në rregull". Dhe kur gjërat, për shembull, nuk ishin
21 ashtu siç i planifikonim ne, duhej që të kontaktonim përsëri
22 me komandantët, në mënyrë të tillë që komandantët të binin
23 dakord për formulimin. Por, ishte absolutisht e qartë për mua
24 që ai nuk kishte as aftësinë, dhe as kompetencën që të merrte
25 vendime për UÇK-në. E kam fjalë këtu për çështje praktike, për

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Page 56

1 shembull: dorëzimin e armëve, ose udhëzimin e forcave,
2 drejtimin e forcave, veshjes së uniformave apo gjërave të
3 tilla të cilat kishin të bëjnë aspektin ushtarak. Këto ishin
4 çështje që vendoseshin nga persona të tjerë. Ajo çfarë bënte
5 ai ishte një person i cili ishte fytyra e UÇK-së, domethënë,
6 një person i cili luante një rol të ngjashëm me atë të
7 ministrit të punëve të jashtë. Ose për shembull, ajo çfarë do
8 të bënte Sekretarja Albright në qoftë se do të ishte në një
9 situatë të tillë.

10 Domethënë, me fjalë të tjera ishte zëdhënësi ose fytyra,
11 përfaqësia e UÇK-së. Ky ishte një dialog i cili ndodhi për
12 disa ditë dhe ideja ishte që të nënshkruhej marrëveshja në
13 mënyrë të tillë që komandantët në terren të ishin të kënaqur
14 me zgjidhjen, që Gjenerali të ishte po ashtu i kënaqur, dhe ne
15 synonym që të kishim veprime konkrete që do të duhej që të
16 merreshin nga UÇK-ja për t'u demilitarizuar.

17 Unë jam takuar vetë me komandantët dhe kam parë me sytë e
18 mi marrëdhënien e këtyre komandantëve me Hashimin. Këta
19 komandantë i kanë thënë atij çfarë të bënte. Domethënë,
20 marrëdhënia ishte e tillë që nuk i thoshte Hashimi
21 komandantëve se çfarë të bënin, por komandantët ishin ata që i
22 thoshin Hashimit se çfarë të bënte.

23 PY. Atëherë do shikojmë bashkë artikullin e *Financial Times*,
24 në versionin në libër.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Kështu që për këtë do i kërkoja

1 Sekretares të paraqesë në ekran dokumentin e pranuar tani më
2 si provë, 1D279. Të kalojmë tek faqja SPOE00229723 [Sipas
3 përkthimit]. Të fillojmë të shohim nga paragrafi që thotë që
4 "Jackson më mori ..."

5 Këtu thuhet:

6 "Jackson më mori në njërën prej tendave të tij fushore
7 dhe më tha se nënshkrimi i tij duhej të përshkruhet sikur
8 'marrjen' angazhimit të UÇK-së dhe jo 'pranim' i tij. Ai
9 shpjegoi se disa vende të NATO-s frikësoheshin se pa
10 ndryshimin e kësaj fjale të vetme, ato do të konsideroheshin
11 si përkrahje -- përkrahës të një ushtrie të pavarur për
12 Kosovën. Kjo nuk kishte asnjëfarë kuptimi. Dokumenti mezi po
13 paraqiste një aspiratë shqiptare. NATO-ja nuk po premtonte
14 asgjë. I frustruar unë thashë se do të bisedoja me Thaçin. I
15 vetmi opsion që më kishte ngelur për t'i ofruar Thaçit ishte
16 telefonata nga Clinton. I kërkova Jonathan Prince, një ndihmës
17 i Shtëpisë së Bardhë, i cili ishte ngarkuar për të shërbyer në
18 Shtabin e Jackson që të na lidhte në dhomën e Presidentit në
19 një hotel të Gjermanisë. Pastaj i thashë Thaçit se nëse ai e
20 pranonte këtë ndryshim të vetëm dhe pranonte të nënshkruajë
21 aty dhe në atë moment, atij vetë do t'i telefononte Presidenti
22 i Shteteve të Bashkuara për ta uruar. Ai më vështroi për disa
23 çaste dhe pastaj më tha, 'Po, po, mund ta nënshkruajmë tash'.
24 Marrëveshja u nënshkruara të afërt disa minuta më vonë. Pjesa
25 e fundit e enigmës tanimë gjeti vendin e vet. Thaçi bisedoi me

1 Presidentin, dhe brenda disa muajsh komandantët e NATO-s
2 vërtetuan se ..."

3 Dhe vazhdon më tej libri.

4 Pyetja që kam për ju është kjo z. Robin [Sipas
5 përkthimit]: Z. Thaçi u pajtua me këtë ndryshim të minutit të
6 fundit vetë, me vullnetin e vet?

7 PË. Po.

8 PY. Si e lidhni këtë që sapo thatë me ato çfarë thatë më
9 përpara që ai duhej që të bisedonte me komandantët e UÇK-së
10 për t'u pajtuar me ne?

11 PË. Kjo ishte një marrëveshje midis UÇK-së dhe forcës së
12 NATO-s, forcës së KFOR-it. Në marrëveshje UÇK-ja kishte marrë
13 angazhime të caktuara. Kishte marrë përsipër detyra të
14 caktuara që UÇK-ja ishte e përgatitur që të ndërmernte që të
15 realizonte, për shembull, afate të cilat kishin të bënin me
16 demilitarizimin. Domethënë, se si do ndryshohej kjo strukturë
17 ushtarake në një forcë mbrojtëse. Pra, ata e bënë këtë
18 angazhim, ata u pajtuan me këtë, u pajtuan gjithashtu edhe
19 komandantët e UÇK-së, për shembull, kryekomandanti, z. Çeku,
20 ose drejtues të tjerë të rëndësishëm të Ushtrisë Çlirimtare të
21 Kosovës u pajtuan me këtë.

22 Por ndërkohë, përdorimi i fjalës nuk është se ndryshonte
23 atë për të cilën u pajtuan komandantët. Pra, ishte thjesht një
24 çështje fjale dhe sipas meje kjo nuk ishte fare kuptimin,
25 domethënë, ishte një gjë komplet e pakuptimtë. Edhe ia thashë

1 vetë këtë gjë për ministrat, ose ndërkohë përfaqësuesit
2 politikë kishin të drejtë që të vendosnin kur diçka ishte me
3 kuptim ose diçka ishte pa kuptim. Dhe në këtë rast ishte pa
4 kuptim. Dhe ai do të duhej që të kontaktonte komandantët kur
5 bëhej fjalë për ndryshime të njëmendta, për ndryshime reale të
6 vërteta që kishin ndikim, por jo për një gjë të tillë kaq të
7 vogël. Në qoftë se ndryshimet ishin të mëdhaja, sigurisht që
8 duhej të kontaktonte me komandantët e UÇK-së, me z. Çeku e me
9 të tjerë.

10 Por, në rastin në fjalë bëhej fjalë për një ndryshim të
11 pakuptimtë. Ishte thjesht një hollësi që e kishte në mendje
12 Gjenerali Jackson. Unë nuk mendoja personalisht që kjo
13 përfaqësonte pikëpamjet e anëtarëve të NATO-s, po ai e tha që
14 kjo do të duhej që të bëhej si ndryshim. Domethënë, kjo ishte
15 situata. Nuk ishte asnjë lloj ndikimi ligjor. Por, nga ana
16 tjetër, Gjenerali nuk ishte jurist, ishte thjesht një person
17 ushtarak edhe thjesht donte që të pasqyronte interesat e
18 palëve të tjera, ndërkohë që detyrimet i kishte pala kosovare.

19 Dhe pasi ia shpjegova të gjithë situatën që ky ishte një
20 ndryshim shumë i vogël, ndoshta jo me kaq fjalë sa e thashë
21 tani, dhe pasi i shpjegova që unë do siguroja një telefonatë
22 të Presidentit të Shteteve të Bashkuara me të, ai u bind që
23 kjo ishte një ndryshim i vogël, jo domethënës, jo i
24 përnjëmendtë. Ishte një ndryshim shumë i vogël në shkëmbim të
25 fundit të konfliktit, të sjelljes së paqes për popullin e vet.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 60

1 Kështu ai e kuptoi që ndryshimi ishte shumë i vogël, nuk ishte
2 domethënës, dhe për këtë arsye nuk i duhej që të merrte leje
3 ose të merrte aprovimin e komandantëve. Dhe ne u pajtuam me
4 këtë dhe vend të kësaj do të merrte një telefonatë nga
5 Presidenti i Shteteve të Bashkuara që ishte një gjë e madhe,
6 ishte një zhvillim shumë i rëndësishëm për një person që
7 luante rolin, në thonjëza, të ministrit të punëve të jashtme
8 dhe përfaqësuesit të UÇK-së. Mendoj që ky ishte një vendim i
9 lehtë i bërë prej tij. Nuk ishte e vështirë për të marrë këtë
10 vendim.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Kemi pak minuta derisa të shkojmë
12 në pushimin e kafes. Megjithatë, përpara se të vazhdojmë me
13 pushimin do i kërkoja Sekretares që të paraqesë në ekran një
14 tjetër dokument që mban numrin DHT04107 deri në DHT04110.

15 PY. Z. Rubin, ky është artikull i *New York Times*, i gazetës
16 *New York Times* nga data 22 qershor 1999. Është shkruar nga një
17 gazetar që quhet Carlotta Gall. A e njihni këtë person?

18 PË. Po.

19 PY. A keni punuar me këtë gazetare në kohën kur keni qenë
20 zëdhënësi i Departamentit të Shtetit?

21 PË. Po.

22 PY. A keni folur me Carlotta Gall lidhur me këtë udhëtim
23 tuajin në Kosovë në qershor të 1999-s?

24 PY. Besoj se po.

25 PY. Është një artikull i cili e ka titullin: Kriza në

1 Ballkan: Separatistët; Rebel --

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Pra, është një artikull të cilin
3 mund të vazhdojmë e ta shohim në faqen e dytë. Dua që të marr
4 një fragment nga paragrafi ku fillon me "Një zyrtar perëndimor
5 ..."

6 PY. Në këtë pjesë thuhet:

7 "Një zyrtar perëndimor që ishte takuar me Gjeneral Çekun
8 në bjeshkë në selitë e UÇK-së kishte folur me të."

9 A e keni idenë se për kë bëhet fjalë këtu kur thotë
10 gazetarja "Një zyrtar perëndimor"?

11 PË. Besoj që kam qenë unë.

12 PY. A keni qenë në selinë e z. Çeku vetë?

13 PË. Po.

14 PY. A mund të na thoni diçka më tepër, ju lutem?

15 PË. Do të mundohem -- po mundohem që të marr parasysh
16 kërkesën e Gjykatësve që mu bë në fillim fare, megjithatë, në
17 përgjigje të pyetjes, më lejoni të them që, në fund të
18 bisedave, bisedimet përfunduan, ne po prisnim ndërkohë, kjo
19 ishte pjesë e procedurës që bënin zakonisht, por Gjenerali
20 Reith, që ishte në ushtrinë britanike në atë kohë, mendoi që
21 do ishte një veprim i zgjuar që të në fakt të takoheshim me
22 komandantin aktual të UÇK-së që gjendej në një tjetër vend, që
23 ishte ndoshta një kilometër a ca kilometra më tej nga vendi ku
24 ne po bënim negociatat.

25 Kështu që, ajo çfarë ndodhi ishte që ne u larguam nga aty

1 ku ishim, disa prej nesh, jo të gjithë dhe shkua për të
2 takuar z. Çeku, Gjeneral Çekun në shtëpinë e vet, ose në
3 selinë ku qëndronte ai. Ne pimë një gotë uiski me të për të
4 festuar vendimin për transformimin e UÇK-së në Forcën
5 Mbrojtëse të Kosovës. Dhe përshtypja ime gjatë atij procesi
6 ishte që duke qenë që kishim marrëdhënie të mira në Ballkan,
7 duke pasur parasysh karrierën time për disa vite, dhe duke
8 ditur se si silleshin njerëzit me persona që ishin shefa,
9 ishin komandantë, dhe përshtypja ime ishte që njerëzit u
10 sollën, ose silleshin sikur personi përgjegjës ishte Çeku, dhe
11 për këtë arsye u mor vendimi drejt fundit të negociatave për
12 të shkuar për të takuar Çekun personalisht.

13 PY. A keni konstatuar që komandantët e UÇK-së ishin
14 indiferentë ndaj z. Thaçi?

15 PË. Jo.

16 PY. Po marrëdhënia midis z. Thaçi dhe komandantëve si ishte,
17 mund të na e thoni?

18 PË. Përsëri, duke iu kthyer përvojës gjatë këtyre tre ditëve,
19 gjashtë deri në dhjetë herë neve na është dashur që të
20 ndryshojmë gjërat dhe sigurisht që kishim një lloj ndërveprimi
21 social deri në një masë. Nuk më kujtohet ekzaktësisht mosha e
22 tij, po besoj që ka qenë diku rreth të 30- tave, e kam fjalën
23 për z. Thaçi, ndërkohë që unë personalisht 39, në mos gabohem.
24 Po, aq kam qenë 39. Ne të dy ishim më të rinjtë e të gjithë
25 grupit. Ndërkohë që të tjerët ishin shumë herë më të thyer në

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 63

1 moshë sesa ne. Dhe unë konstatova si nga aspekti social që ai
2 ishte i tërhequr në raport me ta dhe kur kërkohej informacion
3 ose njohuri lidhur me mënyrën sesi funksiononte UÇK-ja, ose
4 kur flitej për nevojën për të kuptuar më mirë aftësitë e UÇK-
5 së, ose kur duhej të merrej një vendim nga ana e UÇK-së,
6 Hashim Thaçi duhej që t'i drejtohej këtyre grupit të
7 komandantëve për të marrë informacione, për të marrë njohuri
8 apo për të marrë udhëzime për vendimmarrje. Unë e kam parë
9 vetë me sytë e mi, domethënë, që ai ishte i tërhequr sa i
10 takon çështjeve të thelbit të pyetjeve që kishin të bënin me
11 UÇK-në. Kishte dhe një lloj distacimi prej tyre. Por
12 gjithashtu edhe prej diferencës së moshës në atë kulturë,
13 përshtypja ime ishte që ai ishte personi që iu kërkonte atyre
14 mendimin për të bërë gjërat dhe ata i thonin atij se çfarë
15 drejtimi të merrnin ose çfarë përgjigje të jepnin.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja që
17 të pranohej në provë materiale ky dokument. Është dokumenti me
18 numër DHT04107 deri në DHT01411.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
20 kundërshtim?

21 Z. PACE: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
23 DHT01407 deri në DHT014110 pranohet në prova materiale. Ju
24 lutem caktojini një numër.

25 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrë numrin e

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 64

1 provës D -- 1D288.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, besoj se ka
3 ardhur momenti për të bërë pushim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
5 pushim për 30 minuta tani. Mund të dilni nga salla, Dëshmitar.
6 Ju lutem edhe një herë mos flisni me askënd për dëshminë tuaj.
7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon kohës, dua t'ju njoftoj
9 se në seancën e radhës do të përfundoj me dëshmitarin.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
11 që na njoftuat.

12 Do të bëjmë pushim deri në orën 11.30.

13 --- Pauza fillon në orën 11.02

14 --- Seanca rifillon në orën 11.31

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
16 Sekretare, sillni dëshmitarin në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
19 Z. Misetic, mund të vazhdoni.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Mirë se vini, z. Rubin. Tani dua t'ju tregoj një video.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, kjo është prova
23 materiale P2519, duke filluar tek minuta 02:13 sekonda.

24 [Luhet videoincizimi]

25 "Për popullin e Kosovës po fillon një epokë e re që

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 65

1 garanton liri.”

2 “Do të jap një deklaratë të shkurtër. Pas një ore do të
3 jetë një ngjarje tjetër. Fola me Hashim Thaçi pas nënshkrimit
4 të marrëveshjes, me znj. Albright. Ajo shprehu kënaqësinë e
5 saj për Hashim Thaçin, vendimin që mori dhe organizata që mori
6 vendimin për t’u transformuar. Presidenti i Shteteve të
7 Bashkuara foli gjithashtu, bisedoi para pak çastesh me z.
8 Hashim Thaçi dhe në të njëjtën mënyrë e përgëzoi atë për
9 nënshkrimin e këtij dokumenti dhe ishte veçanërisht i kënaqur
10 për ecurinë dhe angazhimet që shprehu z. Thaçi dhe
11 bashkëbisedimin që pati me Presidentin”.

12 Z. MISETIC: [Përkthim]

13 PY. Z. Rubin, së pari, a mund t’i identifikoni njerëzit që
14 patë në video?

15 PË. Pash veten, pash Hashim Thaçin dhe në fillim pash
16 gjeneralin Jackson.

17 PY. Ajo që thatë ju dhe ajo që z. Thaçi tha në video, a është
18 në përputhje, a përputhet me atë që ju kujtohet ju që është
19 thënë në atë kohë?

20 PË. Po.

21 PY. Në video ju thoni që Presidenti i Shteteve të Bashkuara
22 ishte i kënaqur me mbështetjen e shprehur nga z. Thaçi për
23 tolerancë dhe demokraci. Në atë kohë a besuat se mbështetja e
24 z. Thaçi për tolerancë dhe demokraci ishte e singertë?

25 PË. Kjo ka ndodhur para 26 vjetësh, unë po pasqyroj atë që

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 66

1 besova në atë kohë që ka thënë. Por në punën që bëjmë ne
2 fjalët janë të rëndësishme, por veprimet janë edhe më të
3 rëndësishme. Pra, do të thoja vetëm që ne do t'i gjykonim
4 bashkëbiseduesit tanë bazuar në veprimet e tyre, por fjalët e
5 shprehura ishin fillim i mirë.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Tani do t'ju tregoj një video
7 tjetër që është 103211-09.

8 [Luhet videoincizimi]

9 "... ishte jashtëzakonisht i madh. James Rubin, i cili e
10 hapi këtë konferencë, fillimisht përshëndeti z. Thaçi e Çeku,
11 duke theksuar se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë vënë në
12 bashkëpunim të mirë me udhëheqjen e Kosovës. Në këtë kuadër,
13 Rubin përmendi edhe bisedën që ka zhvilluar mbrëmë
14 Kryeministri Thaçi me Presidentin Clinton dhe Sekretaren e
15 Shtetit znj. Albright, të cilët, si u shpreh ai, kanë çmuar
16 lart nënshkrimin e marrëveshjes për transformimin e UÇK-së
17 duke e vlerësuar si kontribut konkret për vendosjen e paqes në
18 Kosovës dhe të stabilitetit në rajon. Ndërkaq duke ju drejtuar
19 gazetarëve, Kryeministri i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës,
20 Hashim Thaçi, tha që më vjen mirë që takohem me ju në
21 Prishtinë. Dhe shtoi se ne të UÇK-së e konsiderojmë vazhdimësi
22 të Marrëveshjes së Rambujesë. Duke u përgjigjur në shumë
23 pyetje të gazetarëve, Kryeministri Thaçi e shprehu në këtë
24 takim qartë për ndërtimin e shoqërisë demokratike në Kosovë,
25 ku UÇK-ja dhe Qeveria e Përkohshme e Kosovës do t'i kryejnë me

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 67

1 vendosmëri obligimet që shtrohen para tyre. Më pastaj Hashim
2 Thaçi duke ju përgjigjur në një pyetje për të burgosurit,
3 pohoi se në burgjet serbe ende mbahen shumë intelektualë
4 shqiptarë si është Ulqin Hoti, Xhavit Haziri, Afir Shala e
5 shumë të tjerë për të cilët tha se duhet të lirohen sa më
6 parë."

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Z. Rubin, pyetja ime e parë është a e patë videon? A
9 është kjo video e së njëjtës konferencë për shtyp që pamë më
10 parë?

11 PY. Duket që po.

12 PY. Në rregull. Ka dy dallime të ndryshme që duken nga teksti
13 që është transkripti i përkthimit. Pra, fjalët që i atribuohen
14 z. Thaçi që nuk janë në videon e parë. Pra, këtu është shënuar
15 që z. Thaçi në konferencën për shtyp tha:

16 "Ne konsiderojmë nënshkrimin e marrëveshjes për
17 transformimin e UÇK-së si vazhdim të Marrëveshjes së
18 Rambujesë."

19 Dhe pastaj:

20 "UÇK-ja dhe Qeveria e Përkohshme e Kosovës janë të
21 vendosura për të përmbushur detyrimet që iu janë dhënë atyre."

22 Dhe pastaj u përgjigj pyetjes lidhur me të burgosurit se
23 "Shumë intelektualë shqiptarë mbahen në burgjet e Serbisë" dhe
24 shumë të tjerë që duhet të lirohen sa më shpejtë që është e
25 mundur.

1 A ju kujtohet kjo?

2 PË. Janë ngatërruar dy ngjarje këtu. Është deklarata që është
3 dhënë në tendën, në çadrën e Gjeneralit Jackson me hartat që
4 janë rreth aty. Dhe pastaj, po atë ditë më vonë kemi shkuar në
5 Prishtinë dhe kemi patur një konferencë për shtyp ku u jemi
6 përgjigjur shumë pyetjeve. Ky raport është, përmban të dhëna
7 nga të dy këto ngjarje. Për këtë arsye në këtë raport
8 përmbajtja është më e gjerë, përmban më shumë gjëra sesa
9 raporti i parë, sepse në raportin e parë kemi vetëm momentet
10 kur Presidenti Clinton flet me z. Hashim Thaçi dhe Sekretaren
11 Albright. Pastaj, nuk e di sa minuta kanë kaluar nga tenda e
12 selisë së KFOR-it deri në qytetin e Prishtinës ku kemi shkuar
13 dhe është mbajtur konferenca për shtyp. E para më kujtohet
14 kanë qenë dy fjali që janë thënë nga secili prej nesh sa i
15 përket mjedisit ushtarak ku nuk mund të ishin gazetarët.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, kjo video dhe
18 transkripti janë të pranuar si përmes mocionit të provave jo
19 gojore. Në vendimin e Trupit Gjykues F03467 dhe do të kërkoja
20 që t'iu jepet një numër prove materiale.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jepini një
22 numër prove materiale.

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo merr provën
24 materiale 1D289.

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, mund të shfaqni në
3 ekran dokumentin DHT01460 deri në DHT01461.

4 PY. Z. Rubin, në faqen e parë shihni që është raport i
5 seancës dëgjimore të Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë të
6 Senatit të Shteteve të Bashkuara. Ky është, pra, komiteti në
7 të cilin ju keni punuar në fund të viteve 1980 dhe në fillim
8 të viteve 1990?

9 PË. Saktë.

10 PY. Dhe shihni në faqe dhe ky është komiteti për të cilin ju
11 folët në fakt që keni punuar për Senatorin Biden?

12 PË. E saktë.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër, rreth
14 fundit të faqes dhe shohim komentet e Senatorit Biden. Dhe
15 këtu fillojmë me fjalinë rreshti i katërt në krye të
16 paragrafit.

17 Dhe thotë:

18 "Bombardimet nuk funksionojnë. Më duket që bombardimet
19 funksionuan edhe vetë z. Thaçi më tha kur u takova me orë të
20 tëra me të që ai ka bërë gjithçka - dhe kjo është e kotë.
21 Ndikimi në rritje i UÇK-së në këtë proces ishte kaq, pra, në
22 rritje. Asnjë provë s'kishte për këtë. Mund të flisni për
23 1.500 luftëtarë, jo 10.000. Z. Thaçi më pyeti, më tha, ai tha,
24 po të ishe -- ke qenë 29 vjeç kur ke marrë funksionet zyrtare
25 siç jam unë tani. A ke ndonjë këshillë? I thashë meqë po më

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 70

1 pyet të them tani menjëherë, po janë rrethana edhe pse janë
2 rrethana të ndryshme. Ai më tha, cila është këshilla jote? Unë
3 i thashë numër 1, mos e merr veten shumë seriozisht, kaq
4 seriozisht dhe numër 2 kuptohet që ... se unë e di që ti e di
5 që nuk e kontrollon UÇK-në."

6 Tani, Senatori Biden thotë që i tha z. Thaçi që ai e
7 dinte që z. Thaçi nuk e kontrollonte UÇK-në. A mund t'i thoni
8 Trupit Gjykues nëse qëndrimi i z. Biden në atëkohë -- cili
9 ishte qëndrimi i z. Biden në atë kohë në Komisionin për
10 Marrëdhënie me Jashtë?

11 PË. Mesa më kujtohet në atë kohë ai ka qenë demokrat i
12 nivelit të lartë në komision.

13 PY. Dhe bazuar në njohuritë që keni ju do të doja t'ju pyesja
14 disa pyetje lidhur me sesi një demokrat i nivelit të lartë në
15 marrëdhënie me jashtë e di që kush është personi që nuk e
16 kontrollon UÇK-në.

17 A keni udhëtuar me Senatorin Biden në Ballkan?

18 PË. Po, në 1993, në pranverë të 1993. Kemi shkuar në vendet e
19 Ballkanit, mendoj.

20 PY. A ka Departamenti i Shtetit një protokoll kur senatorë të
21 Shteteve të Bashkuara udhëtojnë?

22 PË. Po.

23 PY. Cili është protokolli?

24 PË. Ka një oficer të kontrollit në çdo vend. Dhe normalisht
25 senatori, në këtë rast, që shkon në Ballkan duhet, është një

1 aeroplan i qeverisë, ushtarak, me zyrtarë ushtarakë në
2 aeroplan që të siguron që pastaj aeroplani të shkojë në vendin
3 e duhur. Dhe pastaj kur arrihet në vend, oficeri i kontrollit
4 nga Departamenti i Shtetit takohet në aeroplan, përshkruan
5 situatën, zhvillimet e fundit në terren dhe personat që do të
6 takojë, nivelin e tyre, rangun e tyre, protokollin, kontekstin
7 e vendit, pra, të gjitha këto jepen nga oficeri i kontrollit
8 ose nga shërbimet e inteligjencës.

9 PY. Tani kam pyetjen tjetër. Gjatë konfliktit të Kosovës, një
10 demokrat i nivelit të lartë në Komisionin për Marrëdhënie me
11 Jashtë a merrte *briefings*, pra, informacione mbi zhvillimet që
12 ndodhnin në Kosovë?

13 PË. Po.

14 PY. Kush nga këta demokratë merrte këto informacione, këto
15 raporte?

16 PË. Është një përzierje e stafit të tij dhe ne si pjesëtarë
17 të stafit të tij, mendojmë, që kemi role të rëndësishme në
18 marrjen e këtyre raporteve ku informohen senatorët dhe ne kemi
19 marrë informacione nga të gjitha burimet, nga shërbimet e
20 inteligjencës, Departamenti i Shtetit, Departamenti i
21 Mbrojtjes.

22 Në këtë rast e di që Senatori Biden ka qenë
23 jashtëzakonisht i përfshirë, i interesuar në luftën në Kosovën
24 sepse ishte demokrat i nivelit më të lartë në senat në
25 marrëdhëniet me jashtë. Ishte personi që kishte udhëtuar në

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 72

1 Ballkan dhe ndoshta ishte ai që kishte më ndikim në Partinë
2 Demokrate për sa i përket çështjeve në Ballkan. Dhe lufta
3 ishte shumë kontroverse nga pikëpamja politike brenda Partisë
4 Demokratike, në Partinë Republikane. Dhe kështu, një senator
5 si Senatori Biden besoj që është i informuar dhe janë dhënë
6 raporte nga të gjithë - nga CIA, nga agjencitë e
7 inteligjencës, nga Departamenti i Shtetit, pra, raporte të
8 gjerësishme. Dhe e di që Sekretarja Albright ka biseduar me
9 Senatorin Biden shumë gjatë luftës së Kosovës, sepse ishte
10 çështje shumë e rëndësishme për Shtetet e Bashkuara në atë
11 kohë dhe sepse Presidenti Clinton ishte demokrat dhe sepse
12 Presidenti Clinton dhe Senatori Biden ishin të afërt dhe se
13 Senatori Biden kishte interes të veçantë në Ballkan.

14 Pra, besoj që ai duhet të ketë marrë raporte të tilla si
15 çdo senator në mesin e qindrave senatorëve lidhur me këtë
16 pikë.

17 PY. Tani për t'ju përgjigjur pyetjes që thatë më parë, do të
18 ishte, pra, raport zyrtar?

19 PË. Duhet të ishte diplomat nga Departamenti i Shtetit që
20 bazohej, që ishte vendosur në rajon dhe takohej në aeroplan,
21 pra, në avion, zyrtari i Departamentit të shtetit, zyrtar i
22 marrëdhënieve me jashtë.

23 PY. Faleminderit. Në paragrafin 65-66 të deklaratës suaj të
24 dëshmitarit dhe ju shpjegoni që Departamenti i Shteteve të
25 Bashkuara kishte shkruar Mitch McConnell, që nuk kishte

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 73

1 kontroll efektiv të komandës së UÇK-së. Dhe ne, sipas
2 deklaratës tuaj, është vlerësim që është verifikuar dhe pohuar
3 nga agjenci të shumta, nga Pentagoni, shërbimet e
4 inteligjencës.

5 Pyetja ime është nëse e dini që ky vlerësim i dhënë nga
6 Senatori Biden gjatë seancës dëgjimore në Senat, pra, që
7 Hashim Thaçi nuk kontrollonte UÇK-në, ishte, përputhej me
8 vlerësimin që i jepte Qeveria e Shteteve të Bashkuara në atë
9 kohë?

10 PË. Kjo ishte në përputhje, po, sepse të dy deklaratat
11 pasqyrojnë faktin se Hashim Thaçi nuk kishte në kontroll sepse
12 ne nuk mendonim, nuk besonim që i kishte një sistem të
13 kontrolluar, që të quhej një sistem që funksionon në mënyrë të
14 duhur, të strukturuar i UÇK-së. Nuk ishte njësi e organizuar
15 që të mund të përkufizohej si e tillë, ku dikush ishte në krye
16 dhe kishte autoritet apo informacion dhe aftësi për të diktuar
17 apo për të ditur se çfarë po ndodhte dhe konkretisht se Hashim
18 Thaçi nuk ishte as në krye të kësaj organizate. Në krye të
19 kësaj ishte Gjeneral Çeku.

20 Dhe prapë Senatori Biden duhet ta kishte ditur për z.
21 Çeku. Dhe deklarata -- unë kam punuar në qeveri për në shumë
22 raste dhe një gjë e tillë do të ishte verifikuar në mënyrë të
23 gjerë nga zyrat e ndryshme të shumta në secilën prej
24 ndërtesave përfshirë Shtëpinë e Bardhë, CIA, Departamenti i
25 Mbrojtjes, pra, Ministria e Mbrojtjes, Departamenti i Shtetit.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 74

1 E dini, 250 njerëz përafërsisht kanë verifikuar këtë deklaratë
2 dhe të cilët konsideroheshin ekspertë për Ballkanin.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, do ta dorëzoja këtë
5 për pranim si provë, pra, DHT01460 deri në DHT01461.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
7 kundërshtim?

8 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo pranohet.
10 Jepini një numër, ju lutem, znj. Sekretare.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do të marrë numrin
12 e provës materiale 1D00290.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

15 PY. Z. Rubin, në paragrafin 81, 83 të deklaratës tuaj ju
16 bisedoni për artikullin e *The New York Times* i shkruar nga
17 Chris Hedges.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Të shfaqim në ekran DHT11910 deri
19 në 11916.

20 PY. Ky artikull u publikua pas disa ditësh kur ju shkua në
21 Kosovë për të negociuar demilitarizimin e UÇK-së. Artikulli i
22 *The New York Times* shkruan se pretendonte se komandantë të
23 UÇK-së bënë një fushatë kundër rivalëve të tyre politikë,
24 fushatë e drejtuar nga Hashim Thaçi, Azem Sylja dhe Xhavit
25 Haliti.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe pastaj kalojmë në faqen
2 DHT11911 të këtij artikulli. Kalojmë në paragrafin që fillon
3 me "Departamenti i Shtetit ..."
4 PY. Kjo është publikuar me 25 qershor 1999. Artikulli pastaj
5 ju citon juve duke thënë që:

6 "Por dje Departamenti i Shtetit kundërshtoi disa aspekte
7 të këtij tregimi. 'Ne thjesht nuk kemi informacion për të
8 mbështetur pretendimet se ka ekzistuar një program i drejtuar
9 nga lidershipi, nga udhëheqja e UÇK-së program vrasjesh dhe
10 ekzekutimesh', James P. Rubin, zëdhënësi i Departamentit të
11 Shtetit."

12 Pastaj:

13 "Z. Rubin, tha që nuk mund të përjashtonte mundësinë që
14 udhëheqës rebelë ishin në një farë mënyrë të lidhur me
15 vrasjet. Por ai tha që zyrtarët e Departamentit kishin
16 kontrolluar dhe verifikuar një gamë të gjerë, një seri të
17 gjerë burimesh dhe nuk mund të konfirmonin këto akuza.

18 "Një zyrtar i Departamentit të Shtetit dhe një diplomat
19 perëndimor në Ballkan duke cituar raportet e inteligjencës dhe
20 kontakte të gjera me zyrtarë rebelë brenda dhe jashtë Kosovës,
21 thanë që ata ishin në dijeni të ekzekutimeve të oficerëve të
22 nivelit të mesëm të dyshuar për bashkëpunim me serbët, por tha
23 që nuk kishte prova të lidhjes së Thaçit me këto vrasje."

24 Pyetja ime është kjo që është thënë këtu a pasqyron në
25 mënyrë të saktë deklaratën që ke dhënë në atë kohë?

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 76

1 PË. Po.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky është një version, z. Kryetar,
3 është version ndryshe i artikullit që është diskutuar në
4 deklaratën e dëshmitarit dhe do të doja ta dorëzoja këtë, do
5 të dorëzoja versionin më të ri dhe të plotë si provë. Është
6 DHT0146 deri në DHT01461.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Numrat e
8 ndryshëm që më dhatë.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT11910 deri
11 në 11916.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ky është.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
14 kundërshtim?

15 Z. PACE: [Përkthim] Jo.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kjo do marrë numrin e
18 provës materiale 1D191.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Znj. Sekretare, na shfaq në ekran,
22 ju lutem, provën materiale 1D275.

23 PY. Z. Rubin, në paragrafin 82 të deklaratës tuaj, keni
24 shpjeguar që atë ditë kur u publikua artikulli i *The New York*
25 *Times* ju bëtë konferencën për shtyp të rregullt ku juve ju bë

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 77

1 pyetja lidhur me këtë artikull.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen DHT05186 që është
3 transkripti i konferencës për shtyp që keni mbajtur atë ditë.
4 Dhe paragrafi fillon me -- në mes të faqes.

5 PY. Ju citoni që keni thënë:

6 "Tani, më bëhet pyetja rregullisht nëse UÇK-ja është e
7 përfshirë në trafik droge dhe unë rregullisht ju them juve që
8 nuk kemi konfirmim të pavarur të kësaj. Tani po pyetem nëse
9 udhëheqja e UÇK-së është përgjegjëse për ekzekutime dhe këtu
10 po ju them që nuk kemi informacione për të konfirmuar këtë. Ne
11 bëjmë verifikime shumë të thella dhe kemi kontakte shumë,
12 shumë të mira në rajon. Dhe nuk kemi qenë në gjendje që të
13 vërtetojmë apo të mbështesim, me gjithë përpjekjet e forta që
14 kemi bërë, ato që janë, pra, pretendime anonime. I vetmi
15 person i cituar me të vërtetë ka qenë një person kundërshtar
16 politik i cili nuk i është referuar në mënyrë specifike ndonjë
17 pretendimi apo akuze specifike por tha thjesht që ky udhëheqës
18 është në gjendje të ketë të bëjë një sjellje të tillë."

19 Pra, ju thatë në konferencën për shtyp se Kombet e
20 Bashkuara kishin bërë përpjekje të shumta dhe të thella, të
21 gjera për të hetuar pretendime kundër z. Thaçi dhe udhëheqësve
22 të UÇK-së dhe nuk kishin qenë në gjendje të mbështesnin apo të
23 vërtetonin pas gjithë këtyre përpjekjeve të vërtetonin, pra,
24 pretendimet që ishin anonime. Ju kujtohet që keni thënë që
25 keni bërë përpjekje shumë të mëdha dhe të thella për të hetuar

1 këto pretendime?

2 PË. Po. Dhe do të thoja që kjo ka qenë një karakteristikë,
3 një veçori e këtij gazetari në veçanti, Chris Hedges, i cili
4 shpesh ishte i keqinformuar nga burime serbe. Ne kemi
5 konstatuar në mënyrë të përsëritur që ky gazetar përsëriste
6 thashetheme, pa prova, por pasi punonte për *The New York Times*
7 ne duhet të bënim hetime të thella për këto, sepse *The New*
8 *York Times* ishte një organizatë informative dhe lajmesh, pra,
9 gazetë shumë e rëndësishme.

10 Dhe më kujtohet kjo çështje është paraqitur në mënyrë të
11 përsëritur gjatë kësaj periudhe ku z. Hedges dukej që po
12 përpiqej në mënyrë të përsëritur që të vendoste udhëheqësit e
13 popullit të Kosovës, përfshirë UÇK-në. Dhe unë i kërkoja
14 komunitetit, pra, agjencive të inteligjencës, ekspertëve të
15 jashtëm, zyrtarëve ushtarakë, të gjithë njerëzit që mund të më
16 jepnin informacion lidhur me veprime kriminale apo gjëra të
17 tilla, pyesja ekspertët për krime ndërkombëtare në mënyrë të
18 përsëritur dhe nuk kemi marrë asnjë konfirmim të këtyre
19 komenteve shpifëse që bëheshin në mënyrë të përsëritur nga z.
20 Hedges. Përfundimisht, ai u hoq nga puna, u pushua nga *The New*
21 *York Times* për gabime të përsëritura.

22 E di që nuk është pyetja që më bëtë ju, por mendoj që
23 është në mënyrë të drejtpërdrejtë relevante për pyetjen, sepse
24 më irritonte fakti që duhej në mënyrë të përsëritur të gjeja
25 përgjigje për pyetjet që vinin nga një gazetar me reputacion

1 që bënte gabime pas gabimesh, pra, në mënyrë të përsëritur.

2 PY. Z. Rubin, në Departamentin e Shtetit kush i hetonte këto
3 pretendime, pretendime për krime?

4 PË. Gjatë kohës që kam qenë unë atje ka qenë një zyrë që
5 merrej apostafat me krimet e luftës. Më duket se e drejtonte
6 David Scheffer asokohe. Kjo ka qenë një periudhë kur ne i
7 ofronim mbështetje shumë të madhe Tribunalit Ndërkombëtar për
8 ish-Jugosllavinë dhe për Ruandën, kishim sektorë apostafat që
9 merreshin me këto detyra. Kështu që rregullisht merrja
10 udhëzime nga këto njësi për mënyrën sesi duhet t'ju
11 përgjigjesha këtyre akuza të shpeshta madje.

12 Kishim juristë, kishim zyrtarë zbulimi, kishim ekspertë
13 të krimeve ndërkombëtare, këshilltarë juridikë, pra, kishte
14 shumë persona që punonin në këto njësi për krimet e luftës që
15 gjatë gjithë kohës përpiqeshin të zbulonin a kishte ndonjë
16 bazë për këto akuza, sepse çështja e Kosovës në fakt ishte një
17 nga aspektet kryesore që trajtonte Presidenti i Shteteve të
18 Bashkuara aso kohe dhe Shtete e Bashkuara. Dhe çdo sugjerim që
19 ne po ndihmonim kriminelët ishte diçka që donim ta hetonim dhe
20 të gjenim zgjidhje.

21 Unë dhe personalisht i hetoja këto sepse kam qenë i
22 përfshirë personalisht me Madeleine Albright dhe me UÇK-në dhe
23 unë doja me të vërtetë ta dija nëse ndonjë prej këtyre
24 pretendimeve ishte i vërtetë dhe herë pas here ngriheshin
25 pretendime të tilla. Edhe unë po ju them që kemi punuar shumë,

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 80

1 i kemi hetuar, askush prej akuzave lidhur me rolin e tij dhe
2 udhëheqësit e UÇK-së apo akuza të tjera, marrina, asgjë
3 s'ishte e vërtetë.

4 PY. Në paragrafin 83 ju thoni se çështja e krimeve të luftës
5 ishte mbase një nga aspektet më të rëndësishme të Presidencës
6 Clinton asokohe, kështu që keni dëgjuar ju në qoftë se z.
7 Thaçi ka qenë i lidhur me vrasje, pra, në qoftë se do kishit
8 dëgjuar diçka ju që z. Thaçi jepte urdhra për vrasje apo bënte
9 diçka të këtij lloji menjëherë Shtetet e Bashkuara do ta
10 kishin tërhequr mbështetjen e tyre.

11 Pra, ky mesazh lidhur me z. Thaçi tregon që Shtetet e
12 Bashkuara nuk do të bashkëpunonin me të nëse do të dyshonin
13 për sjellje të tilla?

14 PË. Unë nuk mund ta përsërisë këtë herë pas here, nuk e
15 përsërisja herë pas here. Por ne i kishim ndihmuar shqiptarët
16 e Kosovës. Ishin shumë mirënjohës se u shpëtuan jetën. Edhe
17 udhëheqësit e tyre ishin po ashtu shumë mirënjohës dhe ishin
18 shumë të kujdesshëm me deklaratat, me kërkesat që vinin nga
19 Presidenca e Shteteve të Bashkuara, përfshirë përfaqësuesit e
20 tyre mes të cilëve dhe unë, kështu që unë e di që ne kishim
21 shumë influencë ndaj tyre.

22 Kështu që kur mendonim se ishte anormale, çështje
23 terrorizmi apo dëgjonim herë pas here historira për
24 fundamentalistë islamikë që përpigeshin të penetronin në
25 Ballkan, ne e trajtonim me ta këtë temë. Sa herë që dëgjonim

1 aspekte të ngjashme, sikurse dhe ju sapo e përshkruat, ne e
2 trajtonim me ata. Por jo çdo herë që i takonim, sepse e
3 kuptuam që kryesisht ishin të rreme, të fabrikuara edhe
4 synonin të dëmtonin, të ndikonin në mbështetjen tonë, ne
5 thjesht ndihmuam njerëzit që të mos masakroheshin dhe këto
6 akuza synonin ta cenonin këtë marrëdhënie tonën.

7 PY. Sipas jush, si e konsideronte z. Thaçi marrëdhënien e tij
8 me Shtetet e Bashkuara?

9 PË. Që nga momenti që e kam takuar deri herën e fundit që e
10 kam takuar, më është krijuar përshtypja që për të Amerika ishte
11 një simbol dhe një pasqyrim i njëmend e asaj që ai e
12 konsideronte një shtet i fuqishëm i mirë për botën. Ai donte
13 që Shtete e Bashkuara ta respektonin, ta besonin, qoftë kjo me
14 presidencë republikane apo demokratike, ai donte mbështetjen e
15 Shteteve të Bashkuara, flasim udhëheqjes, presidentit,
16 Kongresit, Shteteve të Bashkuara, popullit amerikan për aq sa
17 të ishte e mundur. Kështu që sipas meje, ky ishte prioriteti i
18 tij më i madh mënjane respektit që kishte ai dhe synimit për
19 të mbrojtur popullin e vet.

20 PY. A kishte ndonjë në sjelljen e z. Thaçi apo në mënyrën se
21 u shpreh që ty të shtynte të mendoje se do ta rrezikonte
22 mbështetjen e Shteteve të Bashkuara?

23 PË. Jo, mendoj hera e parë kur ai ishte gati ta rrezikonte
24 kjo ishte pikërisht në Rambuje kur i tha jo Madeleine Albright
25 po sepse ai nuk ishte personi përgjegjës, madje dukej që e

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 82

1 kishe shumë të vështirë kur e tha jo, gati-gati ishte në lot
2 tha. Kështu që ai donte të sigurohej që Amerika ta
3 respektonte, ta mbështeste, të kishin besim tek ai, shqiptarët
4 donin të ishin të lirë, të sigurtë, ky ishte prioriteti i tij,
5 pra, pikërisht.

6 PY. Do t'ju tregoj një dokument lidhur me një vizitë një muaj
7 më pas në Prishtinë.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] I lutem Sekretares të nxjerrë në
9 ekran dokumentin 065193-065195, ju lutem.

10 PY. Z. Rubin, ky është artikulli i *Associated Press* i 29
11 korrikut 1999, rreth një muaj artikullit të *The New York*
12 *Times*, këtu raportohet për një vizitë të Sekretares Albright
13 në Kosovë. Keni qenë ju me të në këtë udhëtim?

14 PË. Po.

15 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë më poshtë. Viojmë të
16 shohim më poshtë në faqe.

17 PY. Thuhet Sekretarja Albright iu drejtua turmës dhe ju tha
18 se nuk duhet të merrnin hak, nuk ishte e nevojshme të merrnin
19 hak.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

21 PY. E shihni që:

22 "Albright doli nga takimi me Kouchner dhe Jackson me një
23 pamje pozitive sa i takon të ardhmes së kësaj province.

24 "Më pas iu drejtua një grupi të madh shqiptarësh etnik që
25 kishin ardhur ta shihnin."

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 83

1 Dhe thuhet këtu:

2 "Të mos bëjmë gabime. Për sa kohë ju do ta zgjidhni
3 Kosova do të mbetet shtëpia juaj, mëmëdheu juaj."

4 Pastaj vijon dhe thotë:

5 "Shpresoj, ju lutem, këtu në Kosovë që njerëzit të mos
6 dalin më me armë gjatë natës, të mos digjen më shtëpitë e
7 fshatrat dhe të mos ketë më kurrë masakra dhe varre masive."

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë më poshtë.

9 PY. "Po Albright po ashtu i tha që komuniteti ndërkombëtar
10 nuk do të ndihmonte më në qoftë se shqiptarë etnik do ta
11 merrnin ligjin në duart tyre."

12 Ju tha:

13 "Demokracia nuk mund të ndërtohet mbi hakmarrje dhe nuk
14 do ta keni mbështetjen e botës nëse nuk jeni tolerantë dhe e
15 merrni ligjin në duart tua."

16 Shkojmë dhe më poshtë, thuhet:

17 "Pati një moment të tensionuar pas fjalimit të Albright
18 kur u takua me Hashim Thaçin, kreun e Ushtrisë Çlirimtare të
19 Kosovës dhe *de facto* drejtuesin e shqiptarëve etnikë të
20 Kosovës.

21 "Pati të shtëna me armë zjarri teksa Thaçi shkoi tek
22 selia e Kombeve të Bashkuara për të takuar Albright."

23 Pikë së pari, a ju kujtohet ky fjalimi që ka mbajtur
24 Albright në Prishtinë për turmën atje?

25 PË. Po.

1 PY. Fjalët që thuhet se i ka thënë ajo, a përputhen me atë
2 çka ju kujtohet dhe ju?

3 PË. Po.

4 PY. A ju kujtohet se më vonë, më pas atë ditë ajo u takua me
5 z. Thaçi?

6 PË. Po.

7 PY. Ju keni qenë i pranishëm në takimet me z. Thaçi?

8 PË. Absolutisht, po.

9 PY. A ju kujtohet gjatë këtij udhëtimi që Sekretarja e
10 Shtetit t'i ketë thënë Hashim Thaçit se ai do të mbante
11 përgjegjësi penale për krimet që do të kryheshin në Kosovë pas
12 hyrjes së KFOR-it?

13 PË. Absolutisht, jo.

14 PY. A i tha ajo atij që ai duhet t'i hetonte e t'i ndiqte
15 penalisht krimet që po kryheshin?

16 PË. Nuk më kujtohet. Mund t'ju them, mesa më kujtohet mua,
17 ajo mund të donte t'ia jepte këtë mesazh, donte të thoshte që
18 duhet të ketë tolerancë, ju lutem, të keni parasysh të jeni
19 tolerantë dhe jo në formën siç e thatë ju.

20 PY. Kur thoni "tolerancë", çfarë doni të thoni?

21 PË. Ajo ishte një person që e kuptonte shumë rëndësinë e
22 hetimit të krimeve të luftës, pra, që personat fajtorë të
23 ndiqeshin penalisht dhe të ndëshkoheshin. Ky ishte thelbi i
24 Tribunalit të Krimeve të Luftës, ajo besonte në këtë objektiv,
25 pra, kur ka luftëra, ku personat kryejnë vepra penale, krime,

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Misetic

Faqe 85

1 këta të ndiqen penalisht në grup, por jo personi që e ka kryer
2 krimin.

3 Dhe përmes proceseve të rregullta juridike të caktoheshin
4 apo të mbaheshin përgjegjës penalisht personat, por në këtë
5 formë ndalohen dhe aktet hakmarrëse. Dhe kur lejohet faji
6 kolektiv dhe ky përgjithësohet përmes deklaratave apo
7 politikave apo procedurave juridike, atëherë cikli i dhunës
8 vijon nuk ndërpritet. Dhe ajo këtë ma komunikoi. Dhe unë e
9 kuptova shumë mirë çfarë donte të thoshte. Prandaj dhe ajo
10 donte të ekzistonte tribunali për krimet e luftës në mënyrë që
11 personat të dënoheshin në bazë të ligjeve, në bazë të
12 rregulloreve dhe të mos lejohej faji kolektiv. Dhe ky ishte
13 pikërisht qëllimi i tribunalit. Madje ajo ka folur lidhur me
14 këtë. Dhe unë kështu e kam kuptuar këtë pjesë të botës. Ajo
15 donte t'i thoshte atij: Ji tolerant, bëj ç'të mundesh që dhe
16 personat dhe populli yt të jetë tolerant dhe na e lërë ne ta
17 zgjidhim sesi personat do të mbajnë përgjegjësi penale për atë
18 që kanë kryer në mënyrë që të mos përgjithësohet dhuna dhe
19 faji.

20 PY. Faleminderit, z. Rubin.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, ky dokument është
22 pranuar më përpara përmes një mocioni, por, do ju lutesha t'i
23 jepnim numrin përkatës.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
25 jepini numrin përkatës dokumentit 065913-065195.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 86

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
2 numrin e provës 1D292.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

5 PY. Z. Rubin, faleminderit që ju përgjigjët pyetjeve të mia.

6 Unë me kaq i mbyll pyetjet për ju.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbrojtja e

8 Veselit kur të jeni gati. Nuk keni pse nxitoni.

9 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

10 Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon:

11 Z. DIXON: [Përkthim]

12 PY. Mirëdita, z. Rubin. Unë quhem Rodney Dixon. Unë jam

13 avokati i z. Kadri Veseli, kam disa pyetje për ju.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Fillimisht do të doja të flisnim për

15 deklaratën tuaj që ka marrë tashmë numrin e provës 1D262,

16 paragrafi 11.

17 PY. Ku shpjegoni rolin tuaj si ndihmës sekretar edhe zëdhënës

18 i Sekretares së Shtetit Madeleine Albright. Në paragrafin

19 thoni:

20 "Për të bërë punën time, çdo mëngjes lexoja të gjitha

21 raportet nga mediat, raportet e zbulimit dhe kabllogramet

22 diplomatike nga ambasadat dhe misionet tona. Zyra ime kërkonte

23 përgjigje nga zyrat e departamentit dhe i pyeste, u kërkonte

24 të sqaronin apo të shpjegonin situata të caktuara, politikat e

25 SHBA-së apo reagimet ndaj temave apo pyetjeve që mund të

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 87

1 bëheshin."

2 A është e vërtetë që përpara se të dilnit në deklaratata
3 për shtyp, pra, çdo ditë, në thelb, pavarësisht a kishte a
4 s'kishte një konferencë të tillë për shtyp, ju merrnit
5 instruksione se çfarë ndodhte në ish-vendet e Jugosllavisë
6 përfshirë Kosovën?

7 PË. Kjo ka qenë një temë me interes personal për mua dhe për
8 Sekretaren Albright, kjo ka qenë një nga punët më të
9 rëndësishme për mua të dija çfarë dinte Qeveria e Kosovës për
10 Kosovën, Bosnjën, Serbinë, ish-Jugosllavinë. Prandaj, unë bëja
11 ç'të kisha mundësinë si zëdhënës që të kisha përgjigja që t'i
12 dija, unë i dija vetë, i njihja, domethënë, ekspertët në CIA,
13 në Pentagon, persona të caktuar dhe ata siguroheshin, plus që
14 unë lexoja shumë. Isha edhe i ri, përthithja shumë material
15 dhe lexoja nga ora 6:00 e mëngjesit deri pasdite, bëja takime
16 me persona të caktuar, me ekspertë të caktuar nga njësitet për
17 krimet e luftës, për Bosnjën, Kosovën dhe ekspertë në fusha më
18 të përgjithshme. Pra, përgjigja e gjatë ishte kjo që sapo ju
19 dhashë, përgjigja e shkurtër ishte po.

20 PY. Faleminderit për përgjigjen e gjatë në fakt sepse unë
21 doja ta kuptoja si ka funksionuar. Pra, është e vërtetë që ju
22 keni pasur qasje edhe kishit shumë burime, kishit materiale
23 dhe ishit i informuar çdo ditë?

24 PË. Absolutisht, po.

25 PY. Kjo vlen për periudhën e 1998 po ashtu, sikurse për 1999

1 ku jemi dhe të fokusuar ne shumë, por ama përfshihet edhe

2 1998?

3 PË. Absolutisht, po.

4 PY. Vazhdojmë. "Kontaktet e para të autoriteteve amerikane me

5 UÇK-në ishin shumë të rëndësishme", vazhdojmë pastaj dhe

6 paragrafët 13, 14, 15. Që të kuptojmë periudhën kohore, ju

7 thoni:

8 "Në atë kohë".

9 Thoni që:

10 "Ishte dhe caktuar edhe Gelbard si i dërguar i posaçëm

11 për Ballkanin."

12 Bëhet fjalë për 1998?

13 PË. Po. Më duket se bëhet fjalë dhe për 1998. Kam një

14 paqartësi për Gelbard dhe Holbrooke, kam një mbivendosje, më

15 duket se Gelbard ishte i dërguari më formal, Holbrook ishte

16 disi më informal, po punonin shumë me njëri-tjetrin.

17 PY. Pra, Gelbard takohej me UÇK-në. Gjithmonë fokusohemi për

18 gjashtë muajt e parë të 1998?

19 PË. Po.

20 PY. Në paragrafin 15 thoni që:

21 "Mësova se disa persona të zbulimit amerikan po ashtu

22 ishin në kontakt me UÇK-në, veçanërisht Ramush Haradinaj, po

23 në atë kohë nuk kisha dijeni për ndonjë kusht të caktuar që

24 CIA t'i kishte vendosur operacioneve të UÇK-së. Sidoqoftë,

25 njësoi si me çdo partner tjetër që kishim ne, unë besoj, se

1 atyre u ishte thënë të mos angazhoheshin në veprimtari
2 terroriste apo të mos kryenin krime lufte dhe sigurisht të mos
3 promovonin fundamentalizmin islamist. Kjo ka qenë politika
4 jonë kryesore asokohe.”

5 Tani për periudhën kohore, kur mësuat se disa persona të
6 zbulimit amerikan kishin kontakte me UÇK-në, veçanërisht me
7 Ramush Haradinaj, bëhet fjalë këtu dhe për 1998, pra, gjashtë
8 muajt e parë të 1998 deri nga vera?

9 PË. Është pak më e ndërlikuar, mbase sot do ta kisha shkruar
10 ndryshe këtë.

11 Pra, unë nuk e mësova për CIA-n me Haradinaj, këtë e kam
12 mësuar vetëm në 1999-n, po në atë kohë mësova se kjo ka
13 ndodhur dhe në 1998-n. E di që Gelbard ishte takuar me UÇK-në.

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR].

18 Unë jam përpjekur të them këtu që oficerët e CIA-s që e
19 njihnin administratën Clinton do ta kishin ditur se ka pasur
20 dy aspekte të rëndësishme për ne. Ka qenë para sulmeve të
21 shtatorit. Ka qenë para luftës Kinë-Rusi, por problemi kryesor
22 atëherë ishte islamizmi dhe krimet e luftës por në përgjithësi
23 sepse këto kanë qenë prioritetet e administratës Clinton.
24 Kështu që nëse nuk e komunikojnë këto fjalë atëherë i takon që
25 s’e bëjnë punën. Këtë jam përpjekur të them unë në këtë tekst.

1 PY. Pra, është e vërtetë, sikurse thoni këtu, nuk mund të
2 ishit partnerë me asnjë organizatë në qoftë se kjo organizatë
3 mund të ishte përfshirë në aktivitete terroriste apo krime
4 lufte dhe ju doni të siguroheshit që të kishit sa më shumë
5 informacion lidhur me këtë temë, apo jo?

6 PË. Do t'ua bëj shumë të qartë këtu. Pas Bosnjës, ku menduam
7 se e ndaluam një luftë dhe ndihmuam krijimin e një shoqërie
8 tolerante dhe të mos ishte kaotike, ne ishim krenarë për këtë
9 që bëmë. Dhe pamë një situatë të re në Kosovë. Dhe ne donim të
10 siguroheshim që të ishim në anën e engjëjve, themi ne, në anën
11 e të mirëve dhe nuk donim që ata të ishin viktima. Po s'mund
12 të ishin viktima nëse do të kryenin krime lufte. As nuk do të
13 ishin viktima nëse do të kishin qasje ekstremiste islamiste.
14 Në këtë kohë, Amerika ishte superfuqi, sigurisht. Donim të
15 ishim në anën e viktimave dhe në qoftë se ndodhte diçka
16 ndryshe kjo i takonte që të ishte kundër çdo gjëje që besonte
17 Madeleine Albright, Clinton dhe unë rrjedhimisht.

18 PY. Pra, ju e merrni të gjithë informacionin, e lexoni me
19 shumë vëmendje, shihnit emrat e personave në të dhe
20 verifikoni informacionin përpara se të flisnit lidhur me të?

21 PË. Absolutisht. Ne nuk donim të bënim operacione ushtarake
22 apo të harxhonim me miliarda dollarë për persona apo
23 organizata që nuk shprehnin tolerancë të paktën publikisht.
24 Kini parasysh këtë janë persona pa pushtet. Këta ishin
25 viktima. Ne takoheshim me ta, ndërkohë që ata ishin viktimat e

1 një shtypësi. Ishin persona që ishin në anën e kundërt të
2 pushtetit në Kosovë dhe ne donim të siguroheshim që ata të
3 ishin të lirë dhe të mos ndiqnin politikat e shtypësit nga të
4 cilët donin që të shpëtonin.

5 Pra, ne nuk donim të ishim në anën e atyre që nuk ndiqnin
6 të njëjta objektiva dhe ne jemi përpjekur shumë që kjo të mos
7 ndodhte. Dhe do kishte shumë keq për ne në qoftë se do kishte
8 pasur bazë për akuzat që ngriheshin.

9 PY. Vazhdojmë me kronologjinë, në paragrafin 16, thoni:

10 "Pas shpërthimit të serbëve kundër shqiptarëve të Kosovës
11 në verën e 1998 ..."

12 U bë një marrëveshje në tetor të 1998-s mes Ambasadorit
13 Holbrook dhe Slobodan Milosevic. Kjo periudhë, pra, vera e
14 1998-s deri nga tetori i 1998-s, nga informacioni që keni
15 pasur ju, ju e dini që ka pasur një shtrirje, ka pasur shumë
16 sulme prej forcave serbe kundër shqiptarëve të Kosovës në
17 pjesë të ndryshme të Kosovës, apo jo?

18 PË. Po, po. Na shqetësoi shumë, na shqetësonin raportet që
19 merrnim, familje që vriteshin, që u digjeshin shtëpitë dhe
20 vriteshin thjesht sepse ishin shqiptarë, shqiptarë të Kosovës.
21 Kjo filloi në fakt të ngjasonte me krizën e Bosnjës, ku u
22 vranë njerëz, u masakruan thjesht për shkak të etnisë së tyre
23 dhe jo për diçka se kishin bërë. Dhe filluam që të shihnim që
24 po shfaqej e njëjta politikë, e njëjta gjë dhe kjo na bëri që
25 të vepronim, ata ishin viktima jo vetëm se kishin qenë të

1 shtypur me dhjetëra vite por po masakroheshin nga forcat
2 paraushtarake dhe ushtarake serbe. Dhe ne nuk donim që të
3 përsëritej tmerri i Bosnjës në Kosovë, ky ishte qëllimi i
4 politikës sonë, të parandalonim të përsëritej e njëjta gjë.
5 PY. Vazhdojmë tek Rambujeja. Për Rambujenë, në paragrafin 17,
6 thoni që:

7 "Marrëveshja funksionoi për disa javë."

8 Por pastaj pati sulm tjetër nga serbët kundër shqiptarëve
9 në Kosovë në janar të 1999. Dhe, më pas, kalojmë në fazën
10 tjetër që është Konferenca e Rambujesë. Kështu ka funksionuar,
11 kështu janë shpalosur ngjarjet, apo jo?

12 PË. Paragrafi 17 është shumë i rëndësishëm, do të thoja,
13 sepse pikërisht këtu bota, rusët, Shtetet e Bashkuara vendosën
14 të angazhoheshin në nivel serioz dhe përdornin forcat
15 ushtarake, NATO-n, madje bashkëpunuan dhe me rusët asokohe të
16 përpiqeshim ta parandalonim një gjenocid tjetër. Menduam se
17 ekzistonte rreziku, do të kishim një rast tjetër gjenocidi.
18 Ishte një risk real, rrezik real dhe nuk donim që kjo të
19 ndodhte. Donim që gjithë bota të bashkohej të bënte diçka
20 unike, t'u ofronte marrëveshjen, të zbatohet kjo marrëveshje
21 me forcat e NATO-s dhe kjo ishte thjesht e drejtë, do
22 përmbusheshin objektivat e të dyja palëve por ua bëmë të qartë
23 që në qoftë se nuk respektohet marrëveshja kjo do të ketë
24 pasoja.

25 Dhe kjo ka qenë diçka unike që bota s'e kishte bërë kurrë

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 93

1 më përpara me sa kam unë dijeni, ka qenë vërtetë e
2 jashtëzakonshme nga pikëpamja diplomatike asokohe të
3 dislokoreshin këto forca.

4 Z. DIXON: [Përkthim] Ju kërkojmë ndjesë përkthyesve për
5 shpejtësinë.

6 PY. Dua të fokusohemi në një aspekt tjetër të gushtit dhe të
7 shtatorit të 1998, mënyra sesi ju merrnit informacione dhe si
8 i përcillnit këto informacione, si i përcillnit deklaratat
9 tuaja të Departamentit të Shtetit.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Pikë së pari, kërkojmë që të nxirret
11 në ekran materiali DKV1783-1783. Do dali në ekranin tuaj, z.
12 Rubin. Është një njoftim për shtyp, deklaratë për shtyp që e
13 keni nxjerrë ju, 23 shtator 1998.

14 PY. E shihni?

15 PË. Po.

16 PY. Ju kujtohet ky njoftim për shtyp, në qoftë se i hedh një
17 sy shpejt e shpejt?

18 PË. Më duhet të them që mesa kujtoj ka qenë njoftim formal i
19 Departamentit të Shtetit që ka përgatitur zyra për reagimet
20 humanitare, zyra për refugjatët dhe të drejtat e njeriut, ka
21 lidhje me para. Unë nuk kam qenë shumë i përfshirë në
22 përgatitjen e këtij njoftimi për shtyp, thjesht e kam
23 miratuar, nëse më kuptoni. Ka një dokument shumë burokratik
24 ky, thjesht ka dalë në emrin tim pasi e lexova dhe e miratoi
25 Sekretarja Albright.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 94

1 PY. Shohim në paragrafin 3 ku thuhet:

2 "Konflikti i armatosur në Kosovë ka çuar në më shumë se
3 300.000 persona të zhvendosur refugjatë dhe viktima të tjera
4 në këtë konflikt".

5 Bëhet fjalë për shtatorin e 1998-s. Këtë informacion nga
6 e keni marrë, nga ka ardhur ky informacion?

7 PË. Kjo ka ardh nga zyra për refugjatët në Departamentin e
8 Shtetit, kjo zyrë e ka marrë këtë informacion ka të ngjarë nga
9 personat në terren të cilët ishin organizata joqeveritare,
10 organizata të tjera që kujdeseshin për këta persona të
11 zhvendosur, për refugjatët. Dhe këtë informacion e kanë
12 grumbulluar dhe ia kanë kaluar zyrës përkatëse, zyra e
13 përpunoi dhe doli me shifrën 300.000 persona të zhvendosur.

14 PY. Pra, ky është një informacion që ju e rishikonit, apo jo,
15 në kuadër të punës suaj të përditshme?

16 PË. Absolutisht, po. Që të jemi të qartë, ky ishte një
17 informacion që unë zakonisht e merrja, përpigësja ta
18 verifikoja saktësinë e informacionin bazuar në atë çka dija.

19 Por unë e merrja nga zyrat që vetë zyrat e merrnin nga
20 personat në terren edhe Komisioneri i Lartë i Kombeve të

21 Bashkuara për refugjatët [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]. Por personat në terren e dinin më shumë se kushdo
23 tjetër shifrat e sakta.

24 PY. Shohim një deklaratë tjetër për shtyp që ka bërë James
25 Foley, ka qenë zëdhënësi në detyrë asokohe.

1 Z. DIXON: [Përkthim] Ju lutem, të nxirrni në ekran
2 materialin DKV1781-1782.

3 PY. Ndonjëherë z. Foley bënte deklarata për shtyp, apo jo?
4 PË. Po, por ai i lëshonte këto deklarata për shtyp. Ishin
5 deklarata me shkrim jo me gojë, joverbale. Mbase unë kam qenë
6 diku me detyrë duke udhëtuar dhe dilte kjo deklaratë nga
7 departamenti, ai ishte zëvendësi im, ai ndiqte të njëjtin
8 proces që ndiqja dhe unë, verifikonte saktësinë, verifikonte
9 ekstraktet edhe lejonte lëshimin e një deklarate.

10 PY. Pra, nëse shohim paragrafin e katërt, ku thuhet:
11 "Si rezultat i konfliktit në vazhdimësi e sipër, janë
12 rreth 250.000 persona të zhvendosur në Kosovë dhe 26.000 në
13 Malin e Zi, plus 14.000 refugjatë në Shqipëri."
14 Dhe thuhet pastaj:
15 "Mendohet se ka rreth 60.000, rreth 100.000 persona në
16 Kosovë pa strehë, një situatë që po bëhet gjithnjë edhe më e
17 vështirë me ardhjen e dimrit."
18 Nga ka ardh ky informacion?

19 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtoj. Kjo pjesë pyetjesh nëse
20 më lejohet duhet të ketë dhe bazën, çfarë relevance ka kjo. U
21 përmend një urdhër këtu i 12 majit edhe keni dhënë një urdhër
22 me gojë dhe lidhur me këtë, lidhur me këto aspekte, këto
23 aspekte nuk kanë asgjë relevante.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila është
25 relevanca?

1 Z. DIXON: [Përkthim] Dua të kuptoj sesi ka ardh
2 informacioni nga terreni, kjo është relevante, sepse kjo na
3 ndihmon të kuptojmë çfarë dinim për UÇK-në dhe për të
4 akuzuarit në këtë çështje gjyqësore. Nuk kam nevojë të bëj
5 parashtrim për këtë, por sigurisht që është relevante sepse
6 duam të kuptojmë se çfarë informacionesh merreshin asokohe dhe
7 si merreshin.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
9 Rrëzohet kundërshtimi. Të shohim ku do dilni.

10 Z. DIXON: [Përkthim]
11 PY. Edhe një herë, z. Rubin, nga vinte ky informacion? Vetëm
12 kaq mund të përgjigjeni.

13 PË. Nga organizatat humanitare në terren që i jepnin
14 informacion zyrave përkatëse të Departamentit të Shtetit të
15 cilat konfirmoheshin nga burimet e inteligjencës sa i takon
16 krizës të jashtëzakonshme humanitare. Pra, kishte krizë
17 humanitare, po ndodhte një krizë humanitare, po afrohej dimri.
18 këta ishin persona që kishin nevojë për strehë, kishin nevojë
19 për mbështetje, ne nuk mund ta lejonim që të bëhej dhe më keq
20 se bëhej fjalë për dhjetëra mijëra persona që mund të vdisnin
21 nga uria, nga i ftohti apo për mungesë të ilaçeve, mjekimeve,
22 barnave. Kështu ka ardhur informacioni.

23 PY. Dua t'ju tregoj një tjetër dokument, është një dokument
24 prej jush, pra, është një njoftim për shtyp i juaji.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Për procesverbal, është dokumenti

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 97

1 DKV1776 deri në 1780. Do i kërkoja Sekretares ta paraqesë në
2 ekran dokumentin.

3 PY. Është një njoftim për shtyp, pra, këtu pasqyrohet ajo
4 çfarë keni thënë ju, jepen pyetjet e gazetarëve dhe përgjigjet
5 e dhëna. A është ky formati që kujtoni të keni përdorur
6 asokohe, Dëshmitar?

7 PË. Po.

8 PY. Le të kalojmë tek faqja DKV1777, në fillim të këtij
9 dokumenti, pra, në këtë faqe, ju jepni përgjigje. Pra, këtu ju
10 bëni sqarimin e procedurës më tepër sesa të thelbit:

11 "Por më shumë unë jam e interesuar për atë çka të bëjë me
12 informacionin në kohë reale që vëzhgohet nga verifikuesit.
13 Monitoruesit po bëjnë gjykim të asaj çfarë ata shohin. Unë
14 këtu nuk po ju jap një urdhër të plotë ose nuk po ju jap një
15 panoramë të plotë të luftimeve dhe situatës që ndodhë atje po
16 thjesht jepet një përmbledhje e situatës. Shefi im i misionit
17 monitorues Shaun Byrnes ia ka dhënë këtë informacion disa prej
18 kolegëve tanë në terren, por edhe unë dëshiroj që t'ju jap një
19 pjesë të informacionit që i ka dhënë ai personave në terren."

20 Pyetja që kam për ju është kjo, informacionin e keni
21 marrë nga Shaun Byrnes, si shefi i KDOM-it amerikan në atë
22 kohë?

23 PË. Po. Kjo ka ardhur si rezultat i marrëveshjes së tetorit
24 që u dha verifikuesve në teori më tepër qasje. Pra, Shaun
25 Byrnes e njihja mirë, e njohja personalisht dhe njihej në

1 rrethin tonë si person i cili jepte informacion të saktë dhe
2 këtë informacion ose ma ka dhënë mua vetë ose ekipit tonë.
3 Mund të na e ketë dhënë me gojë ose shkrim dhe ai na ka dhënë
4 informacion lidhur me lëvizjet e forcave serbe që ka qenë në
5 fushëveprimin e marrëveshjes së tetorit, pra, ky është një
6 informacioni i verifikuar në terren, domethënë, është
7 informacioni më i saktë i mundshëm që ti mund të merrje nga
8 terreni.

9 PY. Këtu flasim më 27 tetor të 1997-s, po flasim, pra, për
10 atë lloj informacioni që juve e keni marrë në të përditshmen
11 tuaj, pra, është informacion që është marrë pas 27 tetorit
12 1998.

13 A është informacion i zakonshëm ky që ju merrnit?

14 PË. Po.

15 PY. Po informacion nga strukturat e UÇK-së a merrni ose
16 informacion lidhur me strukturat e UÇK-së?

17 PË. Mbase jo, sepse qëllimi kryesor i marrëveshjes ishte që
18 të monitorohej ajo çfarë bënin forcat serbe, domethënë,
19 qëllimi kryesor ishte që forcat serbe të largoheshin nga
20 Kosova. Sigurisht që kishte aspekte të caktuara ose probleme
21 që mund të ekzistonin ndërmjet forcave serbe ose UÇK-së dhe
22 guerilëve, forcat guerile të UÇK-së. Dhe marrëveshja e
23 tetorit, në vetvete, me aq sa më kujtohet mua dhe sikurse e
24 thashë edhe më herët, kishte të bënte me mënyrën sesi do të
25 lëviznin serbe, sesi mund të vendoseshin, të tërhiqeshin ato,

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Dixon

Faqe 99

1 ne ishim më shumë të interesuar me pjesën e verifikimit në
2 qoftë se masat përkatëse po merreshin nga ushtria serbe.
3 PY. Ju merrnit këtë lloj informacioni po nga ana tjetër nuk
4 është se merrnit këtë lloj informacioni të detajuar sa i takon
5 UÇK-së nga burime të tjera për t'u siguruar që ju e dini se me
6 çfarë po merreshit, apo jo?

7 PË. Po.

8 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë, sepse përgjigja u dha
9 më përpara. Tha që:

10 "Nuk e di mbase është marrë informacioni, mbase jo."

11 U dha përgjigja. Nuk ka arsye që të vazhdojmë më tej.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mos e bëni më
13 këtë pyetje. Mund të bëni një pyetje tjetër.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Do ju bëj një pyetje tjetër atëherë.

15 PY. Çfarë lloj informacioni i shikonit ju asokohe?

16 PË. Në atë kohë, në 1998, në tetor, ne ishim të përqendruar
17 tek informacioni lidhur me forcat serbe, por ishim të
18 interesuar gjithashtu edhe për zhvillimet e reja, zhvillime të
19 cilat quheshin dalja më tepër në pah e UÇK-së. Këto ishin
20 koncepte që nuk i kuptonim mirë, po kishte zëra dhe ne ishim
21 të interesuar të merrnim më shumë informacion. Ishin
22 informacione që kryesisht ne i merrnim nga forcat inteligjente
23 ose nga burimet diplomatike në terren që mbase kishin kontakte
24 me shqiptarët e Kosovës që mund të jepnin informacione të
25 caktuara.

1 Kur flitet për marrëveshjen e tetorit, marrëveshja e
2 tetorit kishte të bënte me forcat serbe. Ndërkohë ne po
3 mësonim më tepër lidhur me luftën sepse lufta po zhvillohej
4 sepse UÇK-ja mori në dorë fatin e njerëzve të vet duke mos
5 lejuar më masakrimin e tyre, pra, UÇK-ja u përgjigj dhe Serbia
6 u përgjigj po ashtu ose u kundërpërgjigj. Dhe për këtë arsye
7 masakra vazhdoi. Për këtë arsye ne kishim burime të ndryshme
8 informacioni, merrnim informacioni nga verifikues të shumtë në
9 terren, [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR] edhe mjete të tjera

11 informacioni me të cilët mbaheshim të përditësuar.

12 PY. Më herët gjatë dëshmisë tuaj, ju thatë dhe për
13 procesverbal e keni thënë në faqen 62 të transkriptit në kohë
14 reale. Do t'ua lexoj, nuk do jua tregojmë në ekran. Ju thatë
15 që:

16 "... nuk besonit që ekzistonte një sistem kontrolli, atë
17 çfarë ju e quani një sistem të organizuar. Ose nuk është se
18 ekzistonte një njësi e organizuar kontrolli që mund të
19 identifikohet personi që ishte në majë të strukturës dhe që
20 diktonte ose urdhëronte se çfarë duhet të ndodhte."

21 Ky ishte një vlerësim i juaji, një vlerësim që e keni
22 bërë në 1999. Dhe a do ishte e saktë të thuhej që i njëjti
23 vlerësim do të ishte i vërtetë edhe për periudhën e vitit 1998
24 derisa është kaluar në 1999 dhe më pas me Marrëveshjen e
25 Rambujesë?

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 101

1 PË. Besoj se situata ka qenë më shumë kështu në 1998-n. Por
2 gjithsesi gjatë ditëve të para, ne u munduam që të merrnim sa
3 më shumë informacion për të pasur një pasqyrë ose panoramë më
4 të saktë asaj çfarë përfaqësonte UÇK-ja. Ne me kalimin e kohës
5 po merrnim informacion gjithnjë e më tepër të mirë, më të mirë
6 për të kuptuar se çfarë strukture ishte.

7 PY. Ndërkohë që merrnit më shumë informacion a e kuptuat më
8 qartë se cilat ishin këto strukturat e UÇK-së?

9 PË. Po. Si NATO-s, Shtetet e Bashkuara, forcat e mëdha
10 gjithmonë e më tepër i kushtonin rëndësi situatës në terren,
11 caktonin më shumë burime, kishin më shumë kontakte dhe
12 gjithmonë e më tepër po përpiqeshim që të mësonim më shumë
13 lidhur me situatën. Megjithatë deri në okupimin e NATO-s në
14 Kosovë, ne nuk e kemi besuar asnjëherë që UÇK-ja kishte
15 strukturë që ne e mendonim që ishte një strukturë e
16 mirëorganizuar ushtarake.

17 PY. Faleminderit. Nuk kam pyetje të tjera për ju, Dëshmitar.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Dixon.

20 Roberts?

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kemi pyetje për
22 këtë dëshmitar.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Alagendra,
24 mund të filloni.

25 Pyetje të palës tjetër nga znj. V. Alagendra:

1 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Unë jam znj. Alagendra dhe
3 përfaqësoj z. Krasniqi.

4 Në paragrafin 21 të deklaratës tuaj dhe sot ju njoftuat
5 edhe thatë se pas bisedimeve, pasi filluan bisedimet, juve u
6 informuan që delegacioni shqiptar i Kosovës ishte mbledhur dhe
7 kishte caktuar një përgjegjës. Dhe ky përgjegjës për bisedat
8 në Rambuje ishte z. Thaçi, a është kështu?

9 PË. Po.

10 PY. Pjesë të delegacionit shqiptar në Kosovë ka qenë edhe z.
11 Krasniqi, apo jo?

12 PË. Besoj se po, por nuk më kujtohet mirë. Pra, ishte një
13 grup prej tre personash të cilët e kontaktonim në mënyrë të
14 vazhdueshme, por mendoj që z. Krasniqi nuk ka qenë pjesë e
15 këtij grupi të ngushtë.

16 PY. Por besoj që e dini që z. Krasniqi ka qenë pjesë e
17 delegacionit, sepse z. Krasniqi ka qenë zëdhënës i UÇK-së, apo
18 jo?

19 PË. Po. Sa më kujtohet z. Krasniqi ka qenë personi i parë që
20 unë kam parë nga delegacioni.

21 PY. A do ishte e saktë të thuhej që z. Krasniqi ka qenë pjesë
22 e delegacionit shqiptar në Konferencën e Rambujesë deri në
23 fund?

24 PË. Nuk e di.

25 PY. Ideja është, domethënë, që ka qenë gjatë gjithë kohës,

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 103

1 apo jo?

2 PË. Nuk e di. Mendoj se po.

3 PY. Pra, ju thatë që keni pasur kontakte shumë minimale me z.
4 Krasniqi dhe thatë gjithashtu që personi kryesor i kontaktit
5 nga delegacioni shqiptar ishte z. Thaçi, apo jo?

6 PË. Po. Bashkëbiseduesi im kryesor ishte z. Thaçi. Megjithatë
7 ekipi i Shteteve të Bashkuara - keni parasysh që unë isha
8 thjesht një prej anëtarëve të ekipit amerikan - por ekipi
9 amerikan ka pasur kontakte me të gjithë grupin prej këtyre
10 katër pjesëtarëve të delegacionit shqiptar të Kosovës, po kanë
11 pasur kontakte gjithashtu edhe me Veton Surroin apo me persona
12 të tjerë, me Rugovën e të tjerë. Megjithatë sa më takon mua
13 personi kryesor i kontaktit për mua ka qenë z. Thaçi.

14 PY. Në paragrafin 24, po edhe sot, juve na përmendët
15 shqetësimet që kanë ndarë z. Thaçi me ju, përkatësisht që ai
16 nuk e kishte të mundur që të nënshkruante marrëveshjen pa
17 marrë miratimin e UÇK-së, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Në deklaratën tuaj ju thoni që:

20 "Vendimmarrja duhej marrë nga aspekti ushtarak, apo jo,
21 jo personat që ishin të pranishëm në Rambuje."

22 PË. Po.

23 PY. Në paragrafin 25 të deklaratës ju thoni që z. Thaçi nuk
24 ishte në gjendje që të nënshkruante sepse delegacioni shqiptar
25 i pranishëm në Rambuje duhej që të konsultohet me komandantët

Dëshmitari: James Rubin (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 104

1 në Kosovë, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. A është e saktë që duhej që të zhvilloheshin konsultime
4 me drejtuesit ushtarakë në Kosovë jo me anëtarët e
5 delegacionit që ishin së bashku me z. Thaçi në Rambuje?

6 PË. Thua jse kështu. Mënyra sesi e kam kuptuar unë saj kohe
7 është që pjesa dërrmuese e anëtarëve të delegacionit ishin
8 mbështetës të nënshkrimit të marrëveshjes. Ata që ishin pjesë
9 të UÇK-së që ishin një përqindje e vogël, nuk e di t'jua them
10 me ekzaktësi, ndoshta dy ose tre a katër, por këta persona
11 duhej që të merrnin miratimin, Thaçi ishte një prej personave
12 të këtij grupi të vogël, pra, duhej që të merrnin miratimin e
13 udhëheqësve në Kosovë. Unë nuk e di se kush ishin ekzaktësisht
14 këta persona.

15 Për shembull, nuk e dinim znj. Albright kontaktoi me z.
16 Demaçi sepse nuk e dinim se me kë kishin kontakte, kë
17 kontaktonin ata në Kosovë. Por ajo çfarë dimë ne ishte që
18 duhet të konsultoheshin përpara sesa të jepnin shkrimin e
19 tyre.

20 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do ju kërkoja të kalonim në
21 seancë private, nëse është e mundur i nderuar Kryegjykatës.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
23 në seancë private.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

Dëshmitari: James Rubin (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 105

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Rubin (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 106

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2 [Seancë e hapur]

3 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
4 jemi në seancë publike.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Kjo është kabllograma e 10 marsit 1999. Në krye të faqes
7 në paragrafin e parë, e shihni aty ku thuhet që z. Krasniqi
8 është pjesë e krahut politik të UÇK-së dhe si i moderuar, a e
9 shikoni këtë?

10 PË. Po.

11 PY. A është në përputhje me atë çfarë mendoni ju për rolin e
12 z. Krasniqi atëherë?

13 PË. Po.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull. Le të kalojmë
15 në faqen e tretë që është 075396.

16 PY. Do ju kërkoja që të lexonit paragrafin 3, nëse është e
17 mundur.

18 PË. E lexova.

19 PY. Pajtoheni me mua që ai që e ka shkruar këtë kabllogram e
20 ka përshkruar z. Krasniqi si dikë me pikëpamje të ndryshme nga
21 komandantët e tjerë të UÇK-së, a është e saktë?

22 PË. Po.

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Të kalojmë në një tjetër
24 provë materiale.

25 Do i kërkoja Sekretarisë që të paraqesë në ekran provën

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 107

1 P1069. Në faqen 075318.

2 PY. Paragrafi 11 në këtë faqe. Do ju kërkoja ta lexonit,

3 Dëshmitar?

4 PË. E lexova.

5 PY. A pajtoheni me mua që të moderuarit brenda UÇK-së ishin

6 të gatshëm, ishin pro një zgjidhjeje ose një marrëveshjeje të

7 përkohshme, a pajtoheni me mua lidhur me këtë?

8 PË. Po.

9 PY. Të kalojmë tek faqja -- jo të qëndrojmë në të njëjtin

10 paragraf, së pari paragrafi flet për radikalët për dy kahe ose

11 dy krahë, radikalët besojnë që janë ata të cilët mendojnë që

12 nuk është e mundur një zgjidhje e negociuar dhe që Kosova mund

13 të shkëputet prej Serbisë vetëm me anë të forcës?

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do kërkoja që të

15 kalonim në një tjetër faqe të njëjtit dokument. Të shohim

16 paragrafin 11. Përsëri, besoj, që këtu lexoni që z. Krasniqi,

17 Ramë Buja dhe z. Bashota përshkruhen si të moderuar brenda

18 UÇK-së?

19 Z. PACE: [Përkthim] Nuk i kuptoj pyetjet e bëra. Nuk e di

20 çfarë pyetje po i bëhet dëshmitarit sa i takon këtij

21 dokumenti? Nuk e kuptoj pyetjen e avokates.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po, në transkript në faqen

24 39, z. Rubin u pyet lidhur me ekstremistët.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po cila është

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagenda

Faqe 108

1 pyetja juaj?

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Pyetja ime është kjo: A
3 pajtoheni me mua që z. Krasniqi, z. Buja dhe z. Bashota ishin
4 persona të moderuar në UÇK?

5 DËSHMITARI: Po.

6 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në rregull.

7 Le të shohim faqen 075330.

8 PY. Ju lutem lexoni informacionin që keni përpara në ekran.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për cilin
10 paragraf e keni fjalën?

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Paragrafi 1. Paragrafi i
12 parë.

13 DËSHMITARI: E lexova.

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

15 PY. Pikëpamjet e radikalëve që përshkruhen këtu, që janë të
16 përgatitur që të sakrifikojnë mijëra jetë të personave të
17 pafajshëm, a është në të njëjtën linjë me atë çfarë ju na keni
18 thënë sot në faqen 39, ku thoni që ekstremistët "ishin të
19 gatshëm që të vendosnin në rrezik jetën e mijëra njerëzve
20 vetëm për pak fjalë në një dokument"?

21 PË. Po dhe është kënaqësi që shikoj që është e vërtetë ajo
22 çfarë -- gjithmonë kam menduar që është e vërtetë që personat
23 që ishin kundër Rambujesë dhe ishin të gatshëm që të
24 masakronin dhe të venin në rrezik jetën e mijëra e mijëra
25 qytetarëve të pafajshëm, pra, nga njëra anë kishim këta

1 persona ekstremistë por nga ana tjetër ne kishim persona të
2 moderuar si z. Krasniqi, z. Hashim Thaçi, që donin që të
3 nënshkruhej marrëveshja e Rambujesë në mënyrë të tillë që
4 Kosova të çlirohej në mënyrë të tillë që të përfitonin nga
5 mbështetja e perëndimit dhe pa qenë e nevojshme jetën e mijëra
6 njerëzve. Dhe falë Zotit ata nuk iu vesh -- nuk i dëgjuan
7 fjalët e ekstremistëve.

8 PY. Më herët gjatë pyetjeve tua ju folët lidhur me hetimet
9 që Shtetet e Bashkuara kishin ndërmarrë në mënyrë të tillë që
10 të kishin një përgjigje lidhur me pretendimet e përsëritura që
11 kishin të bënin me një program të drejtuar nga udhëheqja e
12 UÇK-së lidhur me ekzekutimet edhe me vrasjet. Dhe ju thatë që
13 ju keni mbledhur të gjithë informacionin e mundshëm.

14 Po ashtu në paragrafin 66 të transkriptit ju thatë që
15 jeni konsultuar me zyrtarë, me ekspertë ushtarakë, me persona
16 të komunitetit të inteligjencës dhe që nuk keni gjetur asnjë
17 informacion që i lidhte pretendime të tilla për vrasje dhe
18 ekzekutime me z. Thaçi. A pajtoheni me mua që nuk keni gjetur
19 asnjë lidhje midis këtyre pretendimeve dhe akuzave dhe z.
20 Krasniqi po ashtu?

21 PË. Ne nuk kemi gjetur asnjë të dhënë, asnjë provë, asnjë
22 informacion që lidhte pretendime të tilla për ekzekutime dhe
23 për vrasje me udhëheqës të tillë. As me z. Krasniqi, as me z.
24 Thaçi. Rreth 25 vite pasi jam larguar nga qeveria kam pyetur
25 të gjithë ata që mund të kishin pasur informacion lidhur me

1 këtë pretendim. Dhe jo vetëm në vitet 2000, por edhe dekada më
2 vonë, kur miqtë e shokët e mi kishin mundësi që të më jepnin
3 informacione që kishin qenë informacione inteligjente njëherë
4 e një kohë, asnjëherë nuk më kanë dhënë të dhëna ose
5 informacion që të bëjnë lidhjen e këtyre pretendimeve me
6 ndonjë nga drejtuesit e UÇK-së.

7 PY. A e kam të saktë, z. Rubin, që në administratën e fundit
8 të Biden ju jeni caktuar nga Sekretari Blinken si sekretar?

9 PË. Po.

10 PY. Dhe ju keni pasur në fokusin tuaj çështjen e ofruesve të
11 disinformacionit, domethënë, çështja e disinformacionit ose e
12 keqinformacionit ka qenë një prej fokuseve kryesore të punës
13 tuaj?

14 PË. Po.

15 PY. Në intervista të shumta që keni dhënë ju keni folur për
16 kërcënimet e mëdha që lidhen me keqinformimin ose
17 disinformimin. Dhe e keni thënë që "ju e keni mësuar më pas
18 madhësinë ose rëndësinë e madhe të informacionit të përdorur
19 kundër nesh nga Rusia dhe Kina"?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe po ashtu në një intervistë me Zërin e Amerikës më
22 datë 20 qershor 2024 ju e keni thënë këtë gjë, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Në intervistë keni deklaruar gjithashtu që Rusia ka
25 përdorur disinformimin ose keqinformimin për të gjithë botën

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 111

1 për sa i takon situatës se si ajo ishte në Ballkanin

2 Perëndimor, a është e saktë kjo, Dëshmitar?

3 PË. Po.

4 PY. A është e saktë të thuhet që nga përvoja jua e gjatë me

5 Ballkanin Perëndimor dhe me Serbinë e Milosevic, a është e

6 saktë të thuhet që mund të ishte pjesë e skenarit rus pjesa e

7 disinformimit?

8 PË. Duke e ndjekur çështjen në vitet 1990, por gjithashtu

9 edhe më pas në vitet 2000 e më tej, unë kam mbërritur në

10 përfundimin se shumë, në qoftë se jo të gjitha akuzat të

11 kriminalitetit, përfshirjes, vrasjeve, ekzekutimeve apo

12 akuzave dhe pretendimeve të tilla ishin të fabrikuara dhe

13 ishin të lidhura kryesisht me fushata disinformimi të

14 organizuara nga rusët të ndjekur nga mbështetës rusë ose nga

15 organizata të sponsorizuara nga serbët.

16 Mund ta shtjelloj më tej, por të paktën ky është

17 përfundimi që kam nxjerrë unë pas 20 e ca kusur viteve në këtë

18 fushë, pra, kështu janë bërë gjërat, si janë promovuar, si

19 janë zmadhuar, ekzagjeruar dhe kjo përsëri duke iu kthyer

20 temës sot, këtu më shumë ka qenë ideja jonë, pra, ka qenë

21 shumë e rëndësishme që njerëzit të mbajnë përgjegjësi penale,

22 personale ose individuale dhe që të mund të mos përdorej

23 fajësia masive ose e përgjithshme për situata të caktuara.

24 PY. A pajtoheni me mua z. Rubin që propaganda dhe

25 keqinformimi ose disinformimi i tillë janë shumë të rrezikshme

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 112

1 edhe në kohë paqeje?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe narrativat false mund të nxehin më tepër dhunën, mund
4 të nxisin dhunën dhe mund të çojnë gjithashtu edhe në
5 padrejtësi, apo jo?

6 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtojmë. Këto janë pyetje jo
7 relevante.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ça relevance
9 ka kjo, znj. Alagendra?

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do të flas edhe për
11 relevancën, i nderuar Gjykatës, z. Rubin na tha që ka pasur
12 informacion nga terreni, kështu që për këtë arsye po e pyes
13 atë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 vazhdoni më tej. Mos bëni më pyetje lidhur me këtë.

16 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do të vazhdojë me një rast
17 konkret, me masakrën në kafënë Panda në Pejë më 14 dhjetor
18 1998.

19 PY. Nuk e di nëse ju kujtohet, po bëhet fjalë në kafenenë
20 Panda, ku dy persona me automatikë vranë gjashtë nxënës të
21 pafajshëm serbë. A ju kujtohet ky rast, apo jo?

22 PË. Nuk më kujtohet konkretisht ky incident, por mua
23 përshtypja që kam unë është që ka incidente të tilla të
24 ngjashme që kanë ndodhur dhe incidente të kësaj natyre kanë
25 qenë, kanë ekzistuar.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 113

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ai nuk ka
2 informacion lidhur me këtë, mesa di unë.

3 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Do i kërkoj Sekretares të
4 paraqesë në ekran dokumentin P1070. Do kërkoja gjithashtu që
5 paralelisht të tregojë dhe dokumentin 075379 në ekran.

6 PY. Ju lutem, Dëshmitar, lexoni paragrafin e parë të këtij
7 dokumenti. Jo, paragrafi i dytë që i takon që është paragrafi
8 i pestë në këtë faqe.

9 PË. E lexova.

10 PY. A jeni në dijeni të asaj çfarë raportohet në paragrafin 5
11 që UÇK-ja kishte mohuar përfshirjen në vrasje dhe që nuk
12 kishin gisht fare në atë vrasje?

13 PË. Nuk më kujtohet incidenti.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e pyesni
15 dëshmitarin për diçka që nuk e di dhe e tha në fakt më përpara
16 që nuk është në dijeni.

17 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mbase është momenti i
18 përshtatshëm për të bërë pushimin tani.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
20 pushim e drekës tani.

21 Dëshmitar, mund të largoheni nga salla. Ju lutem mos
22 flisni me askënd për dëshminë. Do kthehemi përsëri këtu në
23 orën 2.30.

24 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Edhe sa

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 114

1 pyetje keni, sa kohë ju duhet?

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Ndoshta dhe 20 minuta
3 tjera.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
5 Tani do bëjmë pushimin e drekës deri në orën 2.30.

6 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

7 --- Seanca rifillon në orën 14.30

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
9 Sekretare, sillni dëshmitarin në sallë.

10 Znj. Alagendra, përpara se të filloni, dy përfaqësuesit e
11 qeverisë amerikane dëshirojnë të japin një deklaratë të
12 shkurtër përpara se të filloni. Përpara që dëshmitari të
13 sillet në sallë.

14 [Dëshmitari vijon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
16 Kushdo të jetë gati për të dhënë deklaratën. Z. Rubin,
17 përfaqësuesja juaj dëshiron të japë një deklaratë të shkurtër.

18 ZNJ. GEARHART-SERNA: [Përkthim] Faleminderit shumë. Kam
19 një ndërhyrje të shkurtër në emër të Shteteve të Bashkuara.

20 Siç mund -- si keni parë me siguri dëshminë sot në
21 mëngjes, ne synojmë që të mos ndërhyjmë këtu, prania jonë të
22 mos ndërpresë seancën përveç në rastet kur është e nevojshme.
23 Për të bërë këtë gjë ne ndihmohemi edhe nga dokumentet që z.
24 Rubin ka përdorur dhe të cilave u është referuar, goftë
25 dokumentet që janë të publike siç janë raportimi i lajmeve,

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 115

1 apo dokumentet e brendshme të Shteteve të Bashkuara që janë
2 klasifikuar si -- janë deklasifikuar, pra.

3 Duke thënë këtë ne donim që të jepnim një vëmendje, një
4 vërejtje të shkurtër sa i takon z. Rubin, dhe pyetjes që i
5 është bërë atij për dhënien e informacioneve në hollësi më të
6 mëdha lidhur me burimet konkrete dhe përfundimet nga të
7 tjerët, brenda qeverisë amerikane, në veçanti shërbimet e
8 inteligjencës, pra të zbulimit, ne në këto raste mund të kemi
9 nevojë të ndërhyjmë.

10 Deshëm që ta bëjmë këtë të qartë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
12 Në rregull, znj. Alagendra, mund të vazhdoni pyetjet tuaja.

13 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Faleminderit.

14 PY. Përpara pushimit, po bisedonim për një intervistë me
15 Zërin e Amerikës, z. Rubin.

16 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në qoftë se mund shfaqim në
17 ekran tani dokumentin DJK2096, ju lutem. Faleminderit.

18 PY. Z. Rubin, a mund ta konfirmoni që kjo ishte intervista
19 për të cilën biseduam më herët?

20 PË. Po.

21 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj që të paraqes këtë
22 dokument për t'u pranuar si provë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
24 kundërshtim?

25 Z. PACE: [Përkthim] Cila intervistë është kjo dhe pse nuk

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 116

1 u paraqit si provë, nuk u dorëzua si provë kur u diskutua?

2 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është
4 deklaratë e Zërit të Amerikës.

5 Z. PACE: [Përkthim] Nuk kam kundërshtim.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti
7 DJK2096 pranohet.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Desha vetëm të
9 konfirmoj sepse intervista është tre faqe dhe shkon deri në
10 DJK2099.

11 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Korrekt, kështu është.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë kjo merr numrin
13 e provës materiale 4D195 [Sipas përkthimit].

14 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim]

15 PY. Në faqen 97 të transkriptit kur flitet për fushatën e
16 disinformimit ruse të bërë dhe nga organizata të sponsorizuara
17 të mbështetura serbe, nga serbët, a mund të sqaroni pak më
18 tej? Ne kishim shembuj konkret që ju deshët -- a kishit ndonjë
19 shembull konkret që deshët të elaboroni, mbi të cilin të
20 flisni më në hollësi?

21 Z. PACE: [Përkthim] Kundërshtim. Avokates iu tha më herët
22 që kjo çështje është -- nuk është relevante, vetëm në qoftë se
23 i referohet -- bëhet relevante vetëm në qoftë se i referohet
24 konfliktit. Pyetja dhe këtu është bërë në mënyrë shumë të
25 gjerë që dëshmitari të bëjë, të japë hollësi lidhur me këtë.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 117

1 Kërkoj që pyetja të jetë më konkrete.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta bëjmë
3 këtë më konkrete.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Po pyes për shembuj
5 konkretë ku dëshmitari dëshironte të sqaronte më tej.

6 PY. Ndoshta z. Rubin mund ta sqarojë, mund të japë shembuj
7 konkretë.

8 PË. Është shumë e thjeshtë. I referohem në këtë rast
9 Sputnik-ut dhe kanalit televiziv RT që kishin dhe në gjuhën
10 serbe, pra operonin dhe në gjuhën serbe. Pjesa e vetme e
11 vendeve që donin të bashkoheshin BE-së lejonin RT-në dhe
12 Sputnik-un që të kishin, që shpërndanin, pra, informacione të
13 tilla. Dhe për rrjedhojë Rosisë i jepej mundësia që të
14 paraqiste informacione të rrejshme përmes televizionit me
15 pronësi serbe, kanaleve televizive që janë serbisht dhe mund
16 dëgjohen në të gjithë Ballkanin.

17 Nuk po i referohesha shembujve konkretë, më shumë se sa
18 mënyrave konkrete mbi të cilat bëhej kjo, për të dëmtuar
19 perëndimin, pra në përgjithësi, por jo detyrimisht lidhur me
20 rastin konkret këtu në Gjykatë.

21 PY. Faleminderit për sqarimin që dhatë.

22 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Mund të shfaqim në ekran
23 dokumentin DJK2084 deri në 2095. Dhe më konkretisht në faqen
24 2086.

25 Pak më poshtë në faqe. Po.

1 PY. Kjo është një prej njoftimeve për shtyp që keni dhënë ju
2 në 28 maj 1999. Dhe këtu juve thoni:

3 "Ky është informacion i ri që nuk lidhet me aktakuzat. Ky
4 incident në veçanti në këtë qytet nuk renditet në aktakuzë,
5 por gjykata e ka bërë të qartë që do të vazhdojnë punën e
6 tyre. Ajo që përpiqemi të tregojmë këtu është që ne do të
7 vazhdojmë punën tonë për t'i ndihmuar ata. Ajo, kjo ka të bëjë
8 me provat se serbët kanë pranuar se krime lufte janë kryer dhe
9 se ka, dhe se forcat serbe kanë bërë, kanë mbuluar këto krime
10 në përpjekje për të fshehur provat, për t'i përzier ato me
11 varret e tjera në varrezat e rregullta që të mos ketë
12 llogaridhënie pas arritjes së forcave të NATO-s në Kosovë. Që
13 të kufizojnë provat që të jenë të disponueshme për Gjykatën
14 për Tribunalin për Krime Lufte".

15 Ju kujtohet kjo?

16 PË. Pak a shumë më kujtohet, më kujtohet ky njoftim për
17 shtyp. Më kujtohet pika që ajo që jam përpjekur të theksoj në
18 këtë rast, dhe për rrjedhojë më kujtohet kjo pikë, pra. E kam
19 fjalën, ka ndodhur para 26 vitesh, por më kujtohet njoftimi
20 për shtyp.

21 PY. Dhe pajtoheni me faktin se këtu po thoni në mënyrë të
22 drejtpërdrejtë se serbët ishin të përfshirë në operacionin për
23 të mbuluar, për të fshehur provat?

24 PË. Po, absolutisht që po.

25 PY. Dhe ju pajtoheni me faktin që ata nuk po vepronin sipas

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 119

1 asaj që kuptohet si luftë konvencionale, ata po vepronin si
2 kriminelë në përpjekje për të mbuluar krimet e tyre, për t'i
3 fshehur, apo jo?

4 PË. E saktë, kjo është karakteristikë që kemi parë në Bosnje
5 dhe kemi parë përsëri në Kosovë.

6 PY. Dhe në të njëjtën mënyrë ata po përpiqeshin që të
7 fajësonin në mënyrë të rrejshme dhe të pavërtetë UÇK-në, apo
8 jo?

9 PË. Ata gjithmonë janë përpjekur të fajësojnë UÇK-në, pra
10 qeveria serbe.

11 PY. Dhe kjo është në përputhje me mënyrën e veprimit të
12 regjimit serb, mënyrën se si ka vepruar në atë kohë, pajtoheni
13 me këtë?

14 PË. Kjo është mënyrë se si ata janë përpjekur të justifikojnë
15 atë që po bënin, duke hedhur fajin tek të tjerët.

16 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Tani do kërkoj dokumentin,
17 që të shfaqet në ekran dokumenti 1D00148, ju lutem. Faqja
18 është me numër DHT01536.

19 PY. "Faqja 03", lexojeni pak këtë paragraf, ju lutem.

20 PË. Në rregull.

21 PY. Ju takuat z. Krasniqi drejtpërdrejt pak më vonë më 12
22 prill 1999, në Bruksel, apo jo?

23 PË. Po. Unë e vërejta këtu që nuk ma kanë përmendur emrin si
24 pjesëmarrës në takim, nuk do të thotë që nuk kam marrë pjesë
25 në këtë takim. Mund të kem qenë aty dhe duke bërë edhe gjëra

1 të tjera. Më kujtohet takimi me z. Krasniqi në Bruksel në atë
2 moment sepse ishte një moment shumë i dhimbshëm gjatë luftës.
3 Nuk e dinim se çfarë drejtimi do të merrte lufta. Dhe
4 z. Krasniqi na kërkonte neve gjëra për të cilat ne nuk ishim
5 përgatitur, siç ishte për shembull dërgimi i trupave tokësore.
6 Ne e sqaruam atë që ishim gati të bënim, që do të bënim, por
7 edhe gjëra që nuk mund t'i bënim. Pra, ishte një moment shumë
8 i ndjeshëm.

9 PY. Dhe gjatë kësaj këtij takimi z. Krasniqi i bëri këto
10 kërkesa konkrete, këto tre kërkesa konkrete në emër të
11 shqiptarëve të Kosovës dhe UÇK-së?

12 PË. Kështu e kuptuam ne se ai po na transmetonte formalisht
13 kërkesat e udhëheqësve të UÇK-së dhe të Kosovës neve Shteteve
14 të Bashkuara.

15 PY. Dhe shqetësimi i tij kryesor ishte vuajtja humanitare e
16 qindra mijëra njerëzve të zhvendosur në Kosovë?

17 PË. Absolutisht që po, kështu është. Dhe këtu them që duhet
18 të theksoj se ne kishim të njëjtin shqetësim. Ne menduam se
19 mënyra më e mirë për të shpëtuar këta njerëz ishte që të
20 mposhtnim Millosheviqin dhe kjo ndodhi pas disa javësh më
21 vonë. Por gjatë atyre javëve ai ishte i shqetësuar për
22 popullin e tij. Ne e kuptuam dhe i treguam atë që mund të
23 bënim dhe nuk mund, dhe atë që nuk mund të bënim. Ne donim që
24 të mbanim sa më shumë njerëz që të rrinin aty në rajon, por
25 kuptuam se njerëzit po iknin në masë në gjithë botën dhe donim

1 që t'i ndihmonim ata, por nuk ishim të përgatitur të dërgonim
2 trupa në terren.

3 PY. Ai po kërkonte mbështetje humanitare për këta civilë, do
4 të thonit këtë gjë?

5 PË. Po.

6 PY. Që njihen zakonisht si persona të zhvendosur brenda
7 vendit?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe shqetësimi i tij kryesor ishte kërkesa që shtetet,
10 për ndërhyrjen e Shteteve të Bashkuara apo mbështetje të
11 UÇK-së për të ndaluar spastrimin etnik të Millosheviqit, nga
12 Millosheviqi, që ishte, që është shënuar edhe regjistruar në
13 këtë kabllogram?

14 PË. Po. Dhe ky momenti i ndjeshëm ishte pra se si të mposhtej
15 Millosheviqi. Ishin në, kishte njerëz në pjesë të ndryshme të
16 botës, përfshirë natyrisht dhe UÇK-në, që na donin që ne të
17 ndërhynim nga ajri por dhe nga toka, që ishte shumë temë e
18 ndjeshme, sepse se nuk ishim të përgatitur të bënim një gjë të
19 tillë. Presidenti Clinton kishte përjashtuar në atë moment
20 kohor ndërhyrjen e trupave tokësore, dhe për arsye që thatë
21 edhe ju shqetësimi i popullit të Kosovës, theksuam se nëse
22 Shtetet e Bashkuara dërgonin trupa tokësore lufta mund të
23 ndalonte më herët, më shpejt, dhe njerëzit mund të dëmtoheshin
24 më pak, pra. Por ne nuk mund, nuk ishim në gjendje t'i
25 përgjigjeshim kësaj kërkesë sepse kjo do të thonte që

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 122

1 Presidenti Clinton do të ndryshonte politikën e tij që kishte
2 thënë për të mos dërguar trupa tokësore.

3 PY. Saktë.

4 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Në qoftë se mund të kalojmë
5 në faqen tjetër, atëherë është DHT05180 deri 05189.

6 DËSHMITARI: [Përkthim] Më duket se paskam qenë në atë
7 takim. Sepse e pashë në listë.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, nuk
9 arrij të gjej dot dokumentin në fjalë.

10 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] S'prish punë, mund të
11 shfaqni përsëri dokumentin e mëparshëm në ekran. Dokumenti
12 1D00148. [Mikrofoni çaktivizuar] Po, faleminderit. Kalojmë tek
13 paragrafi 14.

14 PY. Mund ta lexoni ju lutem z. Dëshmitar?

15 PË. Po.

16 PY. Në këtë kabllogram thuhet që kërkesa e tij ishte, ishin
17 trupat tokësore ose përndryshe të armatosej UÇK-ja që të
18 mbronte vetveten dhe të mbronte popullin e Kosovës. Kjo ishte
19 logjika e z. Krasniqi që të armatosej UÇK-ja si nevojë
20 mbrojtëse për të mbrojtur civilët nga krimet mizore të
21 serbëve. A është kështu?

22 PË. Po.

23 PY. Nuk ka asgjë të pavend në këtë kërkesë, pra apo jo?

24 PË. Mendoj që ne në përgjithësi kemi ndjerë që, kemi vënë
25 veten në vendin e tij dhe do të kishim, po të kishim qenë në

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Alagendra

Faqe 123

1 vendin e tij do të kishim kërkuar të njëjtën gjë.

2 PY. Pra, pajtoheni që ishte një veprim i duhur dhe i
3 vlerësueshëm që ishte shqetësimi i tij i parë pra për vuajtjet
4 që pësonin njerëzit e zhvendosur brenda vendit?

5 PË. Është e saktë që ne kemi kuptuar arsyen dhe logjikën e
6 tij, kjo ishte logjika që ne e kemi bashkëndarë pra, mbrojtjen
7 e popullit, mbrojtjen e civilëve. Dhe nuk ishte thjesht diçka
8 që, por ishte diçka që ne nuk ishim të përgatitur për të bërë
9 në atë kohë.

10 PY. Pyetja e fundit, z. Rubin. Duke qenë që e keni pasur
11 mundësinë që të shkëmbeni dhe të ndërveproni me z. Thaçi dhe
12 delegacionin e Kosovës, a pajtoheni që nuk keni parë asgjë në
13 gjuhën, shprehjet e trupit apo lëvizjet, bisedat,
14 ndërveprimet, shkëmbimet që keni parë ju që mund të sugjeronin
15 që z. Jakup Krasniqi, zëdhënësi, ishte më tepër se sa një zë
16 mbështetës i moderuar i cili përpigjej të ndihmonte z. Thaçi
17 dhe ata të tjerët në Rambuje me ndihmën e Shteteve të
18 Bashkuara për t'i dhënë fund konfliktit?

19 PË. Më duket që është një vlerësim i saktë kjo që bëtë ju.

20 PY. Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
22 znj. Alagendra.

23 Z. Pace.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Përpara që të kalojmë, të vazhdojmë
25 të vijojmë në marrjen në pyetje të dëshmitarit, sa për të qenë

1 në rregull do të kërkoja pranimin e tre dokumenteve të cilat i
2 përdora sot. Njoftimi për shtyp, konferenca për shtyp, një
3 numër i këtyre janë paraqitur në prova. Mund t'ju jap numrat
4 në qoftë se është e nevojshme që t'i identifikohen.

5 Z. PACE: [Përkthim] Ka kundërshtime për këto.

6 Z. DIXON: [Përkthim] Kërkesa ime është që t'i paraqes për
7 pranim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjeni këtë
9 duke dhënë numrin identifikues.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Numrat janë sipas rendit, sipas
11 datës. I pari është njoftimi për shtypin i datës 26 gusht
12 1998, dhe ky është DKV1781 deri në 1782. Pastaj, njoftimi për
13 shtyp i z. Rubin i 23 shtatorit 1998, DKV1783 deri në 1783.
14 Dhe pastaj në fund njoftimi për shtyp i datës 27 tetor 1998 i
15 z. Rubin, me numër DKV1776 to 1780.

16 Disa prej tyre janë pranuar tashmë në prova. Këta janë
17 dokumentet e vetë z. Rubin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po pse po i
19 pranon përsëri?

20 Z. DIXON: [Përkthim] I përmenda në pyetjet që paraqita
21 unë --

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Por ato janë
23 tashmë në prova. Ju sapo e thatë këtë gjë.

24 Z. DIXON: [Përkthim] Unë thashë dokumente si të ngjashëm
25 me këto janë pranuar më herët, pra është argumenti në favorin

1 tonë që nuk ka arsytet të ndahen këto nga dokumente saktësisht
2 të njëjtë më ato që janë pranuar më herët në prova. Vijnë
3 këto, janë dokumente që vijnë nga dëshmitari apo zyra e tij.
4 Janë shënime bashkëkohore të faktit, që kanë të bëjnë me fakte
5 të ndryshme të shënuara, të regjistruara, që ne mendojmë janë
6 relevante për rrethanat në fjalë. Por më e rëndësishme, kjo që
7 është edhe më e rëndësishme, siç e shpjegova më herët, ato
8 trajtojnë procedurën që është përdorur për të mbledhë
9 përmbledhjen e informacionit në terren që ne themi që është
10 relevante për informacionin që z. Rubin dhe të tjerët kishin
11 në kohë lidhur me strukturën e UÇK-së që është qartësisht pikë
12 relevante në këtë gjykim.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshironi të
14 kundërshtoni tani apo të bëni një kundërshtim me shkrim?

15 Z. PACE: [Përkthim] Mund të kundërshtoj tani, dhe baza
16 është shumë e thjeshtë. Nuk ka, nuk janë relevante.

17 Siç e pamë më herët gjatë marrjes në pyetje, përmbajtja e
18 këtyre deklaratave, qoftë edhe për personat e zhvendosur
19 brenda Kosovës dhe statistikave. Z. Avokat, në fakt në
20 parashtrimet e tij kur i kundërshtova, shpjegoi që po përdorte
21 këto dokumente. Dokumentet vetë në vetvete nuk janë relevante
22 për këtë çështje. Fakti që ka njoftime për shtyp të tjera nga
23 z. Rubin që janë pranuar në prova nuk do të thotë që duhet të
24 pranohen të gjitha lidhur me, në këtë mënyrë. Pra,
25 kundërshtojmë kundërshtimin, pranimin e këtyre tre

1 dokumenteve.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Do të marrim një vendim lidhur me këto më vonë, me gojë.

4 Z. Pace, vazhdoni pyetjet tuaja.

5 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Harrova të

6 paraqes dokumentin për pranim si provë. Nëse më lejohet.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdo.

8 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Është dokumenti DJK2804

9 [Sipas përkthimit] 2095.

10 Z. PACE: [Përkthim] Dhe një herë ju lutem, i nderuar

11 Kryegjykatës. Ju rikujtoni palëve që paraqitja e dokumenteve

12 për pranim duhet të bëhet në kohë sepse është e vështirë që

13 të, që ngatërrohen gjërat pastaj. Lidhur me këtë dokument të

14 veçantë nuk kemi ndonjë kundërshtim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DJK2084,

16 2095, pranohet.

17 Përsëris atë që thashë më herët. Bëjeni në mënyrë të

18 rregullt.

19 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] E di, kërkoj ndjesë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të doja që

21 këtë ta bënit në momentin që përdorni dokumentin, pra

22 paraqitjen e tij si provë.

23 ZNJ. V. ALAGENDRA: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

25 dokumenti DJK2084, 2095, pranohet me numrin e provës materiale

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 127

1 4D106.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace e
3 keni fjalën ju për pyetjet.

4 Pyetje të palës tjetër nga z. Pace:

5 Z. PACE: [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjesi, Dëshmitar. Unë quhem James Pace. Jam
7 Prokuror me ZPS-në. Do t'ju bëj disa pyetje për katër orë ose
8 më shumë.

9 Si pjesë e rolit tuaj në vitin 1998, Sekretari i
10 Shteteve, Sekretari i Shtetit i Shteteve të Bashkuara mbulonte
11 gjithë botën, për sa i përket politikës së jashtme të Shteteve
12 të Bashkuara, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dëgjova përgjigjen "po", por edhe një herë.

15 PË. Po, po.

16 PY. Duhet ta respektojmë pauzën, përndryshe transkripti nuk
17 mund të pasqyrojë atë që themi.

18 Pra, unë kuptoj që në atë kohë pritej nga ju që, e njëjta
19 gjë pritej nga ju duke pasur parasysh rolin tuaj në qeverinë
20 amerikane në atë kohë?

21 PË. Po.

22 PY. Në paragrafin 11 të deklaratës që i keni dhënë Mbrojtjes,
23 të cilën e konfirmuat sot, ju thoni, dhe po citoj:

24 "Për të bërë punën time çdo mëngjes do të lexoja të
25 gjitha raportet e mediave relevante si edhe raportet e

1 shërbimeve të zbulimit, kabllogramet diplomatike të ambasadave
2 dhe misioneve".

3 A ju kujtohet në ndonjë, çdo ditë të caktuar në 1998, sa
4 raporte të mediave, të shërbimeve të zbulimit apo kabllograme
5 diplomatike lexonit?

6 PË. Nuk mund t'ju jap një numër konkret, por mund të jetë
7 100.

8 PY. A ju kujtohet sa këto informacione, për sa vende
9 trajtonin, pra bëheshin fjalë? Informacione për sa vende në
10 një ditë normale në 1998?

11 PË. Po ta shikoni këtë, siç e pashë, siç e keni parë me disa
12 nga njoftimet për shtyp, varej nga koha, pra gjatë luftës në
13 Kosovë, 95% e pyetjeve mund të kenë qenë rreth Kosovës, dhe
14 vetëm disa pyetje për diçka tjetër. Kur nuk kishte luftë, mund
15 të ishte, mund të kishte rreth dhjetë tema që trajtoheshin,
16 tema të përgjithshme, pra. Kishit edhe fusha të tjera që duhej
17 të trajtoheshin. Por gjatë atyre 78 ditëve në veçanti, dhe tre
18 muaj përpara tyre, apo disa muaj përpara tyre, Kosova ishte
19 tema kryesore që Sekretarja Albright dhe ekipi i saj -- në të
20 cilën Sekretarja Albright dhe ekipi i saj ishin të
21 përqendruar.

22 Dhe duhet të shtoj që kjo ishte relevante për pyetjen
23 tuaj, është relevante për pyetjen tuaj. Unë kisha një
24 marrëdhënie unike, pra të veçantë, me atë lidhur me Ballkanin,
25 sa i takon Ballkanit. Dhe nëse tema ishte, e bisedës ishte

1 Kina, unë lexoja më pak për Kinën sepse dija që pikëpamjet e
2 mia mbi Kinën, kuptimi im, ajo që di unë për Kinën, ishte më
3 mekanik. Ndërsa se sa dy fushat ku isha thellësisht i
4 përfshirë, pra, jam përpjekur që të lexoj më shumë të di më
5 shumë dhe të informoj atë më shumë që ta bëja rolin tim më
6 gjithëpërfshirës. Që pra të mos të kishte shumë tema, pra, për
7 t'u trajtuar dhe po përpiqem të përgjigjem sa më saktë pyetjes
8 tuaj duke thënë këtë.

9 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj tani të shfaqet në ekran
10 dokumenti SPOE00397666-00397674, dhe në faqen e parë.
11 PY. Dëshmitar, këtu shohim që kjo është njoftimi ditor për
12 shtyp i Departamentit të Shtetit, 25 qershor 1998. Pra në
13 faqen tonë shohim referencat e Serbisë dhe Salvadorit. Tani, a
14 është e saktë që në atë kohë çështje që kishin të bënin me
15 Kosovën përfshihen në titullin, nën poshtë titullit, tema
16 "Serbia"?

17 PË. Po.

18 Z. PACE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër, në fund të
19 faqes 667. Largojmë pak.

20 PY. Dhe këtu shohim që faqja mbulon Guatemalën, Arabinë
21 Saudite, Sllovakinë, Egjiptin, Lindjen e Mesme, procesin e
22 paqes për Lindjen e Mesme, të cilin e kuptoj që është më MEPP,
23 pastaj i referohet Kinës, Kuvajtit, Kongos, Kubës, Sirisë,
24 Irakut.

25 A e kuptoj që në këtë, nga kjo që shohim, në këtë faqe që

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 130

1 ju në këtë ditë i keni dhënë përditësime shtypit, në këtë ditë
2 të qershorit 1998, për çështje që kishin të bënin me të gjitha
3 këto shtete?

4 PË. Po.

5 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim dokumentin.

6 DËSHMITARI: Duhet të shtoj, sepse mendoj që i përgjigjet
7 pyetjes tuaj, se si një person përpara shtypit, me ekspertizë
8 të veçantë dhe marrëdhënie të veçantë në këtë fushë, në shumë
9 raste vetëm lexoj atë që është përpara meje. Për Salvadorin,
10 Guatemalën, Egjiptin. Unë, mua më bëhet një pyetje, unë lexoj
11 atë që kam përpara. E vetmja gjë që duhet të bëj është që të
12 lexoj atë që më është dhënë.

13 Ndërsa, kur bëhej fjalë për Ballkanin dhe dy-tre temat e
14 tjera, jo vetëm që ka më shumë faqe aty, përmbajtje, por isha
15 më shumë në gjendje që t'u përgjigjesha pyetjeve sepse dija
16 shumë më shumë, dhe isha shumë më shumë i përfshirë me atë.
17 Dhe ajo ishte shumë më shumë e përfshirë në këtë çështje, me
18 këtë problem. Pra si zëdhënës i qeverisë, duhej të merrem me
19 gjithë ato çështje që ju i përmendët, dhe faqet janë të sakta,
20 përmbajtja që është aty, por duhet të theksoj se si komunikues
21 pra, zëdhënës për shtypin, unë i kam lexuar pra përgjigjet dhe
22 përmbajtjen e atyre. Ndërsa për sa i përket Ballkanit në
23 veçanti për vitin 1998-1999, kur kam kaluar një kohë të madhe,
24 ndoshta në Irak kam kaluar pak kohë varësisht nga kriza që
25 kishim në Lindjen e Mesme, varësisht nga negociatat që

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 131

1 bëheshin, por ato ishin tema që ku kam kaluar kohë të madhe
2 dhe duke u përgatitur dhe duke dhënë informacion gazetarëve
3 kur më bënë pyetje.

4 PY. Përpara që të trajtonit kombet e tjera, vendet e tjera,
5 apo problemet me vendet e tjera, shtetet e tjera, me të cilat,
6 për të cilat ju kishit më pak informacion, a konfirmoni
7 saktësinë e informacioneve që ju jepej përpara se ta lexonit?

8 PË. Po dhe jo. Jo çdo herë. Në fakt zhvillohet një
9 marrëdhënie me njerëzit në jetë dhe ju u besoni, njeriu u
10 beson atyre. Pra ka njerëz që vinin në zyrën time gjatë
11 mëngjesit nga zyra për Amerikën Latine për të thënë për
12 shembull, në veçanti, lajmet për dy vite që kam qenë aty, me
13 nja dy përjashtime siç është Kuba, dhe ju testoni njerëzit 10,
14 20 dhe 30 herët e para, dhe pastaj ju jeni i bindur që
15 informacioni që jep ky person është i verifikuar dhe i saktë.
16 Pastaj 34, 38, 35 herë ju keni më nevojë të bëni verifikime të
17 tilla, pra besoni te njerëzit që ju japin informacion të
18 saktë.

19 PY. Deklarata juaj nuk përmend takimin me pjesëtarë të UÇK-së
20 në dhjetor 1998, apo janar 1999, e saktë?

21 PË. E saktë.

22 PY. Përpara Rambujesë, ju nuk keni marrë pjesë në takimin ku
23 kishte, pjesëtarët e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, saktë?

24 PË. Saktë.

25 PY. Nuk keni, dhe ju nuk jeni takuar me ndonjë nga

- 1 komandantët e zonave operative përpara Rambujesë, saktë?
- 2 PË. Saktë.
- 3 PY. Në paragrafin 13 të deklaratës tuaj, ju thoni që kishit
- 4 shumë pak dijeni se kush ishte udhëheqja e UÇK-së dhe dinit
- 5 pak për ta. Ndërsa sot dëshmuat se në Rambuje lidhur me UÇK-në
- 6 thatë përsëri që "ne nuk e kuptonim kush ishte udhëheqja,
- 7 struktura udhëheqëse e tyre shumë mirë. Nuk e kuptonim mirë".
- 8 Dhe nga gjysma e dytë e 1998 administrata e SHBA-së kishte
- 9 informacion të kufizuar lidhur me udhëheqjen e UÇK-së dhe
- 10 strukturën e brendshme të saj, a është kështu?
- 11 PË. Dua të dallojmë këtu mes zëdhënësit të Shteteve të
- 12 Bashkuara të Amerikës që i cili ka sasi informacioni të
- 13 kufizuar dhe themi [REDAKTUAR]
- 14 [REDAKTUAR]
- 15 [REDAKTUAR].
- 16 Pra kur themi qeveria e Shteteve të Bashkuara duhet të
- 17 korrigjojmë faktin, sepse unë nuk jam qeveria e Shteteve të
- 18 Bashkuara. Unë përpiqem të jem ai në një ditë të caktuar, por
- 19 ka njerëz në qeverinë e Shteteve të Bashkuara që dinë më shumë
- 20 se sa unë, ose edhe ambasadori në Beograd mund të dijë më
- 21 shumë se unë. Jo detyrimisht personat që punojnë në shërbimet
- 22 e zbulimit. Kjo ishte gjithë ditën, pra. Ata mund të dinin
- 23 gjithçka që edhe mund të ishin gjëra që më shumë, mund të jetë
- 24 më shumë se ç'dija unë ose Madeleine Albright.
- 25 PY. A ishit në dijeni se autoritetet e SHBA-së për, ishin, se

1 autoritetet e SHBA-së ishin në kontakt me UÇK-në në 1998, që
2 ishin në kontakt, kanë konstatuar, theksuar se ishte sekrete
3 lidhur struktura e tyre, pra dhe udhëheqja e tyre?

4 PË. Po.

5 PY. Në deklaratën tuaj ju keni thënë se kur keni arritur në
6 Rambuje Hashim Thaçi ishte djalosht i ri nga UÇK-ja të cilin
7 nuk e njihje askush. Ngjashëm në artikullin e Financial Times
8 ju keni thënë lidhur me z. Thaçi se "kur ai erdhi në Rambuje
9 nuk e dinim se kush ishte fare", dhe sot më herët thatë se
10 "askush nuk e njihje në qeverinë e Shteteve të Bashkuara, nuk
11 e dinte se kush ishte ai".

12 Pra, përpara Rambujesë ju vetë nuk e dinit nëse z. Thaçi
13 ishte ndonjëri prej themeltarëve të UÇK-së, saktë?

14 PË. Unë vetë jo. Unë nuk e dija. Po pranoj këtë gjë.

15 PY. Por ju nuk e dinit përpara Rambujesë nëse z. Thaçi ishte
16 anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, apo jo?

17 PË. Po.

18 PY. Përpara Rambujesë, ju nuk e dinit nëse z. Thaçi ishte
19 anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së, apo jo?

20 PË. Po, sepse nuk e njihja.

21 PY. Çka do të thotë se ju nuk e dinit a ishte drejtori i
22 Drejtorisë Politike të UÇK-së?

23 PË. Po.

24 PY. Ju nuk e dinit se në gusht të 1998-s Shtabi i
25 Përgjithshëm i UÇK-së kishte bërë publik emrat e përfaqësuesve

1 të vet, përfshirë këtu Hashim Thaçin, apo jo?

2 PË. Jo, nuk kam qenë në dijeni të kësaj, jo.

3 PY. A e dini nëse ka pasur dijeni BBC-ja në gusht të 1998-s?

4 PË. Nuk e kam idenë.

5 Z. PACE: [Përkthim] Shohim në ekran, ju lutem, materialin
6 me numër 019584-019585. Ju lutem, të shohim vetëm faqen e
7 parë.

8 PY. Shohim këtu që është një raport i BBC-së, një artikull i
9 BBC-së, 15 gusht 1998, është data mbi dokument me titull
10 "Ushtria Çlirimtare e Kosovës bën publik emrat e përfaqësuesve
11 politikë". Dhe është një "Tekst i marrë nga ky tekst është
12 prodhuar, thotë, nga qendra e informimit të Kosovës, faqja e
13 uebsajtit".

14 Dhe në fillim thotë, "Prishtinë, 13 gusht", lexojeni,
15 ndiqeni dhe do ju bëj një pyetje:

16 "Prishtinë, 13 gusht. Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë
17 Çlirimtare të Kosovës (UÇK, Kosovë [Kosovë]) [OVK në
18 serbo-kroatisht]) sot lëshoi, e enjte pasdite [13 gusht], një
19 deklaratë me titullin Deklarata politike numër 7, ku i
20 referohej problematikave më të fundit në Kosovë që ishin një
21 tërheqje taktike, e bëri publik emrat e gjashtë personave.
22 Përfaqësuesit politikë të UÇK-së ku përmendte Adem Demaçin si
23 personin kryesor që udhëhiqte punën për krijimin e
24 institucioneve në Kosovë".

25 "Tërheqja taktike synonte mbrojtjen e popullatës civile

1 dhe kjo rezultoi të ishte e suksesshme", thotë deklarata dhe
2 thotë që "duke fituar pozicione të caktuar lufte, është një
3 vërtetim i kësaj".

4 "UÇK-ja ka dalë nga kjo situata më e fortë se kurrë",
5 thuhet në këtë deklarata. "Kjo prova më e mirë e vendosmërisë
6 tonë për të vijuar më tej me betejën deri sa të arrijmë
7 pavarësinë".

8 "Sa i takon kushteve të reja politike dhe ushtarake në
9 Kosovë, UÇK-ja thotë", citoj, "institucionet që do të
10 përfaqësojnë një spektër të gjerë të skenës politike", duhen
11 krijuar.

12 "Për kontekst, për t'i dhënë fund manipulimeve për sa i
13 takon krijimit të këtyre institucioneve", Shtabi i
14 Përgjithshëm bëri publik emrat e përfaqësuesve politikë. Mes
15 tyre janë Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti,
16 [Hashim] Thaçi, Faton Mehmetaj dhe Sokol Bashota, thotë
17 deklarata."

18 Po përfundoj këtu. Ky nuk ka qenë një nga raportet që
19 keni parë ju asokohe lidhur me Kosovën, apo jo?
20 PË. Nëse do të ketë qenë, se dhe mund ta kem parë, s'më
21 kujtohet se kanë kaluar 27 vjet që atëherë.

22 Z. PACE: [Përkthim] Kërkojmë pranimin e këtij dokumenti.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Mendoj se ka një version tjetër në
25 fakt, megjithatë ne nuk kemi kundërshtime në thelb.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
2 kundërshtime. Atëherë dokumenti përkatës me numrin 019584-
3 019585 pranohet dhe do të marrë numrin përkatës.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
5 numrin e provës P04485.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Meqë po pranohet ky dokument, dua
7 të bëj një sqarim. Ai, z. Pace, lexoi Hashim Thaçi, por në
8 raport këtu thuhet "Haxhi Thaçi".

9 Z. PACE: [Përkthim] Okej, ju kërkoj ndjesë për këtë. Mund
10 ta heqim dokumentin nga ekrani.

11 PY. Në deklaratë thoni që ambasadori Gelbard, Holbrooke, dhe
12 anëtarë të shërbimit të zbulimit amerikan ishin takuar ose
13 ishin në kontakt me anëtarë të caktuar të UÇK-së.

14 Sa i takon 1 tetorit 1998, dokumentit që pamë pak më
15 herët nga Mbrojtja e z. Veseli, ju theksuat se keni marrë
16 informacion dhe nga Shaun Byrnes dhe thatë që ai respektohej
17 shumë sepse jepte informacione të sakta.

18 A keni pasur ju dijeni të keni pasur takime mes Shaun
19 Byrnes dhe përfaqësuesve të UÇK-së në 1998?

20 PË. Edhe mund ta kem ditur, por pas 27 vitesh nuk më kujtohet
21 më.

22 PY. A ju kujtohet nëse në nëntor të 1998-s Shaun Byrnes
23 kishte identifikuar Hashim Thaçin si kreun e departamentit apo
24 Drejtorisë Politike të UÇK-së?

25 PË. Siç jua thashë dhe në fillim të pyetjeve tua, po jua

1 them edhe një herë, me sa më kujtohet nuk e kam njohur emrin e
2 Hashim Thaçit përpara Rambujesë në 1999-n. Pra, përgjigjja
3 mund të jetë po ose jo. Çfarë të dëshironi. Nuk e di se si
4 duhet të përgjigjem.

5 PY. Pra, ju kujtohet të kenë marrë informacione të sakta nga
6 Shaun Byrnes, por jo domosdoshmërisht për strukturën e UÇK-së?
7 PË. Më kujtohet që nuk kam marrë çdo gjë që thoshte Shaun
8 Byrnes. Më kujtohet që ishte një prej personave që e kanë
9 identifikuar si person që jepte informacion të besueshëm, por
10 nuk doja çdo gjë që raportonte ai. Nuk do ishte në gjendje t'i
11 dija unë të gjitha këto nivele hollësirash.

12 PY. Dhe në qoftë se do të ishte në ndonjë kabllogram kjo
13 drejtuar Sekretarit të Shtetit?

14 PË. Çdo kabllogram Sekretarit të Shtetit i shkon, dhe vinin
15 me mijëra, e mijëra, kabllograme çdo ditë për Sekretaren e
16 Shtetit. Unë duhej t'i përzgjidhja. Unë përzgjidhja çfarë
17 duhej të lexoja bazuar në interesin tim në temën përkatëse,
18 ose se ku duhet t'ia përcillja përgjegjësitë lidhur me
19 çështjet në fjalë.

20 Holbrooke, Richard Holbrooke, ishte një person që e
21 njihnim shumë mirë. Madeleine Albright e njohte shumë mirë,
22 dhe Gelbard bashkë me ta po e trajtonin këtë çështje. Unë i
23 respektoja shumë që të tre, çka do të thotë se unë kisha besim
24 se kjo temë ishte në duar të sigurta. Çka do të thotë se
25 hulumtoja më pak dhe nuk kisha nevojë të merrja vesh çdo

1 hollësi lidhur me këtë aspekt, siç do kisha bërë në një temë
2 për një temë tjetër që besoj se nuk do të ishte në duar të
3 sigurta, çka do të thotë nuk kam lexuar çdo gjë që ka shkruar
4 Shaun Byrnes asokohe, me pak fjalë.

5 PY. Keni pas dijeni mes, për takim mes Lawrence Rossin edhe
6 përfaqësuesve të UÇK-së në 1998?

7 PË. Nëse ka qenë me Gelbard, po, nëse s'ka qenë me Gelbard,
8 jo. Unë e di që Gelbard është takuar me të, me UÇK-në, në
9 1998, dhe më pas Larry, ishte personi që i ka takuar të gjithë
10 me sa di unë asokohe. Pra, e di që Larry takohej me të gjithë,
11 kaq mund të them, Larry Rossin. Por takimet me UÇK-në që më
12 kujtohen mua pas 27 vitesh, më kujtohen takimet që kanë qenë
13 me Gelbard.

14 PY. A keni dijeni për kabllograma të 1998-s ku përmendej
15 Hashim Thaçi si drejtues i Drejtorisë Politike të UÇK-së, ju
16 kujtohet një kabllogram i tillë?

17 PË. Mund t'i kem lexuar kabllogramet e tilla, por nuk më
18 kujtohet veçanërisht emri i Hashim Thaçit kur kam shkuar në
19 Rambuje, një a dy muaj më pas. Kam lexuar kabllogramet e Larry
20 për Kosovën, se më duket sikur jua thashë dhe më herët. Ka
21 qenë kriza kryesore asokohe, po përpiqeshim që të ishim sa më
22 të angazhuar. Unë i besoja Gelbard, Holbrooke, por nuk ishin
23 gjithmonë të përfshirë, ndonjëherë ishte, ndonjëherë s'ishte,
24 ndonjëherë largohej me muaj. Dhe kur nuk ishte ai i përfshirë
25 unë përpiqesha të lexoja më shumë dhe është e sigurt që kam

1 lexuar kabllograme nga Beogradi apo nga Larry, lidhur me çdo
2 temë që më kujtohet mua për atë kohë. Por s'mund t'i mbaja
3 mend të gjitha. Sepse, sidoqoftë kjo ka qenë një temë me shumë
4 interes për Madeleine Albright, edhe për mua veçanërisht.
5 PY. A dini, keni dijeni për takimet mes Christopher Hill dhe
6 anëtarëve të UÇK-së përfshirë dhe Hashim Thaçin dhe Jakup
7 Krasniqin në nëntor të 1998?
8 PË. Christopher Hill në atë kohë ishte, sapo kishte filluar
9 punën, ndërsa Gelbard dhe Holbrooke ishin përfaqësuesit
10 kryesorë. Chris dhe Larry Rossin ishin pak më të ulët në
11 gradë, në nivel. Kështu që unë nuk shikoja çdo takim ku
12 merrnin ata pjesë. Nëse raportoj në një kabllogram sigurisht
13 që unë isha, kisha interes. Disa kabllograme thjesht kanë
14 shumë emra, jo të gjitha i lexojmë. Disa kabllograme thonë që
15 UÇK-ja do të bëjë një, do ndërmarrë një veprimtari politike
16 apo serbët do të bëjnë diçka të caktuar, ato i lexon. Ama
17 kabllogramet thjesht me emra brenda, apo që kanë hollësi që
18 mua nuk më nevojiteshin, këto ishin kabllograme që unë nuk i
19 lexoja. I kaloja shpejt e shpejt dhe i lija.
20 PY. Po për mediat ndërkombëtare që raportojnë takime mes
21 diplomatëve të SHBA-së apo autoriteteve të SHBA-së dhe
22 anëtarëve të UÇK-së në nëntor të 1998, këto i lexoje?
23 PË. Po, dokumentet e tilla do t'i lexoja si rregull.
24 Z. PACE: [Përkthim] Të shohim atëherë, një dokument,
25 4D00040, dhe të shohim vetëm faqen e parë të këtij dokumenti.

1 PY. Shohim një artikull të 9 nëntorit 1998. Është raporti i
2 BBC-së me titull, "Ndërmjetësuesi i SHBA-së inicion takime me
3 rebelët Kosovarë", thotë që teksti është marrë nga agjencia
4 ARTA me bazë në Prishtinë e datës 6 nëntor 1998. Po lexoj që
5 nga fillimi.

6 "Dragobil, 6 nëntor: Me kërkesën e tij, sikurse u
7 konfirmua nga pjesëmarrësit në takim, ndërmjetësuesi i SHBA-së
8 për Kosovën, Christopher Hill, u takua të premtën më 6 nëntor
9 me përfaqësues të UÇK-së, [Ushtria Çlirimtare e Kosovës, UÇK
10 në shqip, OVK në serbo-kroatisht] në shtabin kryesor, Hashim
11 Thaçi dhe Ramë Buja, përfaqësues të Drejtorisë të UÇK-së për
12 çështje politike dhe me zëdhënësin Jakup Krasniqi."

13 E keni lexuar këtë raport?

14 PË. Jo. Më falni që po jua them këtë, BBC-ja nga unë asokohe
15 nuk konsiderohej si media ndërkombëtare. Sikurse do ta lexoja
16 *New York Times*, apo *CNN*-in asokohe. Që ishin në fakt organe
17 mediatike amerikane. Por do të isha në dijeni dhe do ta kisha
18 ditur nëse Richard Holbrooke dhe ambasadori Gelbard, do t'jua
19 caktonin vartësve detyrën --

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni një
21 çast, Dëshmitar. Z. Misetic u çua në këmbë.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Besoj se ka një problem se pse
23 është e padrejtë, është e padrejtë për dëshmitarin. Ai tha që
24 ky është një raport i BBC-së.

25 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta diskutojmë këtë pa praninë e

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 141

1 dëshmitarit. Ne i treguam një dokument dëshmitarit në ekran,
2 nëse ka diçka që duhet ta diskutojmë lidhur me këtë, në qoftë
3 se kemi pasur ndonjë lloj influence, atëherë mund ta
4 diskutojmë pa praninë e tij.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Më vjen keq, por ju influencuat
6 dëshmitarin në këtë që të thatë. Megjithatë, mund të bëjmë
7 parashtime pa praninë e dëshmitarit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
9 duhet të dilni për një çast nga salla.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë në krye të faqes, ju
12 lutem. Nuk thotë BBC, thotë shërbimi monitorues i BBC-së. Kjo
13 nuk ka qenë në faqen e internetit të BBC-së por është një
14 shërbim që e kanë paguar, i kontraktuar, që monitoron lajmet
15 rajonale, i përkthen dhe ua jep personave që e dëshirojnë t'i
16 lexojnë. Nuk është BBC-ja, siç ju i thatë dëshmitarit. Nuk
17 bëhet fjalë për BBC-në burimin kryesor.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë,
19 filloni dhe një herë, ju lutem, dhe përdorni titullin siç
20 është. Dhe më pas bëni pyetjen e duhur, z. Pace.

21 Sillni Dëshmitarin në sallë.

22 [Trupi Gjykses dhe Sekretarja e seancës
23 këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do kemi një
25 vonesë, do kemi një vonesë të vogël derisa të vijë dëshmitari.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 142

1 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund t'i thuhet dhe një herë
2 dëshmitarit, ju lutem, çfarë është, si është titulli i saktë?
3 Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, a
5 bëjmë dhjetë minuta pushim tani se në momentin që do
6 rifillonim ne i takonte të ishte momenti i pushimit.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E lëmë. E
9 lëmë fare se dëshmitari erdhi. Vazhdojmë sipas planit.

10 Z. Pace për gjashtë minuta do bëjmë pushim, kini
11 parasysh. Faleminderit.

12 Një çast, një çast.

13 Dëshmitar, z. Pace do t'jua bëjë dhe njëherë pyetjet se
14 pati një keqkuptim për titullin e këtij dokumenti. Z. Pace do
15 ta sqarojë këtë keqkuptim menjëherë.

16 Z. PACE: [Përkthim]

17 PY. Po, Dëshmitar. Sikurse e shihni në ekran thuhet "BBC",
18 por më poshtë thotë, "Ndërmjetësuesi i SHBA-së fillon takimet
19 me rebelët në Kosovë, 336 fjalë, 9 nëntor 1998", dhe thotë
20 "Shërbimi Monitorues i BBC-së: Evropa Qendrore dhe Ballkani",
21 dhe më pas ka informacione të tjera.

22 Në nëntor të 1998 --

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Burimi i kësaj thotë ARTA.

24 Duhet ta thoni dhe këtë gjë. ARTA është burimi, burimi i këtij
25 informacioni është ARTA.

1 Z. PACE: [Përkthim] Për këtë ka të drejtë Mbrojtja. U
2 thashë, e thashë më herët që është agjencia e lajmeve ARTA.
3 Unë thjesht nuk thashë, nuk përmenda më herët që është
4 Shërbimi Monitorues për BBC-në.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

6 DËSHMITARI: Më lejoni të bëj një, më lejoni të bëj një
7 ndërhyrje?

8 Z. PACE: [Përkthim] Jo nuk kam pyetje për ju, Dëshmitar.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prisni për
10 pyetjen, ju lutem, Dëshmitar.

11 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani.

12 PY. Dëshmitar, kur shkua në Rambuje, Sekretarja Albright ju
13 këshilloi të krijonit marrëdhënie me z. Hashim Thaçi, apo jo?
14 PË. Po.

15 PY. Ju u fokusuat veçanërisht tek ai, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Krijuat një lloj miqësie me z. Thaçi në Rambuje, apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Në një moment i bëtë edhe disa rekomandime z. Thaçi
20 lidhur dhe me çfarë kostumesh duhet të mbante dhe çfarë
21 kravatash e kollaresh, apo jo?

22 PË. Jo domosdoshmërisht. Kjo në fakt ka dalë nga persona të
23 tjerë. U bëra si një lloj, u kthye, kjo u bë një mitologji.
24 Nuk e di nga ka dalë kjo legjendë që unë kam, i kam dhënë
25 këshilla edhe për kostumet.

1 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull atëherë. Shohim dokumentin
2 konkret në ekran DHT08787-DHT09214. E zvogëlojmë pak faqen e
3 parë.

4 PY. Kjo është ballina e një memuari nga Christopher Hill.
5 Shkojmë në faqen DHT08925, do ju lexoj paragrafin e
6 parafundit. Do lexoj:

7 "Jamie Rubin ishte i mendimit se udhëheqësi real i
8 delegacionit të Kosovës ishte Hashim Thaçi dhe Albright duhej
9 t'i fokusonte të gjitha përpjekjet e saj tek ai. Jamie kishte
10 filluar t'i kushtonte veçanërisht vëmendje Thaçit, madje
11 kishte shkuar aq larg sa t'i rekomandonte se çfarë kostumesh e
12 kravatash të vishte."

13 Kjo është diçka që i kujtohet z. Hill, a është e saktë?
14 PË. Absolutisht e pasaktë. Christopher Hill ka qenë i anshëm
15 dhe unë e kisha vënë re këtë. Ai ishte, nuk ishte i paanshëm
16 gjatë kohës si drejtues, ishte i anshëm, në favor të LDK-së
17 dhe ishte kundër UÇK-së. Unë kam qenë i paanshëm. Mua më është
18 kërkuar të punoj me udhëheqësin e vetëshpallur të
19 delegacionit. Chris Hill në mënyrë shumë të pamatur e bën
20 sikur unë flisja me Hashim Thaçin për veshjet e tij, për
21 kostumet e tij.

22 Christopher Hill këtu ka qenë i anshëm, është përpjekur
23 të më dëmtojë figurën mua dhe këtë e ka bërë në mënyrë të
24 vazhdueshme dhe gjithashtu është përpjekur të dëmtojë edhe
25 Sekretaren Albright duke dhënë, duke u thënë se ajo kishte

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 145

1 influencuar drejtuesin e delegacionit të UÇK-së në Rambuje,
2 dhe në fakt ne thjesht kishim një objektiv që donim të arrinim
3 atje.

4 Ne deshëm, unë desha të realizoja objektivat e Sekretares
5 Albright. Christopher Hill në mënyrë të pavërtetë duke shpikur
6 historira, është përpjekur të më dëmtojë mua imazhin, ka
7 minimizuar dhe rolin tim si diplomat duke nënkuptuar se ai ka
8 qenë një diplomat i mirë. Por në fakt ai është personi që i
9 dëmtoi dhe i dëmtoi disa nga diskutimet atje dhe nuk kishte
10 persona që të na ndihmonte ne me UÇK-në dhe për shkak të tij
11 ne nuk e morëm "po"-në nga UÇK-ja për marrëveshjen. Dhe kjo
12 pati pasoja.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Do të bëjmë dhjetë minuta pushim. Ju lutem mos e diskutoni me
15 askënd dëshminë tuaj.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 Z. DIXON: [Përkthim] Dua të diskutoj diçka. Unë përmenda
18 një nga dokumentet e mia sa i takon kontakteve në terren me
19 Shaun Byrnes. E thashë këtë për çështjen e relevancës që ju
20 dua, u diskutua pak më herët.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju thashë që
22 unë, ne do të marrim një vendim lidhur me këtë.

23 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë dhjetë
25 minuta pushim.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 146

1 --- Pauza fillon në orën 15.29

2 --- Seanca rifillon në orën 15.42

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

4 Sekretare, mund ta sillni dëshmitarin në sallë.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë
7 me pyetjet e Prokurorisë për ju, z. Rubins [Sipas përkthimit].
8 Do vazhdojmë deri në orën 4.30 sot, dhe do ta mbylлим në atë
9 çast.

10 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar, z.

11 Kryegjykatës.

12 PY. Dëshmitar, në mars të vitit 1999 Sekretarja Albright iu
13 referuar z. Thaçi si "miku juaj, shoku juaj". A është e saktë
14 kjo?

15 PË. Po.

16 PY. Në Rambuje, Hashim Thaçi u përball me një presion të
17 jashtëzakonshëm nga znj. Albright dhe persona të tjerë që
18 ishin të pranishëm për të nënshkruar marrëveshjen. A është e
19 saktë kjo?

20 PË. Po.

21 PY. Në fund të Rambujesë, anëtarë të tjerë të delegacionit
22 kosovar donin që ta nënshkruanin marrëveshjen, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Gjatë të gjithë negociatave në Rambuje, nevojitej
25 marrëveshja e Hashim Thaçit që të vijojë më tej, sepse në të

1 kundërtën do të duhej që ta filloni të gjithën nga fillimi,
2 apo jo?

3 PË. Nuk është tamam ashtu. Objektivi ishte që të dyja palët
4 të binin dakord në mënyrë të tillë që ne kishim një
5 marrëveshje paqeje edhe në mënyrë të tillë që të parandalonim
6 përshkallëzimin e mëtejshëm të luftës.

7 Si minimum, ne dëshironim, sepse kishim dyshime tona në
8 qoftë se pala serbe do të binte dakord derisa të shikonin që
9 presioni të rritej, por për të pasur një presion në rritje ne
10 na nevojitej që i gjithë delegacioni kosovar të pajtohej me
11 marrëveshjen. Me zhvillimet me kalimin e kohës, kishim
12 përfaqësues të delegacionit kosovar që quheshin anëtarë të
13 UÇK-së, ata nuk u pajtuan që të nënshkruanin marrëveshjen
14 atëherë, por pas disa javësh dhe kjo ishte mënyra sesi të
15 rritej presioni në mënyrë të tillë që serbët të mund të
16 nënshkruanin, dhe në mënyrë të tillë që ne të realizonim
17 objektivin fundor që ishte arritja e paqes. Ky ishte objektivi
18 ynë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të kërkoj të paraqitet në
20 ekran tani prova që mban numrin aktualisht 1D280.

21 PY. Dëshmitar, sikurse mund ta shihni ky është një artikull i
22 *Financial Times*. Është një artikull të cilën u përmend më
23 përpara nga Mbrojtja e z. Thaçi dhe ju thatë më herët lidhur
24 me këtë artikull që jeni munduar që të jeni sa më i saktë të
25 jetë e mundur kur keni shkruar këtë artikull. Dëshiroj që të

1 shohim disa pjesë të caktuara të këtij artikulli. Do lexoj nga
2 mesi i kolonës së pesë. Duhet t'i kërkoj Sekretares të
3 zmadhojë shkrimin në kolonën e pestë. Ta kalojmë pak më në
4 qendër të ekranit.

5 PY. Paragrafi që do t'ju lexoj që "Albright i dha atij ..."
6 dhe pastaj do e lexojmë deri në fund të paragrafit. Këtu
7 thuhet:

8 "Albright më kërkoi që të punoja me Thaçin. Pjesa tjetër
9 e delegacionit kosovar kishin dhënë sinjal që ato me shumë
10 gjasa do të mbështesnin atë në qoftë se ai do të pajtohej që
11 të vazhdonim më tej. Në të kundërtën ne do ishim përsëri -- do
12 fillonim përsëri nga zeroja."

13 Pyetja ime është kjo: A e keni shkruar ju këtë apo jo?
14 PË. Po.

15 PY. Kaq e kisha pyetjen. Vazhdojmë më tej. Gjatë Rambujesë
16 anëtarë të UÇK-së iu kanë thënë juve që ata ishin të
17 përgatitur që të pajtoheshim me dokumentin e propozuar prej
18 jush, por që kjo varej nga z. Thaçi. A është kështu?

19 PË. Nuk do e formuloja ekzaktësisht kështu, në fakt. Ne nuk e
20 dinim se çfarë do bënin askush nga palët aty deri në momentin
21 kur ndodhi ajo çfarë ndodhi. Thjesht kemi marrë sinjale,
22 dikush na thoshte çfarë do bënte tjetri. Por, në realitet ne
23 nuk e dinim se çfarë do të bënin secili prej tyre kur të ishte
24 momenti i duhur, derisa erdhi ai moment.

25 Ne morëm disa sinjale, megjithatë, nuk kishim asgjë që

1 ishte përfundimtare, nuk kishim asnjë tregues përfundimtar.
2 Kishte kundërshtime nga shumë anëtarë lidhur me mungesën e
3 qartësisë që kishte të bënte me pavarësinë, megjithatë, ne
4 shpresonim që formulimi ose gjuha - nuk më kujtohen tamam
5 formulimet, gjuha, fjalët e përdorura - domethënë, i kërkoj
6 ndjenjë, i kisha fjalët pak më përpara, por nuk më kujtohen
7 tani. Nuk më vijnë në mendje.

8 Megjithatë, pavarësisht kësaj ne shpresonim që i gjithë
9 delegacioni të nënshkruante marrëveshjen. Ishim optimistë për
10 shumë prej tyre dhe për shkak të takimit tonë me Thaçin, ne
11 menduam që ai ishte më i vështiri. Për ne ai ishte sfida më e
12 madhe.

13 Z. PACE: [Përkthim] Tani do kërkoj që të paraqitet një
14 dokument që e kishim përpara një çasti në ekran, që është
15 1D280. Të kalojmë në faqen e dytë. Këtu do lexoj nga paragrafi
16 i fundit i kolonës së gjashtë.

17 Jo, do lexoj nga fillimi i kolonës së shtatë. Kështu që
18 do kërkoja që të zmadhohet pjesa e dytë e artikullit.

19 PY. Edhe një herë, Dëshmitar, ky është artikulli që është
20 botuar në *Financial Times*, dhe që e keni diskutuar dhe më
21 herët sot. Këtu thuhet si më poshtë:

22 "Në fund, varej nga Thaçi dhe ai nuk lëshonte pe. Anëtarë
23 të tjerë të UÇK-së na thanë privatisht që ata ishin të
24 përgatitur që të pajtoheshim, por varej çdo gjë prej tij."

25 Edhe një herë, pyetja e vetme që kam për u është: A e

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 150

1 keni shkruar këtë pjesë ju në shtator apo tetor '99-s?

2 PË. Ka më shumë përgjigje pyetja, megjithatë, në përgjigje të
3 pyetjes tuaj unë mund të them që, po, e kam shkruar unë.

4 PY. Në deklaratën e dhënë ju keni thënë që UÇK-ja nuk ishin
5 gati që të nënshkruanin marrëveshjen e Rambujesë sepse kjo nuk
6 do çonte në pavarësinë e menjëhershme të Kosovës. Kjo jepet në
7 paragrafin 46. Kjo është në përputhje me artikullin që keni
8 shkruar në *Financial Times*, sepse aty ju thonin, dhe këtu citoj
9 që:

10 "UÇK-ja donte një angazhim të vërtetë dhe të shprehur
11 prej nesh për sa i takon pavarësisë eventuale."

12 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

13 PË. Po.

14 PY. Hashim Thaçi dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së e kishin bërë
15 të qartë përpara shkurtit të '99-s që ata nuk do mbështesnin
16 asnjëherë një zgjidhje politike në qoftë se nuk përmendej
17 shprehimisht pavarësia në dokumentin në marrëveshjen
18 përkatëse, apo jo?

19 PË. Nuk e di kontekstin, nuk di më hollësi për t'ju dhënë.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të paraqitet në ekran dokumenti
21 P01067.

22 PY. Shohim dokumentin përpara në ekran. Në të thuhet që është
23 një dokument i Departamentit të Shtetit të SHBA-ve. Mund ta
24 zmadhojmë pak dokumentin në krye. Mendoj që e dini më mirë se
25 unë, por, dua t'ju pyes, a është korrekti fakti që data është

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 151

1 3 nëntor 1998, apo jo?

2 PË. Po, ka një zero aty që është gabim, po është i
3 deklasifikuar.

4 PY. Në rregull. Ky është një dokument i cili është dërguar
5 nga Ambasada e Beogradit në Uashington DC, Sekretares së
6 Shtetit në Uashington DC.

7 Z. PACE: [Përkthim] Të shohim në të njëjtin dokument
8 faqen 075306. Të kalojmë në fund të faqes.

9 PY. Do lexoj nga paragrafi 15 në këtë faqe.

10 "Thaçi dhe kolegët e tij jo befasisht kërkuan pavarësinë,
11 dhe thanë që në fund ata asnjëherë nuk do të mbështesin një
12 zgjidhje politike pa referencë specifike të pavarësisë në atë
13 dokument."

14 Pyetja që kisha unë për ju më përpara ishte që në qoftë
15 se ju e keni pasur këtë informacion në vitin 1998?

16 PË. Këto kabllograme -- ishin vlerësimet e individëve të
17 caktuar kur janë shkruar këto tekste. Dhe ai që e ka shkruar
18 këtë nuk ka shkruar ashtu siç ka qenë e vërteta. Domethënë se
19 e vërteta është që dokumenti u nënshkrua pa u përmendur
20 pavarësia fare.

21 PY. Nuk po i përgjigjeni pyetjes time.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Në fakt, iu përgjigj pyetjes.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
24 përgjigjuni pyetjes që ju bëhet, sepse në qoftë se duan që
25 t'ju bëjnë pyetje palët e tjera, do të kenë mundësinë t'ja u

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Page 152

1 bëjnë këto pyetje.

2 Z. PACE: [Përkthim]

3 PY. Pyetja ime është kjo: Në nëntor të '98-s, a keni mësuar
4 ju informacionin që sapo e lexoja, që përmban kjo kabllogramë?

5 PË. Nuk po them as po, as jo.

6 Z. PACE: [Përkthim] E heqim nga ekrani dokumentin.

7 PY. Në tetor 1998 media e ka cituar Hashim Thaçin si
8 përfaqësues të UÇK-së, që ka thënë që UÇK-ja do ndëshkojë çdo
9 grup individual i cili do nënshkruajë një marrëveshje në
10 kundërshtim me gatishmërinë dhe vullnetin e njerëzve, të
11 shprehur sipas referendumit të 91-shit.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj, më duhet të
13 kundërshtoj. Cila është baza mbi të cilën bën pyetje
14 Prokurori? Nga ta dijë dëshmitari se çfarë ka thënë Hashim
15 Thaçi në '91-shin. Ka shumë herë që e bën këtë pyetje
16 Prokurori.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do e pyesni
18 dëshmitarin se nga ta dijë këtë?

19 Z. PACE: [Përkthim] Në qoftë se doni shpjegime, mund
20 t'jua jap shpjegimet pa praninë e dëshmitarit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk është e
22 nevojshme që të kalojmë në seancë private. Vetëm thjesht më
23 thoni se cila -- shpjegimi juaj.

24 Z. PACE: [Përkthim] Nuk po flas për seancë private, por
25 nuk dua që të udhëzoj dëshmitarin duke bërë parashtrime në

1 praninë e tij për sa i takon kësaj teme.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] E kundërshtoj.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 Z. PACE: [Përkthim] Pra, në rregull, do vazhdoj me një
5 pyetje tjetër. Do kërkoj që të paraqitet në ekran një dokument
6 që ka numrin P04141. Ta zmadhojmë në fillim në krye të faqes.
7 PY. Është një dokument që shkruhen "Associated Press" dhe
8 titulli është "Ushtria Rebelë e Kosovës kundërshton
9 marrëveshjen e ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara për
10 Kosovën. Ndërkohë është një artikull i cili është shkruar nga
11 Ismet Hajdari, është data 16 tetor 1998, në orën 18:48. Pastaj
12 vijohet më tej me *Associated Press*".

13 Dhe në qoftë se do të vazhdojmë drejt fundit të faqes,
14 aty thuhet si më poshtë. Do t'ju lexoj, Dëshmitar, do lexoj
15 nga paragrafi i fundit.

16 Citoj:

17 "'UÇK-ja do të ndëshkojë çdo individ ose grup që guxon të
18 nënshkruajë një marrëveshje që është në kundërshtim me
19 vullnetin e popullit tonë, siç është shprehur në referendumin
20 1991-shit, që është një referendum jo i autorizuar
21 zyrtarisht'. Thaçi thotë, duke iu referuar një vote në të
22 cilën shqiptarët e Kosovës vendosën që të shkëputeshin nga
23 Serbia, nga republika dominante e Jugosllavisë."

24 Pra, a e keni ditur këtë informacion? Keni qenë në dijeni
25 të këtij informacioni, Dëshmitar, në 1988-n?

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtoj.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk pranohet.

3 Ju lutem përgjigju në qoftë se e keni përgjigjen.

4 DËSHMITARI: Tetori kishte të bënte me Rambujen.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja ishte:

6 A keni dijeni për këtë deklaratë ose a e njihni këtë dokument?

7 Kjo është pyetja.

8 DËSHMITARI: Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet lidhur me

9 marrëveshjen e tetorit. Nuk më kujtohet aq mirë.

10 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta hiqni dokumentin nga ekrani.

11 PY. Një tjetër arsye se pse z. Thaçi nuk ka nënshkruar gjatë

12 Rambujesë është që UÇK-ja nuk dëshironte që të çarmatosej. A

13 është kështu, Dëshmitar?

14 PË. Përgjigja është negative, jo. Mesa di unë, jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë po

16 thonit, z. Pace?

17 Z. PACE: [Përkthim] Le të kalojmë në faqen, në dokumentin

18 P00811. Faleminderit që paraqitët dy versionet, në shqip dhe

19 në anglisht. Tani të kalojmë në faqen SPOE00053983 në të dyja

20 versionet, në shqip dhe në anglisht. Në shqip faqja në PDF

21 është 123, besoj. Besoj që është shfaqja 2. ET 47, është

22 përkthimi në anglisht.

23 Këtu në fund të faqes në anglisht dhe në shqip është

24 shkruar si më poshtë:

25 "Intervistë e z. Hashim Thaçi dhënë gazetës Kosova Sot.

1 Në anglisht është *Kosova Today*. Do kalojmë tek faqja që
2 përfundon me 85, dy faqe përpara asaj që kemi në ekran tani.
3 Do të lexoj nga paragrafi që ka pyetjen të lidhur me
4 Millosheviqin.

5 PY. Thuhet që:

6 "Millosheviqi refuzon me kokëfortësi ta nënshkruajë
7 marrëveshjen. Mirëpo, edhe po ta nënshkruajë, ai refuzon
8 trupat ndërkombëtare paqeruajtëse. A besoni se NATO do të
9 fillojë sulmet mbi bazat ushtarake të Serbisë?"

10 Përgjigja është kjo:

11 "Shpresoj. Por megjithatë nuk besoj shumë se do të vijë
12 puna deri te sulmi. Nuk duhet të jemi shumë të preokupuar me
13 këtë. Ne duhet të mbështetemi në forcat tona në vullnetin,
14 organizimin, fuqizimi dhe rezistencën tonë ushtarake. Pra,
15 duhet të mblidhemi rreth Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.
16 Pavarësisht se çka do të ndodhë pas kësaj konference, ne jemi
17 të bindur që të drejtat mund të realizohen vetëm me mundim,
18 sakrificë dhe dijen tonë. Mirëpo, çdo përkrahje që vjen prej
19 kujtdo qoftë e mirëpresim. Ne as që e kemi konsideruar NATO-n
20 si forcë paqeruajtëse, që do të kontribuonte për paqen,
21 mirëkuptimin dhe stabilitetin në Kosovë.

22 "Po flitet rreth idesë së çarmatosjes së UÇK-së pas
23 ardhjes së forcave paqeruajtëse në Kosovë. Nuk njoh ushtri në
24 botë t'i ketë dorëzuar armët. Këtë nuk do ta bëjë as Ushtria
25 Çlirimtare e Kosovës. Me punën e vet gjatë luftës ajo është

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 156

1 aftësuar dhe profesionalizuar, kështu që është dhe do të
2 mbetet ushtri shtetërore.”

3 A jeni në dijeni të një informacioni të kësaj natyre që
4 është raportuar, z. Dëshmitar?

5 PË. Këto janë deklaratat publike të UÇK-së që mund të kenë
6 pasqyruar ose jo pozicionin e tyre. Ndonjëherë i kemi kushtuar
7 rëndësi, ndonjëherë jo. Por, në përgjithësi ne kemi parë atë
8 çfarë ka ndodhur në realitet, në praktikë. Dhe ajo çfarë ka
9 ndodhur në praktikë është që UÇK-ja u çarmatos. Nuk e kuptoj
10 dot pyetjen tuaj, pasi pas luftës UÇK-ja u çarmatos.

11 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim dokumentin nga ekrani. Tani
12 dëshiroj të paraqitet në ekran dokumenti SPOE00017931.
13 Atëherë, për referencë, dokumenti është SPOE0011783 deri në
14 00117090.

15 DËSHMITARI: Kush e ka shkruar këtë? Nuk e kuptoj.

16 Z. PACE: [Përkthim] Do vijmë dhe këtu.

17 PY. Atëherë, shikojeni dokumentin që keni në faqen përpara
18 jush, data e dokumentit është 26 shkurt 1999 dhe titulli është
19 “Reflektime mbi Rambujenë”.

20 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen e dytë të
21 dokumentit që është 7090. Në fund të kësaj faqeje është një
22 nënshkrim. Poshtë nënshkrimit është emri David Willson.

23 Të kalojmë përsëri në faqen e parë.

24 PË. Unë nuk e di kush është David Willson.

25 Z. PACE: [Përkthim] Të kalojmë dhe një herë te ky

1 dokument. Në fakt, të shohim dokumentin 0017085.Do lexoj nga
2 mesi i faqes këtu. Lexoj nga "Kontrolli UÇK-së ..." dhe më
3 poshtë.

4 "Kontrolli UÇK-së - Delegacioni i shqiptarëve u dominua
5 dhe kontrollohej nga UÇK-ja, që nga ana e vet ishin dyshues
6 për çdo gjë dhe çdokënd në Rambuje. Anëtarë kyç të UÇK-së
7 kishin mbërritur në negociata me një ose dy ide strikte,
8 (referendum dhe rolin e ardhshëm të UÇK-së) në mendjen e tyre,
9 dhe ishte e kuptueshme dhe e dukshme që pjesa dërmuese, në
10 qoftë se jo të gjithë anëtarët e UÇK-së, nuk e lexonin ose nuk
11 e kuptonin tekstin e plotë. Dhe kjo donte të thoshte që
12 shtojca ushtarake për ata të cilët kishin vështirësi akademike
13 reduktohej në pjesë të vogla të UÇK-së që bënë thirrje ose që
14 kërkonin çarmatimin e UÇK-së. Askush nga UÇK-ja, brenda ose
15 jashtë shatosë, nuk mund të kuptonte ose të pranonte këtë
16 opsionin. Pra, asnjë prej tyre nuk ishte pro transformimit të
17 rolit të tyre. Ishte e vështirë të shprehej se si mendimi i
18 UÇK-s mbi këtë temë të mund të reflektonte.

19 Domethënë, a jeni ju në pajtim me formulimin e këtij
20 artikulli?

21 PË. "Me vështirësi akademike", në fakt, nuk jam dakord fare
22 me këtë lloj formulimi sepse është pexhorativ, është negativ
23 në formulim. Nuk e di kush e ka shkruar këtë pjesë. Ndoshta ai
24 personi që e ka shkruar mund të ketë pasur një këndvështrim të
25 bisedave, të negociatave. Është një formulim i komplikuar. Unë

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 158

1 mundova që ta shprehja sa më shkoqur të ishte e mundur në
2 artikullin tim, megjithatë, unë personalisht nuk do shkruaja
3 kurrë një pasazh me këtë lloj gjuhe. Në qoftë se ti thua që
4 "njerëzit kanë vështirësi akademike", i takon që të thuash që
5 njerëzit janë budallenj, nuk dinë se çfarë bëjnë e çfarë
6 mendojnë.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Pace, a mund të na jepni
8 informacion se kush e ka shkruar këtë pasazh ose nga ka
9 ardhur, nga e ka burimin ky dokument?

10 Z. PACE: [Përkthim] Autori, sikurse e thashë, është David
11 Wilson. Unë nuk dua që ta them gabimisht pozicionin e tij në
12 atë kohë.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A e dini për çfarë
14 organizate punonte ky person, dini ndonjë gjë tjetër lidhur me
15 këtë person?

16 Z. PACE: [Përkthim] Do t'ju jap më shumë informacion pas
17 pak.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Gjykatës, në qoftë se do shikoni
19 shënimin përgatitor për dëshmitarin tjetër, besoj se do gjeni
20 përgjigjen e pyetjes tuaj.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

22 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim nga ekrani dokumentin.

23 PY. Tani, që të nënshkruanin apo të mosnënshkruanin kushtet e
24 Marrëveshjes së Rambujesë ishte çështje shumë e rëndësishme?

25 PË. Po.

1 PY. Ishe pothuajse çështje ekzistenciale për Kosovën dhe UÇK-
2 në, apo jo?

3 PË. Për popullin e Kosovës, nënshkrimi do të thoshte
4 mbështetje të NATO-s dhe të forcave të NATO-s, mosnënshkrimi
5 do të thoshte që do ngeleshin vetëm. Pra, për popullin e
6 Kosovës kjo ishte shumë e rëndësishme. Për këtë kemi folur.

7 PY. Më herët dëshmuat që fati potencialisht i milionave të
8 njerëzve ishte në lojë?

9 PË. Po, e kisha fjalën për popullin e Kosovës.

10 PY. Dhe siç e keni thënë publikisht më herët, nënshkrimi i
11 marrëveshjes nuk ishte aq i thjeshtë saqë të thoje, të jepje
12 okej ose jo me një diktator, pra, gishtin lart apo poshtë?

13 PË. Po.

14 PY. Pra, në thelb ishte që delegacioni i Kosovës ndiente dhe
15 kërkonte më shumë garanci për Kosovën, fatin e Kosovës, apo
16 jo?

17 PË. "Garanci" është fjalë e fortë. Nuk ekzistojnë gjëra të
18 tilla në marrëdhënie ndërkombëtare, pra, në çështje
19 ndërkombëtare që garantohen. Mendoj që kërkoheshin siguri që
20 do jepej nga NATO, që do të vazhdonte më tej me procesin, pra,
21 me premtimin e saj, do të zbatonte premtimin për të përdorur
22 forcën ushtarake nëse serbët vazhdonin me shtypjen e tyre.
23 Nëse serbët nuk e bënë këtë gjë, atëherë nëse qeveria serbe,
24 pra, nuk nënshkruante, atëherë ata kërkonin që t'ju jepeshin
25 siguri që në qoftë se të gjithë të tjerët nënshkruanin, NATO-

1 ja do të zbatonte, do të përdorte forcën dhe nuk kërkonin një
2 zbatim të dobët, të brishtë siç kishte ndodhur në tetor. Ata
3 po kërkonin për siguri që t'ju jepnim neve, që ne do t'ju
4 jepnim atyre dhe që do të mbanim premtimin tonë.

5 Pra, kur bëhej fjalë për vullnetin e popullit, ne, siç e
6 kam thënë edhe më herët, nuk mund të garantonim, po citoj,
7 "pavarësinë e një votë, një votim për pavarësinë" nuk mund,
8 por ne mund t'u garantonim atyre që do të kërkonim që vullneti
9 i popullit të -- ne do të bënim të mundur që respektohej
10 vullneti i popullit, por ne nuk ishim në atë pikë në atë
11 moment në 1999, nuk ishim përgatitur për të njohur pavarësinë
12 e Kosovës. Dhe për këtë kishe kufij në politikën tonë. Fushata
13 ushtarake e ajrit, po, trupat tokësore jo.

14 Në qoftë se forcat serbe, serbe dhe shqiptare, shqiptarët
15 e Kosovës do të nënshkruanin atëherë ne do të dërgonim trupat
16 e NATO-s. Nëse serbët nuk do të nënshkruanin dhe shqiptarët do
17 të nënshkruanin atëherë ne ishim të përgatitur të përdornim
18 fushatën ajrore. Pra, këto ishin parametrat që ne kishim, këto
19 ishin siguritë që ne mund të jepnim. Dhe isha i kënaqur në
20 këtë rast, që nuk është gjithmonë, ne ishim në gjendje të
21 zbatonim atë që kishim premtuar.

22 PY. Të kalojmë në faqen 54 të deklaratës tuaj që keni dhënë
23 Mbrojtjes ku thoni që sipas asaj që keni kuptuar ju, z. Thaçi
24 nuk ishte në krye por më poshtë njerëzve që ishin si, për
25 shembull, Demaçi. Dhe pyetja ime e parë është: A është e saktë

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 161

1 që z. Demaçi nuk ishte pjesëtar i Shtabit të Përgjithshëm të
2 UÇK-së?

3 PË. Mendoj që kam qenë shumë i qartë në takimet e mia me
4 avokatët kur kam përgatitur deklaratën time se kush ka qenë në
5 krye që merrte vendimet.

6 PY. Po mund t'i përgjigjeni vetëm pyetjes time, ju lutem?

7 PË. Po përgjigjem por ju po jepni një pohim.

8 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, z. Gjykatës, por
9 dëshmitari nuk po i përgjigjet pyetjes.

10 DËSHMITARI: Po përpiqem.

11 Z. PACE: [Përkthim] A është e saktë se z. Adem Demaçi nuk
12 ishte pjesëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së?

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
14 përgjigjeni kësaj. Vazhdoni.

15 DËSHMITARI: Nuk kam qenë i njohur, nuk kam pasur njohuri
16 se kush kanë qenë pjesëtarët e UÇK-së, të gjithë pjesëtarët e
17 UÇK-së, nuk mund t'i përgjigjem.

18 Z. PACE: [Përkthim] Do të kërkoj të shfaqet dokumenti
19 P00763.5-ET bashkë me P00763.5-AT. Dhe mund të jemi në të
20 njëjtën faqe.

21 PY. Siç e shihni në këtë faqe, lexon 18 shkurt 2020, Hagë,
22 Holandë. Dhe pastaj do të kalojmë disa rreshta më poshtë, ku
23 shohim, ku ju bëni një përmbledhje në rreshtat 6, 7,
24 përmbledhje të intervistës së Rexhep Selimi. Në fund, mund të
25 shohim se ky është transkripti i ZPS-së dhe kjo është nga

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 162

1 intervista e ZPS-së që ka bërë me z. Rexhep Selimi.

2 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të kalojmë në faqen 17 në
3 anglisht, faqja 18 në shqip.

4 PY. Në anglisht do të lexoj nga rreshti 8. Në shqip do të
5 jetë në rreshtin 8.

6 "PY. Kur mori rolin dhe kur u emërua në rolin për të
7 zhvilluar kuvendin kombëtar kush e informoi atë për detyrën që
8 kishte dhe cili do të ishte roli?

9 "PË. Ai erdhi shpesh. Erdhi disa herë në zonën e luftës
10 dhe Shtabi i Përgjithshëm së bashku me asistentin e tij në atë
11 kohë dhe kryeministri aktual i vendit tonë, Albin Kurti dhe
12 kemi patur takime, kontakte të shpeshta, por është e
13 rëndësishme të dimë që z. Thaçi ishte emëruar përfaqësues
14 politik. Të gjithë përfaqësuesit politikë ishin qoftë në vende
15 të ndryshme të Evropës apo në botë apo në Prishtinë kishin
16 këtë linjë komunikimi me z. Thaçi si përfaqësues politik.

17 "PY. Pyetja ime është që do të thotë, pra, që z. Thaçi
18 ishte superior ndaj të tjerëve?

19 "PË. Po."

20 Dhe pyetja ime tani është: A kishit dijeni për këtë
21 informacion?

22 PË. Informacioni është i pasaktë, me aq sa kuptoj unë, unë
23 nuk kam pas dijeni për këtë.

24 PY. Rexhep Selimi duhet ta dijë më mirë lidhur me pozitën që
25 kishte z. Thaçi në UÇK sesa ju, apo jo?

1 PË. Jo. Unë e kam vëzhguar z. Thaçi se nuk kishte dëshirë të
2 vepronte pa mbështetjen e Adem Demaçit, duke e trajtuar atë si
3 superior. E kam parë këtë në mënyrë të drejtpërdrejtë si
4 dëshmitar okular, që ka pasur disa individë mendimet e të
5 cilëve vendosnin, përcaktonin nëse Hashim Thaçi ndihej rehat
6 me nënshkrimin e marrëveshjes në Rambuje. Kjo është arsyeja
7 pse Madeleine Albright kontaktoi Adem Demaçin pas Rambujesë
8 sepse menduam se Adem Demaçi kishte ndikim mbi Hashim Thaçin,
9 jo e kundërta. Pra, jo superior.

10 Ai mund tua ketë thënë këtë juve, ai mund ta ketë besuar
11 këtë. Por përvoja jonë në bisedimet në momentin e krizës,
12 Hashim Thaçi kërkonte nga Adem Demaçi miratimin e tij për të
13 bërë diçka. Kjo nuk është diçka që personi bën me dikë që
14 është poshtë tij. Bëhet me dikë që është mbi juve, pra, kur
15 bëhet një gjë e tillë.

16 Kjo është arsyeja pse nuk e kemi konsideruar atë si
17 vartës të tij, por, sinqerisht, më shumë si një superior
18 ideologjik i tij sepse këto ishin -- nuk janë thjesht
19 organigrama të një organizate. Nuk bëhet fjalë thjesht për
20 këtë. Këto janë çështjet e pavarësisë ose të jopavarësisë e
21 kështu me radhë. Nuk pajtohem, pra, me dëshminë e tij. Dhe në
22 përvojën time, z. Thaçi kërkonte miratimin nga Adem Demaçi
23 përpara sesa të jepte pëlqimin e tij për marrëveshjen e
24 Rambujesë dhe për rrjedhojë e trajtonte atë si epror të tij.

25 PY. Mund të qartësoni përgjigjen tuaj, atëherë, si mund ta

1 dini ju më mirë se z. Rexhep Selimi për rolin e Hashim Thaçi
2 brenda UÇK-së?

3 PË. Nuk mund të di se si t'i përgjigjem kësaj pyetjeje sepse
4 nuk kam mënyrë ta di. Është lloji i pyetjes që nuk mund t'i
5 jepet përgjigje. Nuk e di kush e di më mirë. Ndoshta z. Thaçi
6 e di. Por vëzhgimi, ajo që kam parë unë dhe mund të bëjnë këtë
7 sallë të gjyqit është t'ju them atë që di dhe që kam vëzhguar.

8 Z. PACE: [Përkthim] Ta heqim këtë dokument.

9 David Wilson, pra, më dhënë informacionin, është
10 brigadier i ushtrisë britanike në pension, ka punuar për UNMIK
11 dhe ka qenë i pranishëm në Rambuje në kohën kur ka punuar për
12 OSBE-në.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. PACE: [Përkthim]

15 PY. Dëshmitar, Adem Demaçi kundërshtonte nënshkrimin e
16 marrëveshjes në Rambuje, apo jo?

17 PË. Kështu e kam kuptuar unë. Nuk kam biseduar asnjëherë me
18 të, por ai i ka thënë këtë gjë Madeleine Albright.

19 PY. Adem Demaçi u tërhoq nga UÇK-ja, dha dorëheqjen më 2 mars
20 1999 në periudhën pas Rambujesë dhe përpara Parisit, apo jo?

21 PË. Kështu e kuptoj, nuk e di nëse ka dhënë dorëheqjen apo
22 jo. Por po them jo, po them kështu më duket se kështu është.

23 PY. Është pak pyetje e vështirë, e kuptoj këtë. Gjatë
24 bombardimeve të NATO-s, z. Thaçi ka përdorur një telefon
25 satelit për t'ju kontaktuar juve në Departamentin e Shtetit, e

1 saktë?

2 PË. E saktë.

3 PY. Në shtator, tetor 2000, artikulli juaj në *Financial*
4 *Times*, ju keni shkruar që kjo ka ndodhur "kryesisht në
5 mëngjes", për pjesë të të cilave komunikimi, ju keni
6 konfirmuar edhe saktësinë e tyre në deklaratën tuaj. Dhe në
7 deklaratën tuaj ju thoni se besoni që keni folur me z. Thaçi
8 mes datës 10, midis 10 dhe 14 herë gjatë fushatës 78 ditore të
9 bombardimeve. Cila është më e saktë? Pra, a keni biseduar më
10 shumë në mëngjes apo ka qenë 10, 14 herë mesa ju kujtohet?

11 PË. Nuk mund të dalloj mes këtyre dyjave.

12 PY. Po ju nuk jeni i sigurtë a ka qenë 10, 14 herë në
13 deklaratën tuaj apo ka qenë më shumë gjatë kësaj periudhe 78
14 ditore?

15 PË. Në qoftë se bëjmë një përllogaritje matematike, më së
16 shumti mund të jetë 40. Natyrisht nuk mendoj se ka qenë 40.
17 Por kur kemi biseduar dhe i kemi shkruar njëri-tjetrit, kur
18 themi "kryesisht mëngjeseve", kjo do të thotë shumë. Pra, nuk
19 po bëjmë një përllogaritje matematike të 78 ditëve pjesëtuar
20 për 2 që del 38 apo 39 dhe pastaj themi që kam folur me të një
21 numër të caktuar kohësh. "Pjesët më të madhe të mëngjeseve",
22 gati çdo mëngjes, kjo është një mënyrë shprehjeje e lirë për
23 të thënë që ka pasur shumë biseda telefonike gjatë luftës dhe
24 në fakt është ajo që ka ndodhur, pra, jo çdo mëngjes, por
25 shumë mëngjese.

1 PY. Do të kaloj tani te dokumenti DHT05156-DHT05164.

2 Z. PACE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Është pranuar tashmë.
3 Nuk e kam numrin e provës materiale që i është dhënë.

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Numri i provës
5 materiale është 1D272.

6 Z. PACE: [Përkthim] Qëndrojmë në faqe, faqen kryesore.

7 PY. Shohim që ka të bëjë me njoftimin për shtyp të datës 1
8 prill 1999. Dhe, në fakt, kjo trajtohet, përmendet dhe në
9 deklaratën tuaj.

10 Z. PACE: [Përkthim] Në të njëjtin dokument, tani do të
11 kalojmë tek faqja DHT05159. Dhe do të filloj duke lexuar nga
12 paragrafi i fundit dhe në faqen tjetër.

13 PY. Dhe për kontekst, do të lexoj pjesën ku ju i referoheni
14 z. Thaçi:

15 "Ai tha se njerëzit në zonat përreth Prishtinës po
16 detyrohen të largohen. Ai tha se UÇK-ja kishte qenë në gjendje
17 që të largonte, të evakuonte disa njerëz nga Prishtina. Në
18 Podujevë, ai tha se forcat e Arkanit dhe Seselj po plaçkitin,
19 vënë zjarrin dhe djegin qytetin dhe tha që UÇK-ja po punonte
20 në përpjekje për të mbrojtur popullsinë dhe në male, në zonën
21 malore të Shalës dhe Bajgorës, një numër i madh i përqendruar
22 i civilëve po bombardohen, granatohen dhe ata po zbresin me
23 sëmundje dhe të tjera.

24 "Ai tha se Vushtri, 5.000 njerëzit që më parë ishin
25 mbajtur të ndaluar aty nga serbët janë liruar dhe tani po

1 lëvizin drejt maleve. Ai tha që ata akoma nuk kanë
2 informacione për 20.000 njerëzit nga Skënderaj, të cilët
3 përdoren nga serbët. Ai mendon që ka marrë informacion që
4 është e vështirë që të jemi të sigurtë për këtë informacion,
5 pra, për të mbrojtur fabrikën e municioneve të tyre duke i
6 vendosur ata atje. Ai tha që luftimet vazhdojnë, janë të egra
7 në disa rajone, përfshirë në rajonin e Malishevës dhe që një
8 numër në rritje i popullsisë civile po lëvizin drejt
9 Maqedonisë dhe Shqipërisë.

10 "Pra, përgjigja e shkurtër e përgjigjes tuaj është që --
11 përgjigja e shkurtër e pyetjes tuaj është e qartë se UÇK-ja,
12 Ushtria Çlirimtare e Kosovës, po kalon kohë të vështira po ata
13 vazhdojnë, sipas z. Thaçi, vazhdojnë të bëjnë këtë, bëjnë atë
14 që mund të bëjnë në këto rrethana të vështira.

15 "PY. A ju kërkuan ata armatim të rëndë nga Shtete e
16 Bashkuara dhe cila ishte përgjigja juaj?"

17 Pyetja ime është: A ishte ky një informacion tipik që z.
18 Thaçi do të jepte gjatë një prej bisedimeve telefonike që keni
19 pasur me të gjatë kësaj kohe?

20 PË. "Tipike" është fjalë pak e ashpër. Ky nuk është moment
21 tipik. Këto janë gjëra të tmerrshme që po ndodhin. Dhe unë
22 përpiqem në këtë moment që të trajtojë një situatë që është --
23 ku ka një konflikt shumë rrallë, pra, ka një konflikt dhe
24 askush nuk ka informacion nga terreni. Dhe nuk kishte gazetarë
25 në terren, nuk kishte fare. I vetmi informacion që vinte nga

1 terreni, pra, informacion publik vinte nga autoritetet serbe
2 të cilët ne i konsideronim si të rrejshme dhe të fabrikuara
3 për pjesën më të madhe të tyre.

4 Pra, unë përpiqem të ndihmoj gazetarët që të bëjnë punën
5 e tyre. Dhe jam i kënaqur që të shoh që çdo fjali kam thënë
6 ose që ka thënë ai, që ne mendojmë, sepse nuk kishim
7 informacion të mirë nga terreni gjatë luftës. Dhe, pra, unë po
8 jepja një burim alternativ të informacionit duke atribuar në
9 mënyrë të vazhdueshme informacionin atij pa dhënë një gjykim
10 të prerë lidhur me saktësinë e informacionit. Pra, nuk mund të
11 them që është tipike sepse asnjë ditë nuk është tipike gjatë
12 luftës për sa i përket tmerreve konkrete që po ndodhnin dhe
13 për të cilat po dëgjonim lëvizjet e njerëzve me trena,
14 grumbullimi i civilëve të pafajshëm. Nuk e di sesi mund të
15 quhet kjo tipike.

16 Pra, do të thoja që kjo ishte e ngjashme me fjalët që kam
17 përdorur në raste të tjera, por me fjalën "tipike" kam
18 problem, nuk mund ta përdorim këtë.

19 Z. PACE: [Përkthim] Mund ta heqim këtë dokument. Tani do
20 të kërkoj dokumentin në ekran 1D00148.

21 PY. Dhe kjo është nga kabllogrami që ju është treguar më
22 herët nga avokatja e z. Krasniqi. Mund të shohim që bëhet
23 fjalë për kabllogramin e prillit 1999. Dhe shohim që është
24 përpiluar, përgatitur nga URL dhe më poshtë, "Miratuar nga S:
25 Sekretari".

1 Dhe doja që të kalojmë në të njëjtën dokument në faqen
2 DHT01539. Do të lexojmë nga paragrafi 14, që në fakt ju lexua
3 dhe nga avokatja e z. Krasniqi, po do ta lexoj të njëjtin edhe
4 unë:

5 "(S)", pastaj kemi "Krasniqi këmbënguli që ne të
6 rikonsiderojmë armatosjen e UÇK-së. Ngjarjet e fundit,
7 nënshkrimi i Marrëveshjes së Rambujesë nga shqiptarët dhe
8 spastrimi etnik i serbëve dhe masakrat kishin ndryshuar
9 rrethanat. Armatimi i UÇK-së nuk do të thoshte më tej
10 militarizimi i kosovarëve, por më shumë një mënyrë për t'ju
11 dhënë mundësinë atyre për të mbrojtur popullin e tyre. Një
12 mënyrë për të shmangur embargon, problemin e embargos mund të
13 ishte dërgimi i armëve në Kosovë përmes ndërmjetësve apo
14 ndërmjetësuesit. Sidoqoftë, rusët dhe sllavët e tjerë po
15 armatosnin Beogradin, pra, çështja e embargos dukej e
16 tejkaluar."

17 Paragrafi në vijim, pastaj thotë:

18 "Sekretarja pranoi vështirësitë lidhur me çështjen,
19 problemin që paraqitej. Ajo pothuajse mbrojti dhe këtë
20 logjikë: Njerëzit duan të mbrojnë veten po si mund ta bëjnë
21 këtë në mënyrë të paarmatosur? Në përfundim, realiteti praktik
22 duhej të mbizotëronte, që ishte dhe besimi dhe shokët e UÇK-së
23 kishin fituar në Evropë duke -- miq të UÇK-së kishin fituar
24 përmes nënshkrimit të angazhimit të marrëveshjes, përfshirë
25 edhe vullnetin e tyre, pra, për të dërguar forca në terren,

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 170

1 forca tokësore në një ambient që e lejonte këtë gjë të tillë.
2 Vlerësimi jonë, nëse do të armatosnim UÇK-në kjo mbështetje do
3 të largohej, nuk do të ishte më. Kjo nuk do të thoshte që
4 mosarmatosja e UÇK-së ishte e drejtë, por prioriteti,
5 përparësia duhej të ishte që NATO-ja të mbante, të theksonte
6 vazhdimësinë e saj për të arritur objektivat, derisa
7 objektivat të arriheshin në fund. Ambasadori Dobbins theksoi
8 se ministrat e vendeve të NATO-s në komunikatën e tyre ishin
9 angazhuar që të mbanin këtë qëndrim derisa forcat serbe të
10 largoheshin nga Kosova dhe se forca e sigurisë ndërkombëtare
11 të futej në vend dhe të gjithë kosovarët të mund të ktheheshin
12 në shtëpitë e tyre."

13 Tani, Dëshmitar, është pak e vështirë, kërkoj ndjesë, si
14 pyetje. Por sipas asaj që ju kujtohet juve dhe asaj që dini
15 ju, a është ajo që kemi lexuar këtu e saktë lidhur me miqtë e
16 UÇK-së, pra, që kishin në Evropë dhe dëshira e tyre për të
17 dërguar forca në terren dhe ju citoni: "Vlerësimi jonë ishte i
18 drejtë se po të armatosnim UÇK-në kjo mbështetje do të
19 zhdukej."

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Kundërshtim. Është pyetje e
21 përbërë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace, e
23 bëni më të thjeshtë.

24 Z. PACE: [Përkthim] Pra, po e përsëris pyetjen.

25 PY. "Vlerësimi jonë ishte se po të armatosnim UÇK-në, kjo

1 mbështetje do të zhdukej”.

2 A ju kujtohet kështu, a është e saktë?

3 PË. Do të përpiqem që të jem i shkurtër. Ne po përpiqeshim të
4 mbanim të gjithë vendet së bashku. Vendet Evropiane e kishin
5 pikëpamje të ndryshme sa i takon nivelit me të cilin ishin të
6 angazhuar ata, po dhe të kënaqur që të jepnin armë UÇK-së, të
7 armatosnin UÇK-në. Ajo që po thotë -- ajo thotë këtu që mund
8 të humbni unanimitetin që kishim krijuar në mbështetje të
9 Kosovës në qoftë se do të armatosnim UÇK-në. Pra, kjo do të
10 zhdukej. Fjala “zhdukej” është ndoshta një tepër i fortë nga
11 ajo që ajo kishte në mendje kur tha këtë. Dhe përsëri këto
12 kabllograme pasqyrojnë në mënyrë jo të saktë që atë që po
13 thoshte ajo ishte që duhej që NATO-ja të hynte në terren dhe
14 të merrte një kontrollin, pra, në një ambient që e lejonte, ia
15 mundësonte një gjë të tillë. Unë mund t’ju jap edhe emrat e
16 vendeve që mund të largoheshin, pra dhe kishin pikëpamje të
17 ndryshme lidhur me dëshirën për të armatosur UÇK-në në ato
18 rrethana ekstreme për ta të cilët përballeshin me një masakër
19 të përgjithshme. Ideja e armatosjes së tyre nuk ishte diçka që
20 të gjithë, që disa shtete e mbështesnin.

21 Pra, ajo thoshte që do të humbnim, ajo që thotë këtu
22 është që do të humbisnim unanimitetin dhe po jo që mbështetja
23 do të zhduket, por unanimiteti i mbështetjes do të largohet.

24 Z. PACE: [Përkthim] Do të fillojmë një temë tjetër.

25 Ndoshta është koha që të ndërpresim këtu.

Dëshmitari: James Rubin (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Pace

Faqe 172

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rubin, do
2 të përmbyllim seancën për sot këtu. Jam i sigurtë që dhe ju
3 keni nevojë për pak pushim. Do të shihemi nesër në mëngjes në
4 orën 9.00. Dhe mundësisht mund të përfundojmë nesër me juve.

5 DËSHMITARI: Faleminderit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mos bisedoni
7 me askënd gjatë mbrëmjes lidhur me dëshminë tuaj në sallë të
8 gjyqit.

9 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
11 ndërpritet deri nesër në orën 9.00.

12 --- Seanca mbyllet në orën 16.27

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25